# RAPORT AUDITIMI

**PËRPUTHSHMËRIE DHE RREGULLSHMËRIE**

## “MBI AUDITIMIN E FINANCIMIT TË PROJEKTIT BURIMET UJORE DHE UJITJA”

**SHKURT 2018**

**Përmbajtja** **faqe**

**I. PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE ........ 4**

**II. HYRJA ........ 11**

**Objektivat dhe qëllimi ........ 12**

Identifikimi i çështjes ........ 12

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. ........ 12

Përgjegjësitë e audituesve ........ 12

Kriteret e vlerësimit. ........ 12

Standardet e auditimit ........ 13

**III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT ........ 14**

Informacioni i përgjithshëm. ........ 14

Kuadri legjislativ dhe operues i subjektit ........ 14

Objekt i këtij auditimi ........ 15

Qëllimi i auditimit ........ 15

Fushëveprimi ........ 15

**IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET ........ 17**

1. Mbi marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet e tyre nëse kanë, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimeve. ........ 17

2. Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit ........ 22

3. Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave ........ 29

4. Mbi zbatimin e kritereve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshje me huadhënësin ose legjislacionin shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës. ........ 33

4.1 Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të tenderit “Studimi fizibilitetit dhe projekti paraprak për rehabilitimin e sistemit ujor dhe kullues”. ........ 33

4.2 Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të tenderit “Studimi i fizibilitetit, projektet e zbatimit për ujitjen dhe kullimin, skemat e konsulenceës, trainim dhe mobilizimi”, me numë kontrate MAFCP/CS/003. ........ 37

4.3 Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të tenderit “Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)” ........ 42

4.4 Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të tenderit "Rehabilitimi i 11 Digave ( në Kukës, Berat, Fier, Korçë, dhe Muriz Thana)" ........ 45

4.5 Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të tenderit " Shërbime mbikëqyrje për Rehabilitimin e Digave" ........ 46

4.6 Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të tenderit "Shërbimet e Supervizionit për punimet e ujitjes dhe kullimit" ........ 49

4.7 Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të tenderit MEFWA/G/004a me objekt: "Pajisje hardware për Qendrën e Kadastrës së Ujit" ........ 53

4.8 Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të tenderit MAFCP/G/001 me objekt: "Blerje e pajisjeve kompjuterike dhe softe për Bordet e Kullimit dhe MBZHRAU" ........ 57

4.9 Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të tenderit MEFWA/G/003 me objekt: "Blerje automjetesh" ........ 60

4.10 Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të tenderit "Mobilje për Bordet e Kullimit" ........ 62

5. Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra e shërbime, për periudhën nga fillimi i zbatimit të projektit. ........ 66

5.1 Zbatimi i punimeve të kontatës me objekt "Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)" Loti 1. ........ 66

5.2 Zbatimi i punimeve të kontatës me objekt "Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)" Loti 2. Skema Ujitëse Divjaka, është pjesë e Projektit "Burimet Ujore dhe Ujitja''. ........ 71

5.3 Zbatimi i kontratave me objekt ´´Rehabilitimi i 11 Digave ´´ ( në Kukës, Berat, Fier, Korçë dhe Murriz Thana) ........ 78

**IV KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT ........ 82**

# I. PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përshkrimi i Auditimit

Projekti i burimeve ujore dhe ujitjes është një financim i Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Qeverisë Suedeze.

Baza ligjore e zhvillimit të këtij projekti është Ligji nr. 89/2013 datë 21/02/2013, i ndryshuar me ligjin nr. 58/2016 datë 02.06.2016, VKM-të dhe Manuali Operacional, si dhe dokumenta të tjera nënligjore. Marrëveshja e Huasë me gjithë ndryshimet përkatëse sanksionon marrjen e një Huaje prej 31,000,000 Euro (tridhjetë e një milion Euro), nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim e Zhvillim (në vijim IBRD), hua e cila me marrëveshje mes Ministrisë së Financave të RSH (në vijim MF) dhe donatorit IBRD Huaja Nr. 8211-AL, do të jepej në të njëjtën periudhë me 3.875 milion dollarë Grant i Qeverisë Suedeze (në vijim SIDA).

Sipas materialit të nxjerrë nga Banka Botërore on-line, rezulton se norma e interesit është variabël, por e papërcaktuar. IBRD ka disbursuar 18,535,405.07 € (tetëmbëdhjetë milion e pesë qind e tridhjetë e pesë mijë e katërqind e pesë dollar e shtatë cent) deri në 09.11.2017 (periudha audituese) ose 59.79% të huas, për mallra/punime/shërbime të përfunduara, ose në proces sipas rastit. Nuk janë paguar ende këste të kësaj kredie. Kësti i parë fillon të paguhet në 15 Shkurt 2020, pasi periudha aktuale është në "Grace Period" deri në këstin e parë sipas marrëveshjes.

Për zbatimin e Projektit "Burimet Ujore dhe Ujitja" është ngarkuar Njësia e Zbatimit të Projektit (PIU) në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR). PIU do të menaxhojë dhe koordinojë implementimin dhe administrimin e kontratave të projektit për rehabilitimin e digave dhe të skemave të ujitjes, monitorimin, kontrollin dhe koordinimin me:

Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit në MBZHRAU

Sektorin e Studimit dhe Projektimit të Veprave Ujore (SSPVU) në Qendrën e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore Fushë-Krujë (QTTB).

Laboratorin Teknik në QTTB.

Drejtorinë e Bordit Rajonal të Kullimit Fier.

Sektorin Teknik (i Kolaudimeve) pranë Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit në MBZHRAU, për të garantuar respektimin e kushteve të kontratave, zbatimin e punimeve në përputhje me projektin, në sasi, cilësi dhe afat si dhe zbatimin e ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve në Ndërtim", i ndryshuar dhe deri në përfundimin dhe marrjen në dorëzim përfundimtar të punimeve.

- Është realizuar kryerja e auditimit 100 %, përsa i përket auditimit të zbatimit të kontratave për rehabilitimin e 11 digave dhe rehabilitimin e 5 skemave të ujitjes, në kuadër të projektit “Burimet Ujore dhe Ujitja ” ku përfshihen:

11 Diga

në Kukës, Berat, Fier, Korçë, dhe Muriz Thana

4 skema Ujitëse Loti 1

1. Skema e ujitjes Murriz Thana - Dega Krutje;

2. Skema e ujitjes Murriz Thana – Dega Tërbuf;

3. Skema e ujitjes Kurjan Strum;

4. Skema e ujitjes Koshnica;

1 skeme Ujitëse Loti 2

Skema e ujitjes Divjaka

Qëllimi kryesor i këtij projekti është të ndihmojë Huamarrësin në përcaktimin e kuadrit strategjik për menaxhimin e burimeve ujore në nivelin kombëtar dhe në nivelin e baseneve të lumenjve Drin, Buna dhe Seman si dhe të përmirësojë, në mënyrë të qëndrueshme, performancën e sistemeve të përzgjedhura të ujitjes në zonën e projektit. Projekti realizohet në përputhje me manualin operacional i cili është hartuar në pajtim me kushtet e vendosura nga banka IBRD dhe PAD (Project Appraisal Dokument) dokumenti i vlerësimit të projekteve. Skeduli i implementimit të projektit përfshin periudhën 30 Maj 2013 deri në 18 Maj 2018.

Projekti përbëhet nga komponentët e mëposhtëm:

Komponenti 1: Rehabilitimi i Digave dhe Sistemeve Ujitjes dhe Kullimit :

Nga auditimi rezultoi se në zbatim të realizimit të këtij komponenti për periudhën objekt auditimi janë zhvilluar gjithsej 17 procedura prokurimi me vlerë 25.736.481 euro pa TVSH.

Afatet e përfundimit të punimeve të zbatimit për kontratën rehabilitimi i 11 digave dhe shërbimet e mbikqyrjes për këto punime janë përmbushur plotësisht dhe punimet e ndërtimit kanë përfunduar në masën 100% brenda muajit Nëntor 2015. Paketa “ Shërbime mbikëqyrje për Rehabilitimin e Digave”, është tenderuar tre herë nga momenti i bërjes efektiv të projektit dhe ka dështuar dy here për arsye se fondi limit ka qenë shumë i ulët si pasojë e llogaritjes së tij në bazë të VKM nr. 444 datë 05.09.1994 “Për tarifat e studimit, drejtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit” , (aktualisht i ndryshuar). Fakt i cili ka ndikuar në shtyrjen me gati një vit e gjysmë të procesit të tenderimit për këtë shërbim dhe si pasojë edhe realizimi për këtë pjesë të komponentit 1 është shtyrë me po kaq vite.

Komponenti 2: Mbështetja Institucionale për Ujitjen dhe Kullimin

Në kuadrin e kushteve të reja të krijuara me transferimin e përgjegjësive të ujitjes tek njësitë e qeverisjes vendore, si dhe të përgatitjeve, kërkesave për Financim Shtesë të Projektit duke zgjeruar skemat përfituese, aktivitetet 2.3 dhe 2.4 do të fillojnë zbatimin në Mars 2018 të harmonizuara me aktivitetet të ngjashme të komponentit 2 të Financimit Shtesë.

Komponenti 3: Mbështetja Institucionale për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, e cila përbëhet nga këto nën komponentë me objektiv: *Krijimi i një kuadri strategjik për menaxhimin e burimeve ujore në nivel kombëtar dhe në nivelin e baseneve Drini-Buna dhe Seman* :

Nën komponenti 3/a: Përgatitja e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, e cila është në proces miratimi final në VKM;

Nën komponenti 3/b:Përgatitja e planeve për Menaxhimin e Baseneve Drini-Buna dhe Seman, për te cilën është shpallur procedura për përzgjedhjen e konsulentit për hartimin e VSM. Kontrata parashikohet të lidhet brenda muajit Janar 2018;

Nën komponenti 3/c: Krijimi i Bazës së Konsoliduar të të Dhënave për Burimet Ujore (Kadastra Ujore), për të cilën është nënshkruar Kontrata për furnizimin e licencave softëare GIS të nevojshme për funksionimin e Kadastrës Ujore. Lëvrimi i licencave pritet të bëhet brenda 30 ditëve. Misioni i Bankës në Korrik-Shtator 2017 ka rekomanduar si shërbim shtesë dhe të hapur për publikun, përfshirjen në portal të të dhënave të hapura nga domenë publike (globale/rajonale) mbi ujërat, burimet natyrore meteorologjinë dhe të dhëna të tjera relevante.

Komponenti 4: Mbështetja për Zbatimin e Projektit

Objektivi: Menaxhimi i burimeve në përputhje me objektivat e projektit dhe procedurat sipas Manualit të Zbatimit të tij:

4/a: Menaxhimi i Projektit:

4/b: Krijimi i sistemit të Monitorimit dhe Vlerësimit – Kompletuar

Përsa i përket këtij komponenti rezulton se për Monitorimin ,Vlerësimin dhe anketimin në mbyllje të Projektit janë përgatitur TOR-s dhe pritet miratimi nga Banka, për të vijuar me procedurën e përzgjedhjes se konsulentëve.

Gjatë implementimit të projektit disa nga indikatorët e tij janë rishikuar dhe kanë ndryshuar me VKM, konkretisht në listën e indikatorëve për monitorimin e performancës së projektit të miratuara në Qershor 2016.

Disa indikatorët të tjerë, pjesë e marrëveshjes janë hequr si pasojë e ndryshimeve të ndodhura në administrimin e ujitjes më kalimin e këtij funksioni tek bashkitë, mungesës së lidhjes shkakësore apo për shkak të mbi mbulimit që krijojnë me indikatorë të tjerë.

- Deri në datën 30.10.2017 statusi i disbursimeve të projektit është 59.5% e vlerës totale prej 31 milion Euro të miratuar me ligjin 89/2013 "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes", i ndryshuar. Aktualisht nga IBRD janë disbursuar në total 18,446,442 Euro. Donator tjetër i projektit është Granti Suedez nr. TF014255 me vlerë 3.28 milion Euro. Aktualisht nga ky grant janë disbursuar 2,28 milion Euro, ose 70% e totalit. Në lidhje me kostot lokale dhe TVSH qeveria Shqiptare ka vënë në dispozicion fondin prej 6.88 milion Euro nga të cilat deri në momentin e auditimit janë disbursuar 3.94 milion Euro ose rreth 57%.

Nga auditimi u konstatua se zbatimi i buxhetit të miratuar në disa vite ka qenë larg pritshmërive, ndërsa në disa të tjerë rezulton të jetë zbatuar mirë, duke ju afruar përmbushjes së plotë të tij. Projekti ka nisur me nivele mjaft të ulëta të disbursimeve duke u pasuar nga një rritje në vitin 2012. Më pas në vitin 2013 përsëri niveli i disbursimeve ka qënë mjaft i ulët. Pas këtij viti, niveli i disbursimeve ka ardhur në rritje dhe sidomos në tre vitet e fundit është mjaft i kënaqshëm.

Nga auditimi mbi zbatimin e kritereve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshje me huadhënësin ose legjislacionin shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës rezultoi se për të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara, dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar dhe arkivuar, në kundërshtim me nenin 3 e 29 të "Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".

U audituan këto procedura prokurimi:

- "Studimi fizibilitetit dhe projekti paraprak për rehabilitimin e sistemit ujor dhe kullues", me fond limit 600,000 USD, nga ku rezultoi se Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në cilësinë e Autoritetit Kontraktor në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave teknike dhe financiare nuk ka njoftuar Agjencinë e Prokurimit Publik (APP) për shpalljen e fituesit për tenderin me objekt "Studimi fizibilitetit dhe projekti paraprak për rehabilitimin e sistemit ujor dhe kullues" me shoqërinë M.MD (UK)me vlerë 470,484 GBP (without taxes) ose 76,227,817.68 Lekë.

- "Studimi i fizibilitetit, projektet e zbatimit për ujitjen dhe kullimin, skemat e konsulencës, trajnimi dhe mobilizimi", me numër kontrate MAFCP/CS/003, me fond limit 42,451,320 lekë, rezultoi se Autoriteti Kontraktor nuk ka njoftuar Agjencisë e Prokurimit Publik, për shpalljen e fituesit dhe të lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik të shpallur fitues.

Termat e Refrencës nuk mbajnë emrat dhe firmat e specialistëve të cilët i kanë hartuar ato, nuk kanë Nr. Protokolli dhe datë dhe nuk janë të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (MBZHR). Çdo dokument institucional bëhet i vlefshëm ligjërisht vetëm nëse ai i ka të gjithë elementët e

përmendur më sipër. Gjithashtu në dosjen teknike mungon projekt-idea e miratuar nga investitori.

- "Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)" me fond limit gjithsej për dy lote 2,456,421,710 leke, rezultoi se Zhvillimi i procedurave të tenderit është bërë sipas Dokumenteve të Tenderit të përcaktuara në Manualin e Bankës Botërore dhe nga Udhëzuesit për përzgjedhjen dhe punësimin e konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore.

- "Rehabilitimi i 11 Digave (në Kukës, Berat, Fier, Korçë, dhe Muriz Thana)", me fond limit 939,000,000.9 leke, rezultoi se zhvillimi i procedurës së tenderit është bërë sipas Dokumenteve të Tenderit të përcaktuara në Manualin e Bankës Botërore dhe nga Udhëzuesit për përzgjedhjen dhe punësimin e konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore.

- "Shërbime mbikëqyrje për Rehabilitimin e Digave", me fond limit 41,751,000 leke, rezultoi se Paketa "Shërbime mbikëqyrje për Rehabilitimin e Digave", me fondin prej 232.400 Euro është tenderuar dy herë dhe në të dy rastet ka dështuar, pavarësisht se interesi i firmave në të parin ishte i lartë (34 firma) si dhe në të dytin janë ftuar po ato. Procedura e parë ka dështuar për rrjedhojë të vlerës shumë të ulët të fondit limit ndërsa e dyta për arsye se propozimi teknik i kompanisë së vetme që u paraqit në garë nuk kaloi pragun e minimumit të pikëve teknike duke shtyrje me 17 muaj procedurën e prokurimit të mbikëqyrjes së punimeve dhe për rrjedhojë, ndikim në lidhjen e kontratës së punëve civile, nga mos llogaritja e saktë e kostos së mbikëqyrjes. Banka Botërore ka miratuar ri tenderimin e kësaj pakete me kusht rishikimin e termave të referencës, kërkesës për shprehje interesi dhe buxhetit duke sugjeruar rritjen e buxhetit me të paktën 25%, duke ndikuar në zhvillim normal të procedurës finale. Fituesi në këtë procedurë mbas rishikimit të ToR është oferta më e ulët.

- "Shërbimet e supervizionit për punimet e ujitjes dhe kullimit", me fond limit 775,000 Euro, nga ku u konstatua se dy anëtarë të grupit të punës për përgatitjen e termave të referencës janë edhe anëtare të komisionit të vlerësimit të ofertave, në kundershtim me Nenin 58 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014.

- "Pajisje Hardware për Qendrën e Kadastrës së Ujit", me fond limit 241,380 Euro, rezultoi se Autoriteti Kontraktor (MBZHR) nuk ka marrë opinionin paraprak të bankës për s`kualifikimin e operatorit ekonomik "CP"shpkNjësia e prokurimit nuk ka njoftuar APP, në kundërshtim me Ligjin 89/2013 të ndryshuar dhe me efekt financiar negativ 424,704 lekë.

Kontrata e lidhur me operatorin "P"shpk në procedurën e prokurimit me objekt "Pajisje hardware për Qendrën e Kadastrës së Ujit" është lidhur në datën 24.11.2016. Ndërkohë që operatori ekonomik i s`kualifikuar "CP"shpk, është njoftuar në datën 05.12.2016, ose 11 ditë pas firmosjes së kontratës me operatorin, *veprim i cili e bën të pavlefshme të drejtën e ankimimit* e tij, në kundërshtim me Kodin e Procedurave Administrative. Ky veprim ka sjelle pavlefshmëri të ankimimit të operatorit ekonomik.

- MAFCP/G/001 "Blerje e pajisjeve kompjuterike dhe softe për Bordet e Kullimit dhe MBZHRAU", rezultoi se:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit u konstatua se 2 nga 3 anëtarët e hartimit të specifikimeve teknike janë edhe pjesë e komisionit të vlerësimit të ofertave.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstatua se nuk ka një referencë në lidhje me vlerësimin e specifikimeve teknike. Në raportin e vlerësimit të ofertave të operatorëve, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave shprehet për devijime të vogla apo të mëdha kundrejt specifikimeve teknike të pajisjeve të ofruara. Por, për këtë vlerësim nuk ka një bazë apo referencë lidhur me përcaktimin nëse këto devijime janë të vogla apo të mëdha duke bërë që vlerësimi të jetë jo plotësisht objektiv. Veprime në kundërshtim me ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

- Për procedurat "Blerje automjetesh", me fond limit 157,370 Euro dhe "Mobilje për Bordet e Kullimit", me fond limit 20,664 Euro

Nga auditimi u konstatua se 1 nga 3 anëtarët e hartimit të specifikimeve teknike është pjesë e komisionit të vlerësimit të ofertave, gjithashtu edhe një prej antarëve të hartimit të dokumenteve të tenderit është pjesë e komisionit të vlerësimit të ofertave, në kundërshtim VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

- Zbatimi i punimeve të kontratës me objekt "Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)" Loti 1.

Nga verifikimi i dokumentacionit në dosje rezultoi që: Punimet civile inxhinierike, për rehabilitimin e skemave ujitëse janë realizuar në përputhje me projektin e zbatimit si dhe kushtet teknike të zbatimit.

- Zbatimi i punimeve të kontratës me objekt "Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)" Loti 2. Skema Ujitëse Divjaka, është pjesë e Projektit "Burimet Ujore dhe Ujitja'', nga inspektimet në terren mbi zbatimin e punimeve sipas kontratës u konstatua se zërat e punimeve janë realizuar, por mos lidhja e energjisë elektrike ka penguar testimin e funksionimit të pompave, duke mos bërë të mundur marrjen në dorëzim të veprës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosje për zbatimin e punimeve dhe në veçanti për zërat e ri, rezulton se nuk ka gjetur zbatim pika 12.3.a.i e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës "Vlerësimi" për zërat e punimeve që kanë rritur volumet me 25 % krahasuar me volumet fillestare. Referuar pikës 12.3.a.i të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës "Vlerësimi", këto zëra duheshin konsideruar si zëra të rinj pune dhe duhej bërë negocim çmimi.

- Zbatimi i kontratës me objekt "Rehabilitimi i 11 Digave"( në Kukës, Berat, Fier, Korçë dhe Murriz Thana), rezultoi se punimet e rehabilitimit të digave kanë filluar të shoqëruara me

deklaratat paraprake të fillimi të punimeve në komunat përkatëse siç specifikohet në Nenin 7 të Rregullores së Zhvillimit të Territorit. Por, nga auditimi rezulton se për të gjitha rastet deklarata e përdorur për fillimin e punimeve nuk është formulari i deklaratës standard i përcaktuar në shtojcën D të rregullores së zhvillimit të territorit. Për më tepër për Digën Leminot grupit të auditimit nuk i është paraqitur deklarata paraprake e fillimit të punimeve por një letër me shkrim dore për marrje njoftimi nga drejtoria e urbanistikës së komunës Pirg.

## II. HYRJA

Mbështetur në ligjin 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1135/1, datë 02.11.2017, ndryshuar me nr. 1135/2, datë 17.11.2017, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga data 06.11.2017 deri në datë 05.01.2018, në subjektin Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (në vijim MBZHR), Drejtoria e Menaxhimit të Financimeve të Huaja, u krye auditimi për periudhën prej fillimit deri ne 31.10.2017 me objekt "Për financimin e projektit "Burimet Ujore dhe Ujitja", nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. A.B, përgjegjës grupi;
2. B.D, auditues;
3. M.R, auditues
4. I.H, auditues
5. S.M, auditues

Në veprimtarinë tonë audituese jemi mbështetur në:

- Verifikimin e arritjes së objektivave bazuar në **Ligjin nr. 89/013, datë 21.02.2013**, "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet KësHit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Ne vijim, IBRD), për financimin e projektit të "Burimet ujore dhe ujitja", amenduar me ligjin 58/2016, date 02.06.2016, si dhe **VKM nr. 636, date 31.07.2013**, "Për miratimin e marrëveshjes së grantit Suedez nr. TF014255", ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare per Rindertim dhe Zhvillim, për financimin e projektit "Burimet Ujore dhe Ujitja", ne VKM nr. 294, date 20.04.2016 "Per miratimin e dokumentit të ndryshimit të marrëveshjes se grantit.
- Verifikimin e veprimeve financiare, duke përfshirë procedurat e financimit të përcaktuara në **Ligjin nr. 89/013, datë 21.02.2013**, "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet KësHit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare per Rindertim dhe Zhvillim (në vijim, IBRD), për financimin e projektit të "Burimet Ujore dhe Ujitja", i ndryshuar.
- Sistemet e menaxhimit dhe transaksionet nëse janë në përputhje me aktet ligjore, aktet normative dhe rregulloret në fuqi; përputhshmëria ligjore lidhur me likuidimin e certifikatave të ndërmjetme dhe përputhshmërinë e rregullshmërinë e pagesave të tvsh-së.
- Përputhshmëria ligjore të prokurimeve të cilat janë parashikuar të kryhen sipas Udhëzimeve të Bankës Botërore për zhvillim për prokurimin e mallrave, punëve dhe konsulencës me financime të kësaj banke.
- Zbatimin e kontratave të ndërtimit te supervizorit dhe të konsulencës, bazuar në kontratën tip FIDIC.

Për këtë, kemi kryer testime mbi transaksionet financiare, si dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare.

**Objektivat dhe qëllimi**

Auditimi i zbatimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare në zbatimin e Projektit "Burimet Ujore dhe Ujitja". Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i rregullave, ligjeve, akteve nenligjore dhe rregulloreve, politikave, kodeve, si dhe auditimin e përgjegjësisë financiare, vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret. Zbulimi i devijimeve nga standardet e pranuara dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë, efiçensë, efektivitetit dhe ekonomicitetit të menaxhimit financiar me qëllim që për rastet individuale të identifikuara të detyrohen personat përgjegjës të mbajnë përgjegjësi, si dhe të merren masa për parandalimin e shkeljeve në të ardhmen.

Të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar si edhe shfrytëzimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve, dhënia e opinionit apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime.

**Identifikimi i çështjes**

Auditim përputhshmërie dhe rregullshmërie të marrëveshjes së huasë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Botërore, për financimin e projektit të "Burimet ujore dhe ujitja".

**Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.**

Bazuar në rregulloren e brendëshme të funksionit nga ana e grupit të auditimit u përcaktuan detyrat dhe përgjegjësitë e Njesise së Zbatimit të Projekteve, në MBZHR si dhe të Strukturave përkatëse të saj.

**Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia e audituesit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjen që është nën auditim. *Auditimi është kryer me zgjedhje*, ku për kryerjen e tij grupi i auditimit është mbështetur në dokumentacionin ligjor të paraqitur nga subjekti i audituar (PIU), evidencat e ndryshme në format të printuar dhe elektronik, si dhe në ballafaqimin e problemeve nëpërmjet kontakteve verbale e shkresore me subjektin e audituar. Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar duke përfshirë testimet, komunikimin e vazhdueshëm me stafin dhe specialistët e subjektit objekt auditimi, për të dhënë një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë dhe të qartë për zbatimin e përputhshmërisë se në çfarë masë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshje financimi.

**Kriteret e vlerësimit.**

Vërtetësia e përputhshmërisë se në çfarë masë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara.

Në vlerësimin e mekanizmave të auditimit, janë marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- llojet e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve të cilat mund të ndodhin;
- procedurat e mekanizmave të auditimit, që i shërbejnë parandalimit dhe zbulimit të këtyre gabimeve, të metave, parregullsive dhe shkeljeve;
- nëse janë miratuar procedurat e duhura dhe nëse niveli i respektimit të tyre, është i kënaqshëm;
- anët e dobëta të mekanizmave ekzistuese të auditimi, që çojnë në mos zbulimin e gabimeve parregullsive, të metave dhe shkeljeve prej tyre;
- ndikimi që këto anë të dobëta kanë, dhe;
- shpërndarjen në kohë dhe intensitetin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve;
-vlerësimin me objektivitet, profesionalizim dhe paanshmëri i observacioneve dhe oponencave teknike të paraqitura nga subjekti i audituar.

Për këtë u bazuam në:

***a.*** Ligjin nr. 89/013, datë 21.02.2013, "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet KësHit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindertim dhe Zhvillim (Ne vijim, IBRD), për financimin e projektit të ""Burimet ujore dhe ujitja,

***b.*** Ligj nr. 58/2016, datë 02.06.2016 "Për Ratifikimin e Dokumentit të ndryshimit të Marrëveshjes së Huas, të ratifikuar me Ligjin Nr. 89/2013, "Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për Financimin e Projektit të Burimeve Ujore Dhe Ujitjes"

***c.*** VKM nr. 636, date 31.07.2013, "Për miratimin e marrëveshjes së grantit Suedez nr. TF014255", ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit "Burimet ujore dhe ujitja",

***d.*** VKM nr. 294, date 20.04.2016 "Për miratimin e dokumentit te ndryshimit te marrëveshjes se grantit.

***e.*** Kontrata tip FIDIC;

***f.*** Udhëzimet e Bankës Botërore për zhvillim për prokurimin e mallrave, punëve dhe konsulencës me financime të kësaj banke.

***g.*** Manuali Operacional**.**

**Standardet e auditimit**

Standartet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës, janë në përputhje ligjin nr. 154/2014, "*Për organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", neni 3, pika 5, me Kodin Etik dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, sipas përcaktimit të ISSAI 100, "Auditimi i përputhshmërisë përcakton se deri në çfarë masë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi", duke përdorur gjykimin profesional specifikisht në ISSAI 400 "Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë", kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në praktikat më të mira të fushës" si dhe manualin e përputhshmërisë botim i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

## III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

**Informacioni i përgjithshëm.**

Auditimi u zhvillua në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Njësia e Zbatimit të Projektit (PIU), e cila është përgjegjëse për koordinimin dhe promovimin e projektit në MBZHR, organizimin e aktiviteteve promovuese me këtë qëllim mbështetjen e departamenteve dhe Njësive Administrative të MBZHR për të gjetur mundësi aplikimi për mbështetjen financiare, në funksion të adresimit të nevojave strategjike afat-mesme dhe afat-gjata, si dhe mbikqyrjen e projektit në terren.

Rëndësia e auditimit për KLSH, qëndron në faktin e përdorimit me efektivitet të investimit të projektit “Burimet ujore dhe ujitja” si dhe ndikimi pozitiv në përmirësimin e sistemit të ujitjes dhe kullimit për zonën e parashikuar dhe mirë menaxhimi i baseneve ujore. Zhvillimi i projektit do të ndikojë në përmirësimin e aftësive ujitëse dhe kulluese të të mbjellave në zonë, i cili lidhet drejtpërsëdrejti me përmirësimin e cilësisë së jetesës së banorëve, kjo gjë arrihet nëse do të kihen parasysh zhvilluesit zbatimi i planit të menaxhimit mjedisor dhe mirëmbajtje rigoroze të kanaleve vaditëse.

PIU do të menaxhojë dhe koordinojë implementimin dhe administrimin e kontratave të projektit për rehabilitimin e digave dhe të skemave të ujitjes, monitorimin, kontrollin dhe koordinimin me:

- Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit në MBZHRAU
- Sektorin e Studimit dhe Projektimit të Veprave Ujore (SSPVU) në Qendrën e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore Fushë-Krujë (QTTB).
- Laboratorin Teknik në QTTB.
- Drejtorinë e Bordit Rajonal të Kullimit Fier.
- Sektorin Teknik (i Kolaudimeve) pranë Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit në MBZHRAU, për të garantuar respektimin e kushteve të kontratave, zbatimin e punimeve në përputhje me projektin, në sasi, cilësi dhe afat si dhe zbatimin e ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve në Ndërtim”, i ndryshuar dhe deri në përfundimin dhe marrjen në dorëzim përfundimtar të punimeve.

- Është realizuar kryerja e auditimit 100 %, përsa i përket auditimit të zbatimit të kontratave për rehabilitimin e 11 digave dhe rehabilitimin e 5 skemave të ujitjes, në kuadër të projektit “Burimet Ujore dhe Ujitja ” ku përfshihen:

- 11 Diga

në Kukës, Berat, Fier, Korçë, dhe Muriz Thana

- <u>4 skema Ujitëse Loti 1</u>

1. Skema e ujitjes Murriz Thana - Dega Krutje;
2. Skema e ujitjes Murriz Thana – Dega Tërbuf;
3. Skema e ujitjes Kurjan Strum;
4. Skema e ujitjes Koshnica;

- <u>1 skeme Ujitëse Loti 2</u>

1. Skema e ujitjes Divjaka

**Kuadri legjislativ dhe operues i subjektit** për këtë financim është:

- Ligji Nr. 89/2013 datë 21.2.2013 për Ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes;
- Ligji Nr. 58/2016 datë 02.06.2016 "Për Ratifikimin e Dokumentit të ndryshimit të Marrëveshjes së Huas, të ratifikuar me Ligjin Nr. 89/2013, "Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për Financimin e Projektit të Burimeve Ujore Dhe Ujitjes"
- Vendim i KësHit të Ministrave Nr. 636, datë 31.7.2013 për miratimin e marrëveshjes së grantit suedez nr. Tf014255, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administratore e fondeve grant të siguruara nga Suedia, e përfaqësuar nga agjencia suedeze për bashkëpunim dhe zhvillim ndërkombëtar (SIDA), për bashkëfinancimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes.
- Vendim i KësHit të Ministrave Nr. 294, datë 20.4.2016 për miratimin e dokumentit të ndryshimit të marrëveshjes së grantit, të miratuar me vendimin nr. 636, datë 31.7.2013, të kësHit të ministrave, "për miratimin e marrëveshjes së grantit suedez, nr. Tf014255, ndërmjet shqipërisë dhe bankës ndërkombëtare për rindërtim dhe zhvillim (ibrd), që vepron si administrator i fondeve grant të siguruara nga suedia, e përfaqësuar nga agjencia suedeze për bashkëpunim dhe zhvillim ndërkombëtar (sida), për bashkëfinancimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes"
- Udhëzimet e Bankës Botërore për zhvillim e procedurave për prokurimin e mallrave, punëve dhe konsulencës me financime të kësaj banke.
- Manuali Operacional

Rëndësia e kryerjes së këtij auditimi nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka të bëjë me dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, përdorimin me efektivitet, efiçencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, pronës publike dhe asaj shtetërore, zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit financiar, kryerjen si duhet të aktiviteteve administrative, si dhe informimin e autoriteteve publike dhe publikut, nëpërmjet publikimit të raporteve të tij.

**Objekt i këtij auditimi** është rregullshmëria e marrëveshjes së financimit të projektit me huadhënësin, ndryshimet e saj nëse ka, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimeve, shkalla e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjen me huadhënësin, menaxhimi financiar i projektit, shkalla e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar, raportimi i tyre në Ministrinë e Financave, zbatimi i kritereve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshje me huadhënësin, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës si dhe zbatimi i kontratave të lidhura për punime civile, mallra e shërbime. përgjatë periudhës prej fillimit të projektit deri më 31.10.2017.

**Qëllimi i auditimit**: është dhënia e opinionit apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime.

**Fushëveprimi-** auditimi u shtri në periudhën kohore prej 06.11.2017 deri më 05.01.2018, gjatë së cilës dhe u auditua përdorimi i fondeve të kredisë si dhe zbatimi i kontratave të punëve civile.

Projekti "Burimet Ujore dhe Ujitjes" është financuar nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Në vijim, IBRD) në kuadër të një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe IBRD për financimin e projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes

-**Objektivat e projektit** janë krijimi i kuadrit strategjik për menaxhimin e burimeve ujore në nivel kombëtar dhe në basenet e lumenjve Drini-Buna dhe Seman.

-Përmirësimi në mënyrë të qëndrueshme i performancës së sistemeve të përzgjedhura të ujitjes në zonën e projektit.

**Komponentët e projektit:**

- Komponenti 1: Rehabilitimi i Digave dhe i Sistemeve të Ujitjes dhe Kullimit në zonë e projektit.

1/a Rehabilitimi i 11 digave që i shërbejnë 38,000 Ha dhe sistemeve të ujitjes dhe kullimit për 20,000 Ha.

1/b Përgatitja dhe implementimi i instrumenteve të sigurisë, mbrojtjes ambientale dhe sociale

- Komponenti 2: Mbështetja Institucionale për Ujitjen dhe Kullimin.
- Komponenti 3: Mbështetja Institucionale për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore.
- Komponenti 4: Mbështetja për Zbatimin e Projektit.

## IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

### 1. Mbi marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet e tyre nëse kanë, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimeve.

Baza ligjore e zhvillimit të këtij projekti është Ligji nr. 89/2013 datë 21/02/2013, i ndryshuar me ligjin nr. 58/2016 datë 02.06.2016, VKM-të dhe manualet operacionale. Midis tyre është edhe marrëveshja e huasë mes Bankës Botërore dhe Qeverisë Suedeze, të shprehura në ligj, mbi të cilën është lidhur marrëveshja e grantit mes Bankës dhe Qeverisë, si dhe dokumenta të tjera nënligjore.
Ky ligj me gjithë ndryshimet përkatëse sanksionon marrjen e një Huaje prej 31,000,000 Euro(tridhjetë e një milion Euro), nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim e Zhvillim. Hua e cila me marrëveshje mes Ministrisë së Financave të RSH (në vijim MF) dhe donatorit IBRD Huaja **Nr. 8211-AL**, do të jepej në të njëjtën periudhë me Grantin e Qeverisë së Suedisë (në vijim SIDA), sipas VKM-së më poshtë.
Ajo u aprovua nga IBRD në 29.11.2012 dhe u firmos nga të dyja palët në 14.12.2012. Kjo hua është efektive prej datës 13.05.2013 deri në 31.05.2018, por aplikimet për disbursime shkojnë deri në 30.09.2018 për punët e kryera më herët. Lloji i huasë është me shtrirje të paracaktuar kohore (në vijim FSL ose Fixed Spead Loan). Huaja është e marrë për 23 vjet, dhe ka një periudhë 7 vjeçare pa pagesë këstesh (Grace Period).
**Interesat**. Sipas materialit të nxjerrë nga Banka Botërore on-line, dhe dorëzuar pranë Grupit Auditues, rezulton se norma e interesit është variabël, por e papërcaktuar. Ky material bashkëlidhur i referohet datës 09/11/2017 **"WB IBRD 82110 LOAN OVERVIEW….World Bank Client Connection"**. Sipas po të njëjtit dokument, IBRD ka disbursuar 18,535,405.07 € (tetëmbëdhjetë milion e pesë qind e tridhjetë e pesë mijë e katërqind e pesë dollar e shtatë cent) deri në 09.11.2017 (periudha audituese) ose 59.79% të huasë, për mallra/punime/shërbime të përfunduara, ose në proces sipas rastit.
Nuk janë paguar ende këste të kësaj kredije. Kësti i parë fillon të paguhet në 15 Shkurt 2020, pasi kjo periudhë aktuale është në "Grace Period" deri në këstin e parë sipas marrëveshjes. Fillimi i pagesës së kësteve të kësaj kredie fillon pas përfundimit të "Grace Period", pra fillojnë pagesat në 15 Shkurt 2020. Në vijim çdo datë 15 Gusht edhe 15 Shkurt të çdo viti në masën 3.13%, ndërsa në datën 15 Gusht 2035 kësti i fundit do të jetë 2.97%.
VKM nr. 636, datë 31.07.2013, ndryshuar me VKM nr. 294, datë 20.04.2016. Ky vendim përcakton përdorimin e Grantit SIDA **Nr. TF014255**, ku IBRD vepron si administrator i fondeve, në të njëjtën periudhë me Huanë. Vlera e Grantit është, jo më e madhe se US$ 4,675,000 (katër milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë dollar amerikan). Granti është aprovuar për përdorim në 31.07.2013 dhe është efektiv prej 23.08.2013 deri në mbylljen e projektit 31.05.2018 dhe do të administrohet nga IBRD në cilësinë e garantorit të SIDA.

Granti është dakordësuar mes IBRD dhe SIDA në një dokument të përbashkët, për fonde të rregullta që qeveria e Suedisë derdh në buxhetin e Bankës Botërore, ndryshe IBRD, në cilësinë e kontributorit. Sipas marrëveshjes mes RSH dhe SIDA për periudhën Janar 2009-Dhjetor 2012, ky fond është i disponueshëm, në datat e sipërcituar pranë IBRD.

Amendimi i VMK 636 me VKM 294, ka ardhur për të njëjtën arsye si ligji 89/2013 është amenduar me ligjin 58/2016. Varësia e Drejtorisë së Përgjithshme të Administrimit të Ujërave (në vijim DPAU) ka ndryshuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (në vijim MMPAU) duke shkuar drejt ministrisë së re të ndryshuar Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (në vijim MBZHRAU), e cila në kohën e marrëveshjes quhej Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (në vijim MBUMK).

Në fakt ndryshimi i natyrës së disbursimit të gantit ka ardhur edhe me ndryshim të vlerës së tij.

Marrëveshja fillestare parashikonte që ky projekt të zhvillohej mes dy ministrish, të cilat kishin autoritetin juridiksional mbi burimet ujore. Këto ishin MMPAU dhe MBUMK. Marrëveshja është mbi një projekt që duhet të zhvillohej në 4 komponent. Financimi i projektit në komponentët e vet duhej të ndahej si më poshtë mes ministrive dhe burimeve të financimit:

(i) Rehabilitimi i digave dhe sistemit të ujitjes dhe kullimit. Financohej 100% nga IBRD dhe ngarkohej MBUMK për 29,400,000 € investime.
(ii) Suport institucional. Financimi parashikohej 100% nga IBRD dhe ngarkohej MBUMK të realizonte përdorimin e 900,000 € në këtë komponent.
(iii) Suport institucional për menaxhimin e integruar të burimeve ujore. Financimi parashikohej të merrej 3,600,000 € nëpërmjet SIDA dhe 300,000 € nga IBRD. Fondet do të administroheshin 100% nga MMPAU.
(iv) Implementimi dhe suporti. Financimi parashikohej të realizohej 400,000 € nga IBRD dhe 300,000 € nga SIDA. Projekti do të implementohej nga dy ministritë MMPAU dhe MBUMK së bashku, pa ndonjë ndarje në përqindje mes tyre.

Manuali operacional u hartua nga dy Ministri, saktësisht MBUMK dhe MMPAU në 10 Prill 2013 dhe u amendua në Gusht 2016, pas ndryshimeve të ligjit dhe VKM-së më sipër cituar, si në varësitë institucionale edhe në vlerën e Grantit.

Marrëveshja parashikon që të krijohet Komiteti Drejtues i Projektit (në vijim PSC), i cili duhet të bashkëdrejtohej nga dy Ministrat e MBUMK dhe MMPAU. Për këtë në datë 28.03.2013 doli urdhërit nr. 86 i dy Ministrave sipërcituar, për formimin e këtij komiteti. PSC do të përbëhej nga 9 anëtarë, me përbërjen e mëposhtme:

1) Ministri i MBUMK Bashkëkryetar.
2) Ministri i MMPAU Bashkëkryetar.
3) Një përfaqësues nga MF Anëtar.
4) Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ujitjes, Kullimit dhe Mbrojtjes së Tokës (koordinator projekti për MBUMK) Anëtar. (ky pozicion ka ndryshuar më pas në DPAUT)
5) Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Administrimit të Ujrave (koordinator i projektit për MMPAU) **Anëtar**. (ky pozicion ka ndryshuar më pas në DPBU)
6) Kryetari i KësHit të basenit ujor Drin-Bunë (d.m.th. Prefekti Shkodër) **Anëtar**.
7) Kryetari i KësHit të basenit ujor Seman (d.m.th. Prefekti Fier) **Anëtar**.
8) Një drejtor nga Bordet e kullimit nga zona e përfshirë në projekt **Anëtar**.
9) Një kryetar komune nga zonat e përfshira në projekt **Anëtar**.

Referuar manualit operacional të 10 Prill 2013, ky komitet duhej të mblidhej dy herë për vitin 2013, dhe po kaq në vitin 2014, kurse për vitet 2015 deri në 2018 të paktën një herë në vit. Nga dosja e mbledhjeve të PSC rezulton se ky komitet është mbledhur 4 herë gjithsej, deri në periudhën e auditimit 31.10.2017. Datat e mbledhjes së PSC janë si më poshtë:

- Mbledhja e parë datë 30.07.2014
- Mbledhja e dytë datë 26.12.2014
- Mbledhja e tretë datë 13.11.2015
- Mbledhja e katërt datë 05.08.2016

Për vitin 2013 rezulton se nuk është mbledhur asnjëherë PSC, dhe për vitin 2017 deri në 31.10.2017 (afati auditues) nuk ka ende mbledhje. Mbledhjet e zhvilluara kanë paraqitur disa probleme në pjesëmarrje. Në mbledhjen e datës 30.07.2014 sipas listës-prezencës kanë qenë të pranishëm 12 persona, nga të dy Ministritë, përfaqësuesi i MF, dhe përfaqësuesi i BB. Në vendimin numër 1 i PSC, datë 30.07.2014 vendosi:

(1). Miratimin e Raportit progresiv mbi ecurinë e zbatimit të projektit, të paraqitur për periudhën deri në Dhjetor 2014, nga stafet përkatëse të dy ministrive.
(2). Miratimi i ndryshimeve në planin e prokurimit të projektit datë 22.12.2014, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
(3). Miratimi i Projekt buxhetit për vitin 2015, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të ndiqet në bashkëveprim me Ministrinë e Ekonomisë dhe MF, rregullimi i buxhetit afat-mesëm 2016-2017, për nevojat e financimit të huaj shtesë dhe të brendshëm.

Ligji nr. 89/2013 datë 21/02/2013 (ndryshuar me ligjin nr. 58/2016 datë 02.06.2016) sikundër dhe VKM-të sipërcituar përcakton qartësisht se PSC bashkëdrejtohet nga 2 ministrat e MMPAU dhe MBUMK, që në rastin e ndryshimeve në strukturën qeveritare të emërtesave ministeriale, duhej të ishin MM dhe MBZHRAU. Mbledhja e dytë e PSC me pjesëmarrjen e 8 personave prodhoi vendimin numër 2 datë 26.12.2014 për pikat e mëposhtme:

1. Miratimi i raportit progresiv mbi ecurinë e zbatimit të projektit, të paraqitur për periudhën deri në Maj 2014.
2. Miratimi i ndryshimeve në planin e prokurimit të projektit për vitin 2014, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Miratimi i ndryshimeve në buxhetin e projektit për vitin 2014, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Të vazhdojë bashkëpunimi ndër-institucional mes dy ministrive, MF dhe donatorëve.

Referuar proçes-verbalit të mbledhjes së datës 26.12.2014 ora 11:00 shikojmë se në të nuk kanë marrë pjesë dy ministrat e MM dhe MBZHRAU.

Mbledhja e tretë e PSC, në datë 13.11.2015 dhe protokolluar në MBZHRAU me numër protokolli 8675/1, në të cilin është vendosur:

(1) Miratim i raportit progresiv mbi ecurinë e zbatimit të projektit, të paraqitur për periudhën deri në nëntor 2015.

(2) Miratimi i ndryshimeve në planin e prokurimit për vitin 2015, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
(3) Në buxhetin e projektit për vitin 2015 me aktin normativ janë shkurtuar 440 milion lek financim i huaj IBRD, ti kërkohet MF dhe Ministrisë së Ekonomisë të akordojnë shtesën prej 204 milion lek financim i huaj IBRD, sipas tabelave bashkëlidhur këtij vendimi.
(4) Miratim i projekt-buxhetit për vitin 2016 dhe t'i kërkohet MF shtesë fondesh për financimin IBRD, për të mbuluar financimin e kontratave të planifikuara.
(5) Miratimi i paketës së ristrukturimit të projektit, sipas raportit bashkëlidhur këtij vendimi.
(6)

Kjo mbledhje e zhvilluar në orën 09:00 të datës 13.11.2015 me një bashkëdrejtues.

Mbledhja e katërt e PSC është zhvilluar datë 05.08.2016 ora 09:00. Kjo mbledhje është zhvilluar pas ndryshimeve të ligjit dhe VKM-së, duke kaluar në MBZHRAU kompetencat MM për komponentin 3 dhe 4 të projektit. Kësaj mbledhje i parapriu urdhri numër 407 datë 29.07.2016, i MBZHRAU, që ndryshonte urdhrin numër 86 datë 28.03.2013 për ngritjen e PSC. Sipas këtij urdhri përcaktohej më qartë numri i pjesëmarrësve në PSC dhe pozicionet e tyre. PSC përbëhej:

- Ministri i MBZHRAU Kryetar.
- Sekretari i Përgjithshëm i MBZHRAU Anëtar.
- Një përfaqësues nga MF. Anëtar.
- DPAUT në MBZHRAU Anëtar.
- DDPBU në MBZHRAU Anëtar.
- Kryetari i KësHit të basenit ujor Drinë-Bunë Anëtar.
- Kryetari i KësHit të Basenit ujor Seman Anëtar.
- Kryetari i Bashkisë Divjakë Anëtar.
- Drejtor i Bordit Rajonal të Kullimit Fier Anëtar.

Në mbledhje morën pjesë 9 përfaqësues, pasi Kryetar të KësHit të basenit ujor përkatës, janë Prefektët përkatës që qarqeve ku shtrihen këto basene. Kjo mbledhje konkludoi me:

(1) Miratimin e Raportit progresiv mbi ecurinë e zbatimit të projektit të paraqitur për periudhën deri në Qershor 2016.
(2) Miratimi i skemave prioritare ujitëse që do të rehabilitoheshin me financimin e projektit dhe kostot e vlerësuara, si më poshtë ..."Totali i financimit 2,451,247,593 Lek".
(3) Miratimi i ndryshimeve në planin e prokurimit të projektit për vitin 2016, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
(4) Miratimi i ndryshimeve në buxhetin e vitit 2016, si rezultat i ndryshimeve të bëra me VKM 233 datë 20.07.2016 (rritja e financimit të huaj për Huanë IBRD dhe të brendshëm, dhe ulja e financimit të huaj për Grantin Suedez) sipas tabelave bashkëlidhur këtij vendimi.
(5) Për projekt-buxhetin e vitit 2017, t'i kërkohet MF fonde shtesë për financimin e huaj IBRD, për të mbuluar financimin e kontratave të paplanifikuara.

Manuali operacional i vitit 2013 dhe ai i ndryshuar i vitit 2016, në përmbushje të lejimeve ligjore parashikon që PSC të mbulonte këto detyra:

- Sigurimin e koordinimit institucional;
- Sigurimin e mbikqyrjes së përgjithshme të projektit, për politikat dhe drejtimin strategjik të tij;
- Aprovimin e planeve vjetore të zbatimit dhe buxheteve;
- Rishikimin e ecurisë së zbatimit të këtyre planeve dhe zgjidhjen e problemeve eventuale.

Krahas PSC, marrëveshja, ligji dhe VKM parashikon krijimin e një Komiteti Teknik të përbashkët (në vijim PMT) nga sejcila Ministri dhe do të kishte këto detyra sipas ligjit dhe VKM:

- Menaxhimi i përditshëm i projektit;
- Koordinimin me aktorët e projektit, IBRD dhe SIDA.
- Monitorimi dhe vlerësimi i aktiviteteve të projektit, duke përfshirë monitorimin dhe raportin e përputhjes së masave të sigurisë;
- Përgatitjen e planit vjetor të implementimit dhe buxheti;
- Përgatitja dhe përditësimi si të nevojshëm të planit të prokurimit;
- Përgatitja e dokumenteve të prokurimit për të gjitha mallrat, punimet dhe paketat e shërbimeve të konsulentëve;
- Përgatitja e raporteve financiare të pa audituara tre-mujore dhe deklaratat e audituara financiare vjetore;
- Përgatitja e raporteve të progresit gjashtë-mujor dhe vjetor;
- Depozitim sistematik të të gjitha dokumenteve që lidhen me projektin (duke përfshirë prokurimin dhe menaxhimin financiar).

Duke qenë se PMT ka një rol kyç në implementimin e projektit, u gjykua nga Ministritë të nxirrej një urdhër numër 86/1, datë 28.03.2013 me bashkëfirmosjen e dy Ministrave, i cili do të përbëhej:

1. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ujitjes, Kullimit dhe Mbrojtjen e Tokës (DPDUKMT) (koordinator i projektit MBUMK).
2. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Administrimit të Ujrave (koordinator i projektit të MMPAU).
3. Menaxheri i projektit për MBUMK.
4. Menaxheri i projektit për MMPAU.
5. Specialistët e prokurimit dhe financës së projektit.
6. Specialistët e monitorimit dhe vlerësimit.
7. Specialisti i mjedisit në MBUMK.

Ky urdhër i ngarkon PMT-së përgjegjësinë e sigurimit dhe koordinimit të projektit, aspektet teknike dhe operative. PMT duhet të mblidhet të paktën një herë në muaj.

Çdo Ministri krijon Skuadrën e Menaxhimit të Projektit e cila ka përbërjen si më poshtë:

- Menaxheri i projektit (në MBUMK ose MMPAU);
- Specialisti i financës;
- Specialisti i prokurimit.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes:** | **Mospërputhje e strukturave të përcaktuara në marrveshjen e financimit** |
| **Situata:** | Nga auditimi rezultoi se, për shkak të ndryshimeve strukturore të Ministrive në vitin 2017, ka një mospërputhje të përcaktimeve të bëra në ligjin aktual të marrëveshjes së projektit me ndryshimet strukturore të Ministrive. Një situatë e tillë krijon paqartësi në adresimin e problemeve të ndryshme në lidhje me këtë projekt. Për këtë arsye është e nevojshme që të përshtaten përsëri ndryshimet administrative dhe emërore të Ministrive respektive me ligjin e marrëveshjes së kredisë. |
| **Kriteri:** | **Ligjin nr. 89/013, datë 21.02.2013**, "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet KësHit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Ne vijim, IBRD), për financimin e projektit të "Burimet ujore dhe ujitja".<br>**Ligjin nr. 58/2016 datë 02.06.2016** "Për Ratifikimin e Dokumentit të ndryshimit të Marrëveshjes së Huas, të ratifikuar me Ligjin Nr. 89/2013, "Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për Financimin e Projektit të Burimeve Ujore Dhe Ujitjes"<br>**VKM nr. 636, date 31.07.2013**, "Për miratimin e marrëveshjes së grantit Suedez nr. TF014255", ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare per Rindertim dhe Zhvillim, për financimin e projektit "Burimet ujore dhe ujitja",<br>**VKM nr. 294, date 20.04.2016** "Për miratimin e dokumentit te ndryshimit te marrëveshjes se grantit. |
| **Ndikimi/Efekti:** | Paqartësi në adresimin e problemeve të ndryshme në lidhje me këtë projekt. |
| **Shkaku:** | Mospërputhje e strukturave të përcaktuara në marrëveshjen e financimit me emërtimet e reja të ministrive të përfshira në legjislacionin e fushës përkatëse. |
| **Rëndësia:** | E ulët |
| **Rekomandimi:** | Nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të merren masat e nevojshme për të përshtatur të gjitha emërtimet dhe funksionet e reja të Ministrive përgjegjëse për projektin e Burimeve Ujore dhe Ujitjes në manualin operacional të projektit, me qëllim përcaktimin e saktë të kompetencave të strukturave përkatëse. |

## 2. Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit.

Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes, (Huaja IBRD, No. 8211-AL) është një financim i Bankës Botërore në shumën 31 milion Euro, në bazë të Ligji 89/2013 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe

Zhvillim (IBRD) për financimin e Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes", amenduar me Ligjin 58/2016 date 02.6.2016 dhe Granti Suedez (No. TF 014255) në vlerën 3.28 Milion Euro në bazë të VKM nr. 636, datë 31.07.2013, amenduar me VKM 294, date 20.04.2016. (Huaja Efektive: 30 Maj 2013, Granti efektiv: 23 Gusht 2013), ndërsa Qeveria Shqiptare në bazë të marrëveshjes së financimit duhet të mbuloj kostot lokale, TVSH etj. në vlerën Euro 6.88 M. IBRD dhe Sida do të koordinojnë nga afër së bashku gjatë zbatimit dhe mbikëqyrjes së projektit.
Qëllimi kryesor i këtij projekti është të ndihmojë Huamarrësin në përcaktimin e kuadrit strategjik për menaxhimin e burimeve ujore në nivelin kombëtar dhe në nivelin e baseneve të lumenjve Drin, Buna dhe Seman si dhe të përmirësojë, në mënyrë të qëndrueshme, performancën e sistemeve të përzgjedhura të ujitjes në zonën e projektit. Projekti realizohet në përputhje me manualin operacional i cili është hartuar në pajtim me kushtet e vendosura nga banka IBRD dhe PAD (Project Appraisal Dokument) dokumenti i vlersimit të projekteve. Skeduli i implementimit të projektit përfshin periudhën 30 Maj 2013 deri në 18 Maj 2018.

**Projekti përbëhet nga komponentët e mëposhtëm:**

Komponenti 1: Rehabilitimi i Digave dhe Sistemeve U&K
Komponenti 2: Mbështetja Institucionale për Ujitjen dhe Kullimin
Komponenti 3: Mbështetja Institucionale për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore
Komponenti 4: Mbështetja e Implementimit

**Indikatoret kryesore të plotësimit të objektivave:**

**Objektivat e Projektit (PDO):**

(i) Krijimi i kuadrit strategjik për menaxhimin e burimeve ujore në nivel kombëtar dhe në basenet e lumenjve Drini-Buna dhe Seman; (ii) Përmirësimi në mënyrë të qëndrueshme i performancës së sistemeve të përzgjedhura të ujitjes në zonën e projektit.

**Tabela nr. 1 Statusi i realizimit të Indikatorëve Kryesore të Objektivave të Projektit**

| Indikatori | Njesi e matjes | Baseline | Vlerat kumulative te realizuara (Fakt) | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Targeti Maj 2018 | |
| | | | Viti 1 | Viti 2 | Viti 3 | Viti 4 | Objektiv | Realizim i pritshem |
| Përgatitja e një Strategjie të dakordesuar per Menaxhimin e Integruar te Burimeve Ujore | Po/Jo | Jo | | | | Po | Po | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pergatitja e Planeve te dakordesuar te per menaxhimin e Baseneve Drini-Buna dhe Seman | Po/Jo | Jo | | | | Jo ( për periudhen objekt auditimi pasi dokumenti final Rishikimi “B” eshte dorezuar me 22 Dhjetor 2017) | Po | |
| Perfituesit direkt nga permiresimi i sistemeve te ujitjes (Anetaret madhore te familjeve fermere plus punetoret ne ferma) | Numer | 0 | 0 | 0 | 0 | 41,000 | 41,000 | |
| Siperfaqja e rehabilituar dhe permiresuar me sherbime ujitje | Ha | 0 | 0 | 0 | 0 | 20,000 | 20,000 | 24,300 |
| **Statusi i realizimit te Indikatoreve Kryesore te Objektivave te Projektit** | | | | | | | | |
| Pergatitja e nje Strategjie te dakordesuar per Ujitjen dhe Kullimin | Po/Jo | Jo | | | Po | Po | Po | |
| Pergatitja e nje Kadastre per Ujin funksionale | Po/Jo | Jo | | | | Po | Po | |

*Burimi i të dhënave: Njësia e Menaxhimit të Projektit*

***Komponenti 1: Rehabilitimi i Digave dhe Sistemit të Ujitjes dhe Kullimit në zonën e projektit.***

Objektivi: a)Rehabilitimi dhe modernizimi i digave dhe i sistemeve të përzgjedhura të ujitjes dhe kullimit.b) i) Përgatitja dhe zbatimi i instrumenteve dhe i masave të garancisë të lidhura me aktivitetet e rehabilitimit dhe të modernizimit, sipas pjesës 1 (a) më lart, duke përfshirë planet e menaxhimit të mbrojtjes mjedisore dhe sociale dhe planet e veprimit për rivendosjet, kur ato janë të aplikueshme; dhe ii) forcimin e kuadrit që mbulon sigurinë e digave bujqësore, rritjen e kapaciteteve, rritjen e ndërgjegjësimit dhe përgatitjen e planeve për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit dhe sigurimin e cilësisë, instrumentet, operimin dhe mirëmbajtjen dhe përgatitjen për rastet e emergjencave.
Rehabilitimi dhe modernizimi i sistemeve të ujitjes dhe infrastrukturës së digave

Nga auditimi rezultoi se në zbatim të realizimit të këtij komponenti për periudhën objekt auditimi janë zhvilluar gjithsej 17 procedura prokurimi me vlerë 25.736.481 euro pa tvsh.

Afatet e përfundimit të punimeve të zbatimit për kontratën reabilitimi i 11 digave dhe shërbimet e mbikqyrjes për këto punime janë përmbushur plotësisht dhe punimet e ndërtimit kanë përfunduar në masën 100% brenda muajit Nëntor 2015. Paketa “ Shërbime mbikëqyrje për Rehabilitimin e Digave”, është tenderuar tre herë nga momenti i bërjes efektiv të projektit dhe ka dështuar dy here për arsye se fondi limit ka qenë shumë i ulët si pasojë e llogaritjes së tij në bazë të VKM nr. 444 datë 05.09.1994 “Për tarifat e studimit, drejtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit” , (aktualisht i ndryshuar). Fakt i cili ka ndikuar në shtyrjen me gati një vit e gjysëm të procesit të tenderimit për këtë shërbim dhe si pasojë edhe realizimi për këtë pjesë të komponentit 1 është shtyrë me po kaq vite.

**Aktivitetet kryesore për Komponentin 1 janë:**

**Rehabilitimi i 11 Digave (me vendndodhje në Kukës, Berat Fier, Korcë dhe Murriz Thanë) (Drini Buna 3 diga) (Semani 8 diga):**

- Kapaciteti ujëmbledhës total 11 diga : 108 milion m³;
- Sipërfaqja e mbuluar nga 11 digat: 38.000 Ha;
- Afati i punimeve: 12 muaj;
- Kontraktuar: 24 Tetor 2014;
- Përfunduar: 24 Nentor 2015;
- Vlera e Investimit: 6.59 M. Euro;
- Investimi realizuar brenda afateve kontraktuale dhe buxhetit;
- Janë përgatitur dhe adoptuar instrumentet e sigurisë se digave: Plani i Garantimit te Cilesise se Punimeve, Planet e Emergjencës dhe Gatishmërisë, Planet e Shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes. Këto dokumente jane miratuar nga Paneli i Pavarur i Eksperteve per Sigurine e Digave (POE, Kryetari i këtij Paneli është ekspert ndërkombëtar);
- U përgatiten dhe implementuan Planet e Menaxhimit Social dhe Mjedisor (ESMP) dhe Planet e Zhvendosjes (RAP);

**Tabela nr. 2 Të dhëna për digat e rehabilituara:**

| Nr. | Diga | Vlera e investimit (lekë) | Zona qe do ujitet (ha) | Kapacitet million m3 | Lartesi (m) | Gjatesi (m) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Diga ne Murriz Thane** | | | | | | |
| 1 | Diga Murriz Thane | 265.089.956 | 29500 | 66.00 | 17 | 3570 |
| **Digat ne Fier** | | | | | | |
| 2 | Diga Kurjan | 14.859.500 | 5430 | 31.5 | 17 | 540 |
| 3 | Diga Strumi | 7.463.967 | | | 17 | 700 |
| 4 | Diga Zharrëz | 74.632.514 | 600 | 1.90 | 22 | 520 |
| **Digat ne Korçë** | | | | | | |
| 5 | Diga Leminoti | 53.530.100 | 400 | 1.20 | 33 | 180 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | Diga Koshnica 1 | 238.416.705 | 350 | 2.35 | 31 | 300 |
| **Digat ne Berat** | | | | | | |
| 7 | Diga Duhanas | 92.945.611 | 550 | 1.90 | 39 | |
| 8 | Diga Belesova | 70.654.911 | 1280 | 1.40 | 42 | 304 |
| **Digat ne Kukës** | | | | | | |
| 9 | Diga Tregtan 2 | 21.733.190 | 28 | 0.06 | 10 | 254 |
| 10 | Diga Tregtan 3 | 26.436.520 | 315 | 0.95 | 32 | 137 |
| 11 | Diga Vranisht 2 | 55.640.243 | 217 | 0.65 | 27 | 158 |
| | **Total** | **921,403,224** | **38,112** | **105.56** | | |

*Burimi i të dhënave: Njësia e Menaxhimit të Projektit*

Ndërsa për punimet civile për reabilitimin e skemave të ujitjes rezulton se janë realizuar sipas kontratave të lidhura dhe projektit të zbatimit, me përjashtim të skemës së Divjakes e cila nuk është marrë në dorzim për pasojë nuk mund të shprehemi që objektivat janë zbatuar plotësisht ose tërësisht përsa i përket efektivitetit të investimit të skemave të ujitjes.

**Rehabilitimi i 5 skemave të ujitjes (vendndodhja në Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)**

- Sipërfaqja e rehabilituar: 20.000 Ha;
- Perfitues direkt: 41.000 (Anetaret madhore te familjeve fermere plus punëtorët në ferma);
- Afati i punimeve: 8 muaj efektive (pa sezonin e ujitjes);
- Kontraktuar: Dhjetor 2016;
- Përfunduar brënda afatit kontraktual dhe buxhetit;
- Vlera e Investimit: 16.563.000 Euro;
- Janë përgatitur dhe janë në fazën e implementimit Planet e Menaxhimit Social dhe Mjedisor (ESMP) dhe Planet e Zhvendosjes (RAP);

**Skemat ujitëse të rehabilituara:**

| **Emërtimi i skemës ujitëse** | **Kosto e rehabilitimit në EURO** | **Sip/ në ha** | **Vendodhja** |
|---|---|---|---|
| Murriz Thane- Dega Krutje-Terbuf | 8.800.000 | 12.280 | Lushnje/Divjake |
| Skema ujitese Divjake | 4.330.000 | 2650 | Divjake |
| Skema ujitese në Rezervuarin Kurjan-Strum | 2.900.000 | 4730 | Roskovec |
| Skema ujitese në Rezervuarin Koshnicë *(vetem pjesa me gravitet)* | 533.000 | 350 | Devoll |
| **Totali** | **16.563.000** | **20.010** | |

*Burimi i të dhënave / NJësia e Menaxhimit të Projektit*

**Komponenti 2: Mbështetja Institucionale për Ujitjen dhe Kullimin**

Objektivi: Përmirësimi i performancës së organizatave që ofrojnë shërbimet e ujitjes

2/a: Reforma institucionale në sektorin e ujitjes dhe kullimit

2/b: Forcimi i kapaciteteve për organizatat që sigurojnë shërbimet e ujitjes dhe kullimit si dhe të grupeve të interesit

**Aktivitetet kryesore për Komponentin 2 janë:**

- Përgatitja e Strategjise Kombëtare për Ujitjen Kullimin dhe Mbrojtjen nga Përmbytjet
- Dokumenti i Strategjise është përfunduar, në proces miratimi në KM.
- Shërbimi i Trajnimit për Bordet e Kullimit dhe njësitë e qeverisjes vendore:
- Shërbimet e trajnimit janë në proces, kanë filluar në nëntor 2015, përfundojnë në Mars 2018;

Në Planin e Prokurimit të Projektit janë parashikuar edhe aktivitetet në vijim, në mbështetje të funksionimit të skemave të Ujitjes të rehabilituara:

1)Pajisje Hardware & Softëare për Menaxhimin e Sistemit të Informacionit per skemat e Ujitjes te rehabilituara (kosto e vleresuar 100,000 Euro);

2) Motoçikleta per Bordet e Kullimit (kosto e vleresuar 65,500 Euro);

Në kuadrin e kushteve të reja të krijuara me transferimin e përgjegjësive të ujitjes tek njësite e qeverisjes vendore, si dhe të përgatitjeve dhe kërkesave për Financim Shtesë të Projektit duke zgjeruar skemat përfituese, aktivitetet 2.3 & 2.4 do te fillojne zbatimin ne Mars 2018 të harmonizuara me aktivitetet e ngjashme të komponentit 2 të FSH.

**Komponenti 3:Mbështetja Institucionale për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore**
Objektivi: *Krijimi i një kuadri strategjik për menaxhimin e burimeve ujore në nivel kombëtar dhe në nivelin e baseneve Drini-Buna dhe Seman*

**Nenkomponenti 3/a: Përgatitja e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore**

- Dokumenti final i Versioni 3.1 i Rishikuar i Strategjise eshte dorezuar ne Nentor 2017.
- Dokumenti është miratuar ne KKU ne 13 Dhjetor 2017 dhe është në proces miratimi final ne VKM

**Nënkomponenti** 3/b:**Përgatitja e planeve për Menaxhimin e Baseneve Drini-Buna dhe Seman**

- Dokumenti i final i Planeve të Baseneve është dorëzuar në 16 Tetor 2017. Ky dokument eshte dorezuar ne reflektim te komenteve te institucioneve te linjes dhe grupit nderinstitucional mbi Draft dokumentin e PB (Qershor 2017).
- Ky dokument duhet shperndare institucioneve te linjes dhe grupit nderinstitucional per te vleresuar nese komentet jane reflektuar ne menyre korrekte nga ana e konsulentit.
- *Ne baze të komenteve te marra, Konsulenti ka dorezuar versionin final Rishikimi "B"me date 22 Dhjetor 2017.*
- Eshte shpallur procedura per perzgjedhjen e konsulenit per hartimin VSM. Kontrata parashikohet te lidhet brenda muajit Janar 2018.

**Nenkomponenti 3/c: Krijimi i Bazës së Konsoliduar të të Dhënave për Burimet Ujore (Kadastra Ujore).**

Platforma e Kadastres Ujore ka perfunduar.dhe eshte instaluar ne serverin e MBZHR. Misioni i Bankës ne Korrik Shtator 2017 e ka vleresuar Kadastren Ujore si nje portal te shkelqyer per nje game te gjere te te dhenave per burimet ujore.

- Platforma e KU eshte vleresuar nga ASIG si me poshte:
  a) Me shkresen Nr. 100/4 date 26.05.2016 ASIG shprehet se Modeli i Databazes Gjeohapesinore, Sistemi i Referimit Gjeodezik, Profili i Metadatave, Sherbimet e Rrjetit jane konform Ligjit 72/2012;
  b) Me shkresen Nr. 133/1 date 25.05.2017, ASIG shprehet se jane realizuar ndryshimet e nevojshme qe Projekti i Kadastres Ujore te jete konform standarteve dhe detyrimeve ligjore lidhur me temen Hidrografia (VKM 829, DATE 07.10.2015), si dhe me Rregulloren e ASIG mbi sherbimet e rrjetit.
- Eshte nenshkruar Kontrata per furnizimin e licensave softëare GIS te nevojshme per funksionimin e Kadastres Ujore. Livrimi i licensave pritet te behet brenda 30 diteve.
- Misioni i Bankës ne Korrik Shtator 2017 misioni ka rekomanduar si sherbim shtese dhe te hapur per publikun, perfshirjen ne portal te te dhenave te hapura nga domene publike (globale/rajonale) mbi ujerat, burimet natyrore meterologjine dhe te dhena te tjera relevante.

**Komponenti 4: Mbështetja për Zbatimin e Projektit**

Objektivi: Menaxhimi i burimeve në përputhje me objektivat e projektit dhe procedurat sipas Manualit te Zbatimit te Projektit

4/a: Menaxhimi i Projektit:

4/b: Krijimi i sistemit të Monitorimit & Vlerësimit – Kompletuar

Përsa i përket këtij komponenti rezulton se për Monitorimi & Vleresimi dhe anketimi ne mbyllje te Projekti janë përgatitur TORs dhe pritet NO nga Banka, për të vijuar me proceduren e perzgjedhjes se konsulenteve.

Gjatë implementimit të projektit disa nga indikatorët e projektit janë rishikuar dhe kanë ndryshuar me VKM konkretisht në listën e indikatorëve për monitorimin e performancës së projektit te miratuara ne Qershor 2016 konsistojne në:

Indikatori "Numri i digave të rehabilituara" është reduktuar nga 14 në 11, si rrjedhojë e analizës së prioritizimit, bazuar në analizën kosto-efektivitet, në projektet e zbatimit dhe fondet në dispozicion për rehabilitimin e digave.

Indikatori "Sipërfaqet ku përmirësohet shërbimi i ujitjes" është reduktuar nga 35,000 ha në 20,000 ha, për shkak të fokusit më të madh në përmirësimin e sistemit të skemave ujitëse, sesa thjesht rehabilitimit apo kthimit në gjendjen e mëparshme të këtyre skemave, me qëllim arritjen e një zgjidhjeje më të qëndrueshme, mbështetur dhe në të dhënat e studimit të fizibilitetit tashmë të përfunduar.

Sipërfaqja prej 35,000 ha bazohej në studimin e parafisibilitetit të digave dhe sistemeve përkatese të ujitjes të realizuar në vitin 2012 me kosto të shprehura në USD, monedhë e cila rezulton e fuqizuar në raport me euron, krahasuar me kursin e këmbimit të marrëveshjes (USD-EUR 1.29). Po kështu, kanë ndryshuar me rritje edhe çmimet e manualeve të punimeve dhe

kostoja për ha e sipërfaqes që rehabilitohet. Megjithatë, sipërfaqja përfundimtare që do të rehabilitohet do të jetë në vijimësi subjekt rishikimi bazuar në projektet e zbatimit për skemat ujitëse dhe kursimet eventuale nga procedurat e prokurimit.
Indikatori "Rritja e përqindjes së mbulimit të kostove të Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes kundrejt kostos së faturuar" është hequr për shkak të mungesës së lidhjes me komponentët e Projektit dhe veçanërisht me ndryshimet e ndodhura së fundi në administrimin e ujitjes nëpërmjet transferimit tek bashkitë të infrastrukturës së ujitjes dhe përgjegjësisë së operimit dhe mirëmbajtjes së tyre. Në këto kushte, thelbi i indikatorit për sipërfaqen e mbuluar me ujitje do të ishte vetëm raportimi i përqindjes së sipërfaqes së mbuluar me shërbim brenda skemave funksionale të qëndrueshme, pa trajtuar burimet e financimit dhe mirëmbajtjes së skemës.
Indikatori "Pjesa e sipërfaqes që mbulohet nga shërbimet e ujitjes dhe kullimit, me marrëveshjet përkatëse për ndarjen e kostove dhe shfrytëzim mirëmbajtje (%)" është përfshirë për të treguar se si Projekti do të arrijë shërbimet e ujitjes dhe kullimit në mënyrë të qëndrueshme. Indikatori do të masë qëndrueshmërinë e ujitjes dhe kullimit nga këndvështrimi i ndarjes së kostos së shërbimit të ujitjes dhe kullimit dhe marrëdhëniet midis aktorëve përgjegjës për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e sistemit. Ky tregues shërben për të adresuar pamjaftueshmërinë e burimeve për shërbimet e ujitjes dhe kullimit dhe atë të kostove të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes, faktorë që pengojnë qëndrueshmërinë e shërbimeve të ujitjes dhe kullimit.
Indikatori "Përdoruesit e ujit, të cilëve u janë siguruar shërbimet e reja/të përmirësuara për ujitjen dhe kullimin, nga të cilët numri i femrave është", riformulohet në "Përfituesit Direkt të Projektit (përdorues të ujit) (indikatori kryesor)", nga të cilët x% janë femra (indikator plotësues), për të parë raportet e gjinisë.
Disa indikatorët të tjerë, pjesë e marrëveshjes janë hequr si pasojë e ndryshimeve të ndodhura në administrimin e ujitjes më kalimin e këtij funksioni tek bashkitë, mungesës së lidhjes shkakësore apo për shkak të mbi mbulimit që krijojnë me indikatorë të tjerë.

### 3. Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.

***Nga auditimi rezultoi se:***
Deri në datën 30.10.2017 statusi i disbursimeve të projektit është 59.5% e vlerës totale prej 31 milion Euro të miratuar me Ligjin 89/2013 "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmejt Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes", i ndryshuar. Aktualisht nga IBRD janë disbursuar në total 18,446,442 Euro. Donator tjetër i projektit është Granti Suedez Nr. TF014255 me vlerë 3.28 milion Euro. Aktualisht nga ky grant janë disbursuar 2,28 milion Euro, ose 70% e totalit. Në lidhje kostot lokale dhe TVSH qeveria Shqipëtare ka vënë në dispozicion fondin prej 6.88 milion Euro nga të cilat deri në momentin e auditimit janë disbursuar 3.94 milion Euro ose rreth 57%.
Më poshtë paraqiten në mënyrë analitike të ardhurat sipas donatorëve në periudha vjetore:

*Në Euro*

| | Periudha | | | | | | | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Burimi i të ardhurave | 01.01.2017-30.10.2017 | 01.01.2016-31.12.2016 | 01.01.2015-31.12.2015 | 01.01.2014-31.12.2014 | 01.01.2013-31.12.2013 | 01.01.2012-31.12.2012 | 26.08.2010-31.12.2011 | 26.08.2010-30.10.2017 |
| IBRD | 8,106,411 | 3,292,895 | 4,655,029 | 1,484,786 | 505,930 | 364,393 | 36,998 | **18,446,442** |
| SIDA | 507,047 | 548,868 | 554,109 | 279,279 | 200,000 | 190,269 | - | **2,279,572** |
| Qeveria Shqipëtare për kosto lokale | 14,815 | 17,344 | 16,030 | 2,882 | - | - | - | **51,071** |
| Qeveria Shqipëtare për TVSH | 1,580,770 | 780,720 | 1,130,869 | 248,376 | 50,739 | 94,051 | - | **3,885,525** |
| Dokumentat e tenderit | 981 | 655 | - | 703 | 3,341 | | | **5,681** |
| Të tjera | | 1,036 | 1,205 | 1,198 | 330 | | | **3,769** |
| **Total** | **10,210,025** | **4,641,517** | **6,357,243** | **2,017,224** | **760,340** | **648,713** | **36,998** | **24,672,060** |

*Burimi i të dhënave: Njësia e Menaxhimit të Projektit*

Nga sa më sipër konstatohet se nga fillimi i projektit deri në momentin e auditimit, nga IBRD janë disbursuar në total 18,446,442 Euro. Nëse e shohim sipas viteve, konstatohet se tendenca e disbursimeve është në rritje. Në fillim të projektit, prej datës 26.08.2010 deri në datën 31.12.2011 vlera e disbursuar është 36,998 Euro, ose 0.2% e vlerës totale të disbursuar nga IBRD deri në momentin e auditimit. Për vitin 2012 vlera e disbursuar nga ana e IBRD është 364,393 Euro ose 2% e vlerës totale të disbursuar nga IBRD. Për vitin 2013 ky indikator ka ardhur në rritje duke arritur në 2.7% të vlerës së disbursuar nga IBRD ose 505,930 Euro. Për vitin 2014 vlera e disbursuar është pothuajse tre fish më e lartë se ajo e vitit paraardhës, 1,484,786 Euro ose 8%. Për vitin 2015 vlera përsëri është 3 fishuar duke arritur vlerën e disbursuar në 4,655,029 Euro ose 25% e vlerës totale të disbursuar nga ana e IBRD. Në vitin 2016 kemi një ulje në nivelin e disbursimit, saktësisht 3,292,895 Euro ose 18%. Dhe aktualisht për periudhën 01.01.2017 deri në 30.10.2017 janë disbursuar 8,106,411 Euro ose 44%.

Nga ana e SIDA-s deri në 2011 nuk ka disbursime. Ato kanë filluar në vitin 2012, vlera e së cilës është 190,269 Euro. Për vitin 2013 vlera e disbursuar arrin vlerën 200,000 Euro. Për vitin 2014 përsëri kemi rritje të vlerës së disbursuar nga ky donator në vlerën 279,279 Euro. Në vitin 2015 vlera është pothuajse dyfishuar duke arritur vlerën 544,868 Euro, vlerë e cila qëndron pothuajse konstante edhe për dy vitet e tjera 2016 dhe 2017 me vlera përkatësisht 548,868 Euro dhe 507,047 Euro.

Nga ana e qeverisë Shqipëtare kanë filluar disbursimet për kostot lokale në vitin 2014 në vlerën 2,882 Euro. Për vitin 2015 janë disbursuar 16,030 Euro, për vitin 2014 janë disbursuar 17,344 Euro dhe në vitin 2017 (deri 30.10.2017) janë disbursuar 14,815 Euro.

Ndërsa për pagesën e TVSH, nga ana e qeverisë Shqipëtare janë disbursuar 94,051 Euro në vitin 2012. Kjo vlerë ka ardhur në rritje, e lidhur ky edhe me disbursimet e kredisë së IBRD. Për vitin 2013 janë disbursuar 50,739 Euro TVSH. Për vitin 2014 janë disbursuar 248,376 Euro. Për vitin 2015 janë disbursuar 1,130,869 Euro. Për vitin 2016 kemi një ulje të disbursimeve në vlerën

780,720 Euro. Dhe për vitin 2017 deri në datën 30 tetor, vlera e disbursimit të TVSH 1,580,770 Euro.
Projekti ka siguruar të ardhura edhe nga burime të tjera të cilat janë të ardhura nga dokumentat e tenderit dhe të ardhura kryesisht nga interest bankare. Vlera e përfituar nga dokumentat e tenderit për gjithë periudhën e projektit është 5,681 Euro. Ndërsa të ardhurat nga interesat bankare janë 3,769 Euro.
Në lidhje me shpenzimet ndër vite të projektit, paraqitet situata e mëposhtme:

*Në Euro*

| | ***Periudha*** | | | | | | | ***Total*** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Përdorimi i fondeve | 01.01.2017-30.10.2017 | 01.01.2016-31.12.2016 | 01.01.2015-31.12.2015 | 01.01.2014-31.12.2014 | 01.01.2013-31.12.2013 | 01.01.2012-31.12.2012 | 26.08.2010-31.12.2011 | 26.08.2010-30.10.2017 |
| Punime civile | 6,351,740 | 3,282,536 | 4,044,915 | 683,379 | - | - | | **14,362,570** |
| Mallra | 30,450 | 180,195 | 10,878 | 318,853 | - | - | - | **540,376** |
| Shërbime konsulence | 1,185,011 | 992,988 | 1,263,610 | 353,965 | 147,416 | 571,210 | 10,748 | **4,524,948** |
| Kosto operative | 16,120 | 14,975 | 13,190 | 9,865 | 8,634 | 140 | 48 | **62,972** |
| TVSH | 1,221,914 | 784,534 | 1,130,869 | 248,376 | 50,739 | 94,051 | | **3,530,483** |
| **Total** | **8,805,235** | **5,255,228** | **6,463,463** | **1,614,438** | **206,789** | **665,401** | **10,796** | **23,021,350** |

*Burimi i të dhënave: Njësia e Menaxhimit të Projektit*

Nga tabela e mësipërme konstatohet se komponenti me shpenzimet më të larta është ai i punimeve civile me 14,362,570 Euro ose 62.4% e totalit. Pagesat për punimet civile kanë filluar në vitin 2014 me një vlerë totale vjetore prej 683,379 Euro ose 0.48% e totalit të shpenzimeve për punime civile të përdorura deri në datën 31.10.2017. Pas vitit 2014, shpenzimet për këtë komponent janë rritur në mënyrë të konsiderueshme, saktësisht në vitin 2015 janë shpenzuar 4,044,915 Euro ose 28.2%. Për vitin 2016 janë shpenzuar 3,282,536 Euro ose 22.9%, dhe për vitin 2017 janë shpenzuar 6,351,740 Euro ose 44.2%.
Shërbimi i konsulencës përbën shpenzimin e dytë më të lartë të projektit, me një vlerë totale të shpenzuar 4,524,948 Euro. Shpenzimet për këtë zë kanë filluar që në fillim të projektit. Për vitet 2010 dhe 2011 janë shpenzuar 10,748 Euro ose 0.24% të totalit të shpenzuar për këtë zë deri në momentin e auditimit. Për vitin 2012 janë shpenzuar 517,210 Euro ose 12.6%. Për vitin 2013 janë shpenzuar 147,416 Euro ose 3.3%. Për vitin 2014 janë shpenzuar 353,965 Euro ose 7.8%. Për vitin 2015 janë shpenzuar 1,263,610 Euro ose 28% e totalit. Në vitin 2016 janë shpenzuar 992,988 Euro ose 22%. Dhe në vitin 2017 janë shpenzuar 1,185,011 Euro ose 26%.
Për sa i përket TVSH-së, ky zë është i lidhur ngushtë me zërat e tjerë dhe ecuria e TVSH në vite është në të njëjtin trend si ato.
Zëri i mallrave arrin vlerën 540,376 Euro, ose 2.3% të gjithë vlerës së shpenzuar deri në momentin e auditimit. Ndërsa kostot operative janë 62,972 Euro ose 0.27% të totalit të projektit.
Realizimi i buxhetit të miratuar.
Çdo fundviti nga ana e njësia e projektit bëhen parashikime të fondeve të cilat do të disbursohen nga donatorët, të cilat shërbejnë për përllogaritjen e TVSH-së e cila do të paguhet nga Shteti Shqipëtar. Ky parashikim dorëzohet në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. MBZHR

dërgon në Ministrinë e Financave, sëbashku me planifikimi buxhetor të vetë ministrisë, edhe zërin për rimbursimin e TVSH për projektin në fjalë. Nga ana e Ministrisë së Financave dërgohet aprovimi për këtë, e cila më pas nga Sekretari i Përgjithshëm i MBZHR i komunikohet njësisë së projektit. Shkresat në lidhje me akordimin e buxhetit, sipas viteve listohet më poshtë:

- Me shkresën me nr 23/1 prot datë 04.01.2011 të Sekretarit të Përgjithshëm të MBUMK akordohet fondi për vitin 2011.
- Me shkresën me nr 5939/2 prot datë 23.12.2011 të Sekretarit të Përgjithshëm të MBUMK akordohet fondi për vitin 2012. Me shkresën me nr 5939/6 prot datë 09.01.2012 të Sekretarit të Përgjithshëm të MBUMK dërgohet detajimi i investimeve me kod projekti. Me shkresën me nr 23402/336 prot datë 27.02.2012 të Ministrit të Financave dërgohet rialokim i fondeve për vitin 2012.
- Me shkresën me nr 251/2 prot datë 29.01.2013 të Sekretarit të Përgjithshëm të MBUMK dërgohet detajimi i planit të investimeve për vitin 2013. Ky detajim ndryshon më pas me rialokimin e fondeve të përcjella me shkresat: nr 606/2 prot datë 20.02.2013; nr 1433/2 datë 09.04.2013 të Sekretarit të përgjithshëm të MBUMK në vijim të shkresës me nr 5129/1 prot datë 05.04.2013 të Ministrit të Financave; nr 4652/3 prot datë 11.11.2011 të Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHRAU në vijim të shkresës me nr 15368/137 datë 28.10.2013 të Ministrit të Financave; nr 5739 prot datë 04.12.2013 të Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHRAU në vijim të shkresës me nr 17420/1 prot datë 21.11.2013 të Ministrit të Financave.
- Për vitin 2014 fondet janë alokuar dhe rialokuar fondet sipas shkresave: nr 1923 prot datë 21.03.2014, nr 15/2 prot datë 07.01.2014, nr 4440/1 prot datë 26.06.2014, nr 6702/3 datë 13.10.2014 të Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHRAU.
- Për vitin 2015 fondet janë alokuar dhe rialokuar fondet sipas shkresave: nr 452/1 prot datë 22.01.2015, nr 4776/4 prot datë 23.06.2015, nr 6386/9 prot datë 29.09.2015 (në vijim të shkresës me nr 11546/145 datë 21.09.2015 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave), nr 8643/5 datë 28.12.2015, nr 9667/3 prot datë 30.12.2015 të Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHRAU.
- Për vitin 2016 fondet janë alokuar dhe rialokuar fondet sipas shkresave: nr 1204/1 prot datë 17.02.2016, nr 6053/5 prot datë 05.09.2016, nr 9942/3 prot datë 29.12.2016 (në vijim të shkresës me nr 17366/70 datë 27.12.2016 të Sekretarit të Përgjithshëm të MF) të Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHRAU.
- Me shkresën me nr 1428 prot datë 23.02.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHRAU dërgohet çelja dhe detajimi i planit të investimeve për vitin 2017.

Nga auditimi u konstatua se zbatimi i buxhetit të miratur në disa vite ka qënë larg pritshmërive, ndërsa në disa të tjerë rezulton të jetë zbatuar mirë, duke ju afruar përmbushjes së plotë të tij.

| Burimet e financimit | TOTAL Projekti | **2011** | | | **2012** | | | **2013** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| WRIP | *000 Lekë* | Plan | Fakti | % | Plan | Fakti | % | Plan | Fakti | % |
| Financim i Huaj | 4,668,744.00 | 1,000,000 | 1,552 | 0.16 | 100,000 | 79,900 | 80 | 250,000 | 21,847 | 9 |
| TVSH dhe kosto lokale | 933,748.80 | | | | 23,652 | 13,167 | 56 | 33,624 | 7,103 | 21 |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **TOTALI I Financimit** | **5,602,492.80** | | **1,552** | | **123,652** | **93,067** | 75 | **283,624** | **28,950** | 10 |

*Burimi i të dhënave: Njësia e Menaxhimit të Projektit*

| 2014 | | | 2015 | | | 2016 | | | 2017 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Plan | Fakti | % | Plan | Fakti | % | Plan | Fakti | % | Plan | Fakti 10 mujorit | % |
| 389,900 | 192,411 | 49 | 741,391 | 740,061 | 100 | 613,350 | 610,050 | 99 | 1,468,010 | 1,024,817.04 | 69.81 |
| 44,448 | 35,211 | 79 | 166,054 | 160,205 | 96 | 134,500 | 109,597 | 81 | 215,404 | 166,572.00 | 77.33 |
| **434,348** | **227,622** | 52 | **907,445** | **900,266** | 99 | **747,850** | **719,647** | 96 | **1,683,414** | **1,191,389.04** | 70.77 |

*Burimi i të dhënave: Njësia e Menaxhimit të Projektit*

Për vitet 2010 dhe 2011 të marra sëbashku, zbatimi i buxhetit të parashikuar është 1,552 mijë lekë kundrejt planifikimit prej 1,000,000 mijë lekë ose e shprehur në përqindje 0.16%. Një realizim ky mjaft i ulët. Për vitin 2012 realizimi i disbursimit është në nivelin 80%, ndërsa TVSH në nivelin 56%. Në shifra kemi një realizim prej 93,067 mijë lekë kundrejt 123,652 mijë lekë në total. Për vitin 2013 janë planifikuar 283,624 mijë lekë, ndërsa realizimi është vetëm 28,950 mijë lekë ose 10%. Për vitin 2014 janë planifikuar 434,348 mijë lekë dhe janë realizuar 227,622 mijë lekë ose 52%. Për vitin 2015 janë planifikuar 907,445 mijë lekë dhe janë realizuar 900,445 mijë lekë ose 99%. Për vitin 2016 janë planifikuar 747,850 mijë lekë dhe janë realizuar 719,647 mijë lekë ose 96%. Për vitin 2017 janë planifikuar 1,683,414 mijë lekë dhe janë realizuar deri në tetor të këtij viti 1,191,389 mijë lekë ose 71%. Pra, nga sa trajtuar më sipër konstatohet se projekti ka nisur me nivele mjaft të ulëta të disbursimeve duke u pasuar nga një rritje në vitin 2012. Më pas në vitin 2013 përsëri niveli i disbursimeve ka qënë mjaft i ulët. Pas këtij viti, niveli i disbursimeve ka ardhur në rritje dhe sidomos në tre vitet e fundit është mjaft i kënaqshëm.

**4. Mbi zbatimin e kritereve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshje me huadhënësin ose legjislacionin shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës.**

**4.1 Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të tenderit “Studimi fizibilitetit dhe projekti paraprak për rehabilitimin e sistemit ujor dhe kullues”.**

*Nga verifikimi i dokumentacionit në dosje rezultoi që:*

*Zhvillimi i procedurës së tenderit është bërë sipas Dokumenteve të Tenderit të përcaktuara në Manualin e Bankës Botërore dhe nga Udhëzuesit për përzgjedhjen dhe punësimin e konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore, por u konstatuan edhe këto parregullsi:*

**1**. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në cilësinë e Autoritetit Kontraktor në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave teknike dhe financiare nuk ka njoftuar Agjencinë e Prokurimit Publik (APP) për shpalljen e fituesit për tenderin me objekt “Studimi fizibilitetit dhe projekti

paraprak për rehabilitimin e sistemit ujor dhe kullues" me shoqërinë M.MD (UK)me vlerë 470,484 GBP (without taxes) ose 76,227,817.68 Lekë.

**Titulli i Gjetjes 1:** Autoriteti Kontraktor (MBZHR) nuk ka njoftim të Agjencisë së Prokurimit Publik, për shpalljen e fituesit dhe të lidhjes së kontratës.
**Situata:** Njësia e prokurimit nuk ka njoftuar APP.
**Kriteri:** Dokumentet standarde të tenderit.
**Ndikimi/Efekti**: Objektivi për ndërtimin e skemës së ujitjes dhe kullimit është përmbushur tërësisht. Problematika në mos kryerjen e testit lidhet me mos lidhjen e energjisë elektrike.
**Shkaku:** Mos njohje e mirë e procedurave të prokurimit.
**Rëndësia**: I mesëm.
**Rekomandime**: Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për rastin konkret si dhe në vazhdimësi në zhvillimin e procedurave të tenderimit, të zbatojë detyrat sipas procedurave të përcaktuara dhe të bëjë njoftimin e fituesit dhe njoftimin e lidhjes së kontratës për operatorin ekonomik të shpalluar fitues në Agjencisë së Prokurimit Publik.

**2.** Kontrata e shërbimit të Konsulencës nuk ka numër protokolli dhe datë.

Nga auditimi mbi zbatimin e kritereve dhe procedurave të tenderit **"Studimi fizibilitetit dhe projekti paraprak për rehabilitimin e sistemit ujor dhe kullues"** rezultoi si më poshtë vijon:

Tenderi "Studimi fizibilitetit dhe projekti paraprak për rehabilitimin e sistemit ujor dhe kullues" ka këto të dhëna:

| | | |
|---|---|---|
| **a.**Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Studimi i fizibilitetit, projektet e zbatimit për ujitjen dhe kullimin, skemat e konsulenceës, trainim dhe mobilizimi". | | |
| **1.Urdhër Prokurimi** Nr.1 datë 15.06.2011<br>**2. Procedura e Prokurimit**<br>Tender i hapur ndërkombëtar, parakualifikim (ICB) | **3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br><br>E.L- specialiste prokurimi, sipas urdhrit nr.1, datë 15.06.2011 | **4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Sipas Urdhrit 1, datë 15.06.2011<br>1. A.V (Kryetar)<br>2. A.O (anëtar)<br>3. G.P (Anëtar) |
| **5.Fondi Limit (pa tvsh)**<br>**600,000 USD** | **6.Oferta fituese (pa tvsh)**<br>**470,484 GBP** | **7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>04.07.2011<br>10.10.10 | **9.Burimi Financimit**<br>Banka Botërore | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **21 OE**<br>**b)**S'kualifikuar - OE,<br>**c)** Kualifikuar 6 OE (Shortlist) |
| **b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave** | | |
| **11.Lidhja e kontratës**<br>Datë 12.2011 me nr. prot. | **12.**Vlera e kontratës (me tvsh)<br>470484 GBP | **13.**Likuiduar deri datë - |

Njësia për hartimin e dokumenteve të tenderit për këtë procedurë prokurimit sipas urdhrit Nr. 1, datë 15.06.2011, përbëhet nga:

- E.L- specialiste prokurimi.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, referuar urdhrit nr. 1, datë 15.06.2011 dhe urdhrit nr. 292, datë 10.10.2011 përbëhet nga:

1. A.V - Kryetar
2. A.O - Anëtar
3. G.P - Anëtar

Kriteret teknike për listën e shkrutër janë:

1. Dokumente që përcaktojnë statusin ligjor, vendin e regjistrimit dhe vendin e kryerjes së aktivitetit për konsulentin;
2. Mënyra e organizimit dhe kapacitetet e konsulentit;
3. Eksperiencë në projekte të ngjashme;
4. Dokumentacion tjetër (Broshurat, përshkrimi i detyrave të ngjashme, letra rekomandimi, etj).

Konsulenti do të përzgjidhet në përputhje me metodën "Përzgjedhje bazuar në Cilësi dhe Kosto" e përcaktuar në Udhëzuesit e Bankës Botërore - Versioni i Janarit të vitit 2011.

Për tenderin me objekt "Studimi fizibilitetit dhe projekti paraprak për rehabilitimin e sistemit ujor dhe kullues" kanë shprehur interes 21 shoqëri dhe bashkime shoqërish. Komisioni i Vlerësimit pasi shqyrtoi dokumentet e tenderit dhe kriteret teknike, përzgjodhi shoqëritë sipas shortlistës së mëposhtme:

| No | Firm/Joint Venture | Nationality |
|---|---|---|
| 1 | MMD | UK |
| 2 | H.B.V&D | The Netherlands |
| 3 | T | Spain |
| 4 | B&E-C | France |
| 5 | T.E&C.C | Turkey |
| 6 | E.H Jsc&HC | Bulgaria |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit*

- Nga auditimi i dokumentacionit në dosje konstatojmë se raporti për shortlistën është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit, por vlerësimi i renditjes së kompanive konkurruese (shprehje interesi) është bërë vetëm nga anëtari z. A.O.
- Z. I.T, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit me e-mailin e datës 8 Jul 2011 i drejtohet Bankës Botërore për miratimin shortlistës së miratuar nga AK si dhe të shumës 600,000 USD.
- AK në e-mailin e datës 15 Jul 2011 (kerkesë për miratim, nga BB) i dërgon raportin e vlerësimit (shprehjet e interesit) në shortlistën e selektuar ku janë pasqyruar të gjitha komentet e

Bankës Botërore në raportin e rishikuar. (Në raportin e rishikuar vihet re se viti 2010 është korrigjuar në 2011).

- Miratimi i listës së shkurtuar dhe (RFP) nga Banka Botërore është bërë me datë 20 Jul 2011(referuar e-mailit).

- Afati i fundit i pranimit të propozimeve është caktuar data 06 September 2011, ora12:00. Kërkesa për propozim u është dërguar kompanive të shortlistuara më datë 21.07.2011, me nr. prot. 3233/1/2/3/4/5. Kompanitë kanë kërkuar sqarime dhe ana e AK i janë dërguar Bankës Botërore për miratim, dhe pas marrjes së miratimit sqarimet u janë dërguar të gjitha kompanive.

Pas letër-sqarimeve AK me shkresat me nr. Prot. 3233/6/7, datë 17.08.2011 i ka dërguar kërkesën për propozim kompanisë “”**C.E with D (spain)** dhe kompanisë **H.I in association with C (canada)**”.

- KVO në raportin e hapjes së tenderit, arriti në konkluzionin se, Kompanitë

1. **MMD**
2. **T,**

janë konsideruar të jenë të përshtatshme për vlerësim të mëtejshëm

- Raporti i vlerësimit të konsulentëve është bërë me datë 25 Tetor 2011, ku vlerësimi financiar rezulton:

| No | Firm/Joint Venture | Nationality |
|---|---|---|
| 1 | **MMD** | UK |
| 2 | H.B.V&D | The Netherlands |
| 3 | **T** | Spain |
| 4 | B&E-C | France |
| 5 | T.E&C.C | Turkey |
| 6 | E.H Jsc&HC | Bulgaria |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit*

Dhe 2 firmat shtesë që do të përfshihen në listën e shkurtër në rast se ndonjë prej firmave së fundmi ka vendosur të mos paraqes propozimin e saj si vijon:

1. C.E (Spain) with D (partner)
2. H.I (Canada) in association with C (France).

Data e paraqitur tek Banka Botërore për miratim të listës së shkurtuar dhe 2 firmave shtesë është 08 July 2011 dhe miratimi është bërë me datë 19 july 2011.
Data e paraqitur tek Banka Botërore për miratim propozimit financiar është 20 July 2011.

Kompanitë që kaluan pragun minimal të pikëve teknike (75) janë:

| No | Firm/Joint Venture | nationality | Technicul scores |
|---|---|---|---|
| 1 | **MMD** | UK | 88.17 |
| 2 | **T** | Spain | 83.60 |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit*

MBUMK me shkresën nr. prot. 8, datë 05.11.2011, njofton kompaninë "**MMD"** për pikët teknike dhe në akordancë të RFP, pika 5.4, seksioni 2, njofton datën dhe adresën për propozimin financiar.
MBUMK me shkresen nr. prot. 9, datë 05.11.2011, njofton kompaninë "**T"** për pikët teknike dhe në akordancë të RFP, pika 5.4, seksioni 2, njofton datën dhe adresën për propozimin financiar.
- Nga raporti i hapjes së propozimit financiar ofertat ekonomike rezultojnë si vijon:

| No | Firm/Joint Venture | nationality | Technicul scores | Proposed Price |
|---|---|---|---|---|
| **1** | **MMD** | UK | 88.17 | 470,484 GBP |
| **3** | **T** | Spain | 83.60 | 1,456,393.94 Euro<br>ose 204,681,604.33 ALL |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit*

- Në përfundim të procesit të vlerësimit, KVO rekomandon shoqërinë "**MMD Ltd (UK)"** të shpallet fitues duke e vlerësuar propozimin e tyre teknik dhe financiar me pikë më shumë se propozimet e konsulentëve të tjerë.
- KVO me datë 12.12.2011, i dërgon Kryetarit të Autoritetit Kontraktor z. A.K Raportin Përfundimtar të Vlerësimit për shqyrtim dhe miratim dhe në të njëjtën datë aprovohet me Nr. Prot. 10.
- Sekretari i përgjithshëm në MBUMK, me urdhrin Nr. 2, datë 15.12.2011 (Nr. prot. 12, datë 15.12.2011) ka gritur grupin për negocimin e kontratës (K.P; A.V; A.O dhe E.A).
- Kryetari i AK, me Nr. Prot. 10, datë 12.12.2011 miraton fituesin "**MMD Ltd (UK)"** dhe me datë 05.08.2014 miraton lidhjen e kontratës në shumën 470,484 GBP (without taxes) ose 76,227,817.68 Lekë.
- Kontrata Lump-Sum me nr. prot. ska, me Ref. No. RFP/A1/CS/QCBS me fituesin e tenderit "MMD Ltd (UK)" është lidhur më datë 13 Janar 2012, përfaqësuar nga z. I.A dhe për Autoritetin Kontraktor përfaqësuar nga z. A.K, në cilësinë e Sektretarit të Përgjithshëm.

### 4.2 Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të tenderit "Studimi i fizibilitetit, projektet e zbatimit për ujitjen dhe kullimin, skemat e konsulenceës, trainim dhe mobilizimi", me numë kontrate MAFCP/CS/003.

Nga verifikimi i dokumentacionit në dosje rezultoi që:

*Zhvillimi i procedurës së tenderit është bërë sipas Dokumenteve të Tenderit të përcaktuara në Manualin e Bankës Botërore dhe nga Udhëzuesit për përzgjedhjen dhe punësimin e konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore, por u konstatuan këto parregullsi:*

**1.** Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në cilësinë e Autoritetit Kontraktor në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave teknike dhe financiare nuk ka njoftuar Agjencinë e Prokurimit Publik (APP) për shpalljen e fituesit për tenderin me REF N0. MAFCP/CS/003 (Loan No. 8211-AL; Project ID. P121186) si dhe gjithashtu nuk ka njoftuar për lidhjen e kontratës për tenderin me objekt **"Studimi i fizibilitetit, projektet e zbatimit për ujitjen dhe kullimin, skemat e konsulencës, trajnim dhe mobilizimi"** me Bashkimin e Operatorëve Ekonomik "R s.a (leader)

(Switzerland) & BS S.r.l (member) Italy & H (member) Albania" me vlerë 685,900 Euro ose 42,451,320 Lekë.

**Titulli i Gjetjes 1:** Autoriteti Kontraktor nuk ka njoftuar Agjencisë e Prokurimit Publik, për shpalljen e fituesit dhe të lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik të shpallur fitues.
**Situata:** Njësia e prokurimit nuk ka njoftuar APP.
**Kriteri:** Dokumentet standarde të tenderit.
**Ndikimi/Efekti**: Objektivi për ndërtimin e skemës së ujitjes dhe kullimit nuk është përmbushur tërësisht. Problematika në mos kryerjen e testit lidhet me mos lidhjen e energjisë elektrike.
**Shkaku:** Mos njohje e mirë e procedurave të prokurimit.
**Rëndësia**: I mesëm.
**Rekomandime**: Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për rastin konkret si dhe në vazhdimësi në zhvillimin e procedurave të tenderimit, të zbatojë detyrat e Autoritetit Kontraktor duke bërë njoftimin e fituesit dhe të lidhjes së kontratës të Agjencisë së Prokurimit Publik .

**2.** Termat e Refrencës nuk mbajnë emrat dhe firmat e specialistëve të cilët i kanë hartuar ato, nuk kanë Nr. Protokolli dhe datë dhe nuk janë të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (MBZHR). Çdo dokument institucional bëhet i vlefshëm ligjërisht vetë nëse ai i ka të gjithë elementët e përmendur më sipër. Gjithashtu në dosjen teknike mungon projekt-idea e miratuar nga investitori.

Nga auditimi mbi zbatimin e kritereve dhe procedurave të tenderit **"Studimi i fizibilitetit, projektet e zbatimit për ujitjen dhe kullimin, skemat e konsulencës, trajnim dhe mobilizimi"** rezultoi si më poshtë vijon:

Tender i zhvilluar ka këto të dhëna:

| **b.** Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Studimi i fizibilitetit, projektet e zbatimit për ujitjen dhe kullimin, skemat e konsulenceës, trainim dhe mobilizimi". | | |
|---|---|---|
| **1.Urdhër Prokurimi**<br>Nr.173/2 datë 21.6.2013<br>**2. Procedura e Prokurimit**<br>Tender i hapur ndërkombëtar, parakualifikim (ICB) | **3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br><br>- M.K- specialiste pranë Sektorit të Prokurimit, Drejtoria Juridike<br>-E.L- specialiste prokurimi. | **4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Sipas Urdhrit 71, datë 07.03.2014<br>1. K.J (Kryetar)<br>2. E.Z (anëtar)<br>3. A.M (Anëtar)<br><br>Sipas Urdhrit 173/2, datë 21.06.2013<br>1. A.V (Kryetar)<br>2. E.J (anëtar)<br>3. N.K (Anëtar) |
| **5.Fondi Limit (pa tvsh)**<br>**1,043,000 Euro** | **6.Oferta fituese (pa tvsh)**<br>**988,540 Euro** | **7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** |

| | | |
|---|---|---|
| | | |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>26.02. 2014<br><br>Data e fundit e dorëzimit të ofertave: 01 Korrik 2013, jo më vonë se ora 17:00 | **9.Burimi Financimit**<br>Banka Botërore | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **24 OE**<br>**b**)S’kualifikuar - OE,<br>**c**) Kualifikuar 5 OE |
| **b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave** | | |
| **11.Lidhja e kontratës**<br>Datë 29.08.2014 me nr. prot. 3909/1 | **12.**Vlera e kontratës (me tvsh)<br>685,900 Euro ose 42,451,320 Lekë ose **988,540 Euro** | **13.**Likuiduar deri datë |

Njësia për hartimin e dokumenteve të tenderit për këtë procedurë prokurimit sipas urdhrit Nr. 173/2, datë 21.06.2013, përbëhet nga:

- M.K- specialiste pranë Sektorit të Prokurimit, Drejtoria Juridike
- E.L- specialiste prokurimi.

Njësia e Prokurimit përbëhet nga:

- A.V Përgjegjës sektori i projektimeve, Qendra e Transformimit të Teknologjisë bujqësore Fushë Krujë.
- M.K- specialiste pranë Sektorit të Prokurimit, Drejtoria Juridike
- T.M- specialiste e zyrës së protokollit

**Publikime të Ftesës për Ofertë nga Autoriteti Kontraktor:**

- Me shkresën Nr. Prot. 2611, datë 05.06.2013 dërgon për botim Ftesën për Shprehje Interesi, drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Publikim në Development Business Nro. 2 Maj 2010 dhe njoftimit të përgjithshëm të përditësuar, publikuar në 20 Dhjetor 2012, me numër Reference DB No. WB5260-12/12.

Kriteret për shortlistim janë:

- Dokumente që përcaktojnë statusin ligjor, vendin e regjistrimit dhe vendin e kryerjes së aktivitetit për konsulentin;
- Mënyra e organizimit dhe kapacitetet e konsulentit;
- Eksperiencë në projekte të ngjashme;
- Dokumentacion tjetër (Broshurat, përshkrimi i detyrave të ngjashme, letra rekomandimi, etj).

Një konsulent do të përzgjidhet në përputhje me metodën “Përzgjedhje bazuar në Cilësi dhe Kosto” e përcaktuar në Udhëzuesit e Bankës Botërore - Versioni i Janarit të 2011.

Në tendër kanë dorëzuar dokumentacion: Short List Selection:

| Nr. | Operatori ekonomik |
|---|---|
| 1 | Association MMD LTD&EM&ABCMD |
| 2 | ACE |
| 3 | Association G. K & PCES.A (leader) & ADK A – D – K, CE S.A. (member) Greece |
| 4 | Association IC and T Pvt. Ltd (leader) & D– E S Albania |
| 5 | H IEUR – G mbH (Germany) |
| 6 | Consortium IIs.a. (leader) Spain & EP S.A (member) |

| | |
|---|---|
| 7 | Consortium AI S.A (leader) & A&E E(member) Albania Jonit Venture Form |
| 8 | Jonit Venture E, S.L (leader) & C (member) Spain & K (member) Albania |
| 9 | Jonit Venture Sdu CP(SCP) (leader) & E (member) Spain |
| 10 | Jonit Venture BI (leader) France & S CE Srl (member) Italy & HS.p.a (member) Italy & D C (member) Albania |
| 11 | Jonit Venture R s.a (leader) (Switzerland) & BS S.r.l (member) Italy & H(member) Albania |
| 12 | C E E(leader) (France) & A (member) Albania - Jonit Venture |
| 13 | Jonit Venture TC, sa (T) (leader) Spain & A (member) Spain & I (member) Spain |
| 14 | Consortium G I, S.A (leader) Spain & IS.A (member) Spain & P-c shpl (member) Albania - Jonit Venture |
| 15 | PL E H e A S.s Portugal |
| 16 | Jonit Venture LML (leader) (United Kingdom) & BH (member) (United Kingdom) |
| 17 | Jonit Venture E Cs.a. (leader) Greece & T E & C Inc (member) Turkey |
| 18 | Jonit Venture 3TI P S.p.a. (leader) Italy & I I S.r.l. (member) Italy & G G sh.p.k (member) Albania |
| 19 | Jonit Venture P& PE (leader) Italy & CC (member) Italy & D& P (member) Albania |
| 20 | Jonit Venture CEC (CEC-S& P) (leader) J& F C (member) Egypt |
| 21 | Jonit Venture ES srl Italy & e C (member) Albania & E IA (member) Italy & ECsrl (member) Italy & T srl (member) Italy |
| 22 | Jonit Venture A Esrl (leader) Italy & CBMPB (member) Italy |
| 23 | SES LLC (USA) |
| 24 | Jonit Venture SIM spa (SIM) Italy & MA I B (member) Italy |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit, Njësia e Menaxhimi të projektit*

Raporti i vlerësimit të listës së shkurtuar:
Komisioni i vlerësimit bazuar në kriteret e vlerësimit vendosi të vlerësojë listën e shkurtuar si vijon:

| | |
|---|---|
| 1 | Association MMD LTD&EM&ABCMD |
| 2 | Consortium E EAU (leader) (France) & ALBEJIS (member) Albania - Jonit Venture |
| 3 | Jonit Venture L ML (leader) (United Kingdom) & BH (member) (United Kingdom) |
| 4 | Jonit Venture SCP (SCP) (leader) & E (member) Spain |
| 5 | Consortium GPO I, S.A (leader) Spain & I S.A (member) Spain & P-c shpl (member) Albania - Jonit Venture |
| 6 | Jonit Venture R s.a (leader) (Switzerland) & BS S.r.l (member) Italy & H (member) Albania |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit*

Miratimi i listës së shkurtuar nga Banka Botërore është bërë me datë 03 Tetor 2013
Afati i fundit të i pranimit të propozimeve është caktuar data 26 Shkurt 2014. Kërkesa për propozim u është dërguar kompanive të shortlistuara më datë 19 Dhjetor 2013. Kompanitë kanë kërkuar sqarime dhe i janë dërguar Bankës Botërore për miratim, dhe pas marrjes së miratimit sqarimet u janë dërguar të gjitha kompanive. Banka Botërore ka rekomanduar shtyrjen e afatit të dorëzimit të propozimeve.

KVO pas shqyrtimit të dokumentacionit bëri vlerësimin e pikëve teknike si vijon:

| Nr. | Emri i Konsulentëve/JV | Pikët teknike |
|---|---|---|
| 1 | Jonit Venture R s.a (leader) (Switzerland) & BSS.r.l (member) Italy & H (member) Albania | 86.66 |
| 2 | Jonit Venture SCP (SCP) (leader) & E (member) Spain | 78.41 |
| 3 | Association MMD LTD&EM&ABCMD | 76.45 |
| 4 | Jonit Venture SIM spa & MA I | 72.52 |
| 5 | Jonit Venture E S.L & C& K | 27.81 |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit*

Banka Botërore është njoftuar me datë 24 Prill 2014 me raportin e vlerësimit teknik-pjesa 1. Raporti i vlerësimit të konsulentëve është bërë me datë 08 Maj 2014, ku vlerësimi financiar rezulton:

| Nr. | Emri i Konsulentëve/JV | Pikët teknike |
|---|---|---|
| 1 | Jonit Venture R(leader) (Switzerland) & BS (member) Italy & H (member) Albania | 86.66 |
| 2 | Jonit Venture SCP (leader)& E (member) Spain | 77.75 |
| 3 | Association MMD LTD&EM&ABCMD | 76.44 |
| 4 | Jonit Venture SIM spa & MAIB | 71.78 |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit*

Nga raporti i hapjes së propozimit financiar ofertat ekonomike rezultojnë si vijon:

| **Nr.** | **Emri i Konsulentëve/JV** | **Vendi** | **Pikët teknike** | **Çmimi i propozuar** |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Association MMD LTD&EM&ABCMD | England | 76.44 | 984,000 Euro |
| 2 | Jonit Venture SCP (leader)&E(member) spain | France | 77.75 | 960,700 Euro |
| 3 | Jonit Venture R (leader) (Switzerland) & BS S.r.l (member) Italy & H (member) Albania | Switzerland | 86.66 | 685,900 Euro |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit, Njësia e Menaxhimi të projektit*

- KVO me datë 30 Maj 2014 me shkresën me Nr. Prot. 3862, i dergon Sekretarit të Përgjithshëm z. V.B Raportin Pëfundimtar të Vlerësimit për shqyrtim dhe miratim dhe në të njëjtën datë aprovohet me Nr.Prot. 3862/1.
- Në përfundim të procesit të vlerësimit, KVO rekomandon bashkimin e konsulentëve "Jonit Venture R (leader) (Switzerland) & BS S.r.l (member) Italy & H (member) Albania" të shpallet fitues duke e vlerësuar propozimin e tyre teknik dhe financiar me pikë më shumë se propozimet e konsulentëve të tjerë.
- Kryetari i AK, me urdhrin Nr. 290, datë 3.6.2014 (Nr.prot. 3909, datë 3.6.2014) gre grupin për negocimin e kontratës (K.J; E.Z; E.A).
- Kryetari i AK, me Nr. Prot. 3862/2, datë 11.06.2014 miraton raportin e vlerësimit të konsulentit.

- Banka Botërore me datë 28 Jun 2014, miraton fituesin "Jonit Venture R s.a (leader) (Switzerland) & BS S.r.l (member) Italy & H (member) Albania" dhe me datë 05.08.2014 miraton lidhjen e kontratës në shumën 685,900 Euro ose 42,451,320 Lekë
- BOE i përcjell AK Kontratën e Policës së Sigurimit në masën 10 %.
- U konstatua se Termat e Refrencës nuk mbajnë emrat dhe firmat e specialistëve të cilët i kanë hartuar ato, nuk kanë Nr. Protokolli dhe datë dhe nuk janë të miratuara nga investitori (MBZUR). Çdo dokument institucional bëhet i vlefshëm ligjërisht vetë nëse ai i ka të gjithë elementët e përmendur më sipër. Gjithashtu në dosjen teknike mungon projekt-idea e miratuar nga investitori.
- Kontrata Lump-Sum me nr. prot. 3909/1, me Ref. No. MAFCP/SC/003 me fituesin e tenderit të Bashkimit të Operatorëve Ekonomik **"R s.a (leader) (Switzerland) & BS S.r.l (member) Italy & H (member) Albania"** është lidhur më datë 29.08.2014, përfaqësuar nga NKM dhe për Autoritetin Kontraktor nga V.B.
- Titullari i Autoritetit Kontraktor me urdhrin me nr. 495, datë 20.10.2014 (Nr. Prot. 7378, datë 20.10.2014) ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për ndjekjen dhe zbatimin e aspekteve teknike, si dhe vlerësimin, miratimin dhe marrjen në dorëzim të raporteve të përgatitura nga firma konsulente Ekonomik "R s.a (leader) (Switzerland) & BS S.r.l (member) Italy & H (member) Albania" në kuadër të kontratës.

### 4.3 Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të tenderit "Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)".

*Nga verifikimi i dokumentacionit në dosje rezultoi si vijon:*

Zhvillimi i procedurës së tenderit është bërë sipas Dokumenteve të Tenderit të përcaktuara në Manualin e Bankës Botërore dhe nga Udhëzuesit për përzgjedhjen dhe punësimin e konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore.

Nga auditimi mbi zbatimin e kritereve dhe procedurave të tenderit me objekt "Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)" rezultoi si më poshtë vijon:

Tender i zhvilluar ka këto të dhëna:

| **c.** Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: **"Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)".** | | |
|---|---|---|
| **1.Urdhër Prokurimi** Nr.425 datë 09.08.2016<br>**2. Procedura e Prokurimit** Tender i hapur ndërkombëtar, parakualifikim (ICB) | **3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br><br>R-BS-H-Albania | **4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>1. L.B, Drejtori i Ujit dhe Kullimit (Kryetar)<br>2. L.K, Specialist , Drejtoria e Ujit dhe Kullimit (anëtar)<br>3. T.D, Përgjegjës, Sektori i Administrimit & Monitorimit të Ujrave (Anëtar) |
| **5.Fondi Limit (pa tvsh)**<br>**Loti 1:** | **6.Oferta fituese (pa tvsh)** | **7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** |

<table>
<tr><td colspan="2">- Skema Dega Krutje<br>**766,194,307** lekë ose<br>5,590,618,80 Euro<br>- Skema Dega Terbuf<br>**510,875,971** lekë ose<br>3,727,660 Euro<br>- Skema ujitëse Koshnicë<br>**75,351,618** lekë ose<br>549,811.15 Euro<br>**Loti 2:**<br>- Skema ujitëse Divjakë<br>704,932,384 lekë ose<br>5,143,614,64 Euro<br>**[ 17,887,000 Euro (2,456,421,710 ALL)]**</td><td colspan="2">**Loti 1:**<br>**1,653,252,354.45 (pa tvsh) ALL**<br><br>**Loti 2:**<br>**702,204,809.04 (Me tvsh) ALL**</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td colspan="2">**8. Data e hapjes së tenderit**<br>14 Tetor 2016<br><br>Data e fundit e dorëzimit të ofertave: 14 tetor 2016, ora 12:00</td><td colspan="2">**9.Burimi Financimit**<br>Banka Botërore</td><td colspan="2">**10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **9 OE**<br>**b**)S'kualifikuar 1 OE (faza paraprake)<br>1 OE (Vlerësimi i detajuar),<br>**c**) Kualifikuar 8 OE</td></tr>
<tr><td colspan="2">**11.Ankimime**<br>**AK**-s' 1 OE (Kërkesë për sqarim)<br>;**APP**–s'ka; **KPP-**s'ka</td><td colspan="3">**12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>1 OE</td><td>**13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>1 OEkonomik</td></tr>
<tr><td colspan="6">**b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave**</td></tr>
<tr><td colspan="2">**14.Lidhja e kontratës**<br>Loti 1: Nr. prot. 9400, datë 09.12.2016<br>Loti 2: Nr. Prot 9399, datë 09.12.2016</td><td colspan="3">**15.**Vlera e kontratës (me tvsh)<br>Loti 1: 1,983,633,832.36 lekë<br>Loti 2: 702,204,809.04 Lekë</td><td>**16.**Likuiduar deri datë 31.12.2017</td></tr>
</table>

Njësia e Prokurimit përbëhet nga:

1. A.V Përgjegjës sektori i projektimeve, Qendra e Transformimit të Teknologjisë bujqësore Fushë Krujë.
2. M.K- specialiste pranë Sektorit të Prokurimit, Drejtoria Juridike
3. E.L- konsulente prokurimi, Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes

Kryetari i AK me urdhrin Nr. 425/1, datë 29.09.2016 urdhëron zëvendësimin e znj. E.L- konsulente prokurimi, me znj. M.H.

**Publikime të Ftesës për Ofertë nga Autoriteti Kontraktor:**

- Me shkresën Nr. Prot. 6728/2, datë 01.09.2016 dërgon për botim Ftesën për Ofertë në Gazetën T.
- Me shkresën Nr. Prot. 6728/1, datë 01.10.2016 dërgon për botim Ftesën për Ofertë në Gazetën "SN".
- Me shkresën Nr. Prot. 6728/3, datë 02.09.2016 dërgon për botim Ftesën për Ofertë në Agjencisë së Prokurimit Publik.

- Publikimi në faqen zyrtare të MBZHRAU.
- Në buletinin e zhvillimit të biznesit (UNDB)-online.

Siguri i ofertës: Loti 1- 255,000 Euro dhe për Loti 2-103,000 Euro.

Autoriteti Kontraktor, ka bërë njoftimin e shoqërisë "S.C.H" Romania me nr. prot 7403, datë 29.09.2016 dhe nr. prot. 7401, datë 29.09.2016; JV "S.&TE2 Shpk" Albania me nr. prot 7401, dhe nr. prot. 7402 datë 29.09.2016 ; "R" Kingdom of Saudi Arabia me nr. prot 7402, dhe nr. prot. 7403 datë 29.09.2016; "A-S" shpk Albania me nr. prot 7403/3, dhe nr. prot. 7404/3 datë 29.09.2016; "S" shpk, Albania me nr. prot 7402/4, dhe nr. prot. 7403/4 datë 29.09.2016; "ANK" shpk, Albania me nr. prot 7402/5, dhe nr. prot. 7403/5 datë 29.09.2016; mbi qartësimin e letrës nr. 1 mbi dekumentet e tenderit.

Në tendër kanë dorëzuar dokumentacion:

| **Nr.** | **Operatori ekonomik** | **Data e dorëzimit të dokumentacionit** |
|---|---|---|
| 1 | H. SA | 14 tetor 2016 (F.L) |
| 2 | A shpk & P shpk | 14 tetor 2016 (E. C) |
| 3 | AK shpk & C shpk | 14 tetor 2016 (E.I) |
| 4 | JV " SA" & "TE2 & KI" | 14 tetor 2016 (E.S) |
| 5 | JV " T&M.Ç" | 14 tetor 2016 (H.D) |
| 6 | R E | 14 tetor 2016 (Ira Lito) |
| 7 | A shpk | 14 tetor 2016 (MXh) |
| 8 | JV "S" & C. & "IC M" Spa | 14 tetor 2016 (SC) |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit, Njësia e Menaxhimi të projektit*

**Sipas raportit të vlerësimit, kanë marrë pjesë sa vijon:**

| **Nr.** | **Operatori ekonomik** | **Cmimi i paraqitur (ALL)** | | **Përgjegjshmëria Po/jo** |
|---|---|---|---|---|
| | | **Loti 1** | **Loti 2** | |
| 1 | H SA | 2,900,879,227.30 | 865,805,993.52 | po |
| 2 | Ashpk & P shpk | | 781,156,405.16 (Me tvsh) | po |
| 3 | AK shpk & C shpk | | 702,204,809,04 (Me tvsh) | po |
| 4 | JV " S A" & "TE2 & KI" | 1,653,252,354.45 (pa tvsh) | | po |
| 5 | JV " SA" & "TE2 " | | 625,552,314.88 (Pa tvsh) | po |
| 6 | JV " T& MÇ" | 3,144,815,075 (Me tvsh) | 1,055,422,334 (Me tvsh) | jo |
| 7 | R AL-TC E | 1,549,159,185,29 | | po |
| 8 | A | | 870,327,096.97 (Pa tvsh) | po |
| 9 | JV "S" & C & "I-T M" Spa | | | po |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 1,728,419,467.52 | | |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit, Njësia e Menaxhimi të projektit*

**Tenderuesit e skualifikuar:**
Bashkimi i kompanive " T&M.Ç".
Arsyet e skualifikimit: S'kualifikuar në fazën e ekzaminimit paraprak si tenderues jo i përgjegjshëm, sepse garancia e ofertes është më pak se ajo e kërkuar (jo 28 ditë pas Vlefshmërisë së Ofertes, siç përcaktohet në DT, klauzola 19.1).
Nga ana e Komisionit të vlerësimit të ofertave mbas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur është shpallur fitues Bashkimin e Operatorëve Ekonomik për Lotin 1 **JV " SA & "T E2 & K I"**, me vlerë **1,653,252,354.45 Lekë pa tvsh**. Për Lotin 2 është shpallur fitues Bashkimin e Operatorëve Ekonomik **"AK shpk & Ci shpk"** me vlerë **585,170,674,20 Lekë pa tvsh.**
Njoftimi i fituesit drejtuar APP është bërë me shkresën nr. 10042, datë 22.12.2016.
Kontrata nr. prot. 9400, për Lotin 1 me Ref. No. MAFCP/W/ICB/004 me fituesin e tenderit Operatorëve Ekonomik për Lotin 1 **JV " SA & "T E2 & K I"**, është lidhur më datë 09.12.2016.
Kontrata nr. prot. 9399, për Lotin 2 me Ref. No. MAFCP/W/ICB/004 me fituesin e tenderit Operatorëve Ekonomik **"AK shpk & Ci shpk"**, është lidhur më datë 09.12.2016.

## 4.4 Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të tenderit "Rehabilitimi i 11 Digave ( në Kukës, Berat, Fier, Korçë, dhe Muriz Thana)"

| **d.** Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: **"Rehabilitimi i 11 Digave ( në Kukës, Berat, Fier, Korçë, dhe Muriz Thana)",** | | |
|---|---|---|
| **1.Urdhër Prokurimi** Nr.122 datë 03.04.2014<br>**2. Procedura e Prokurimit**<br>Tender i hapur ndërkombëtar, parakualifikim | **3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Njësia e Prokurimit e përbër nga<br>M.K<br>E.L<br>E.B | **4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër Nr.430 datë 08.09.2014<br>K.J ( kryetar)<br>E.Z(anëtare)<br>T.D(anëtar) |
| **5.Fondi Limit (pa tvsh)**<br>939,000,000.9 Lek | **6.Oferta fituese (pa tvsh)**<br>923,502,089.01 Lek | **7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>15,497,911.89 Lek |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>29.07.2014 | **9.Burimi Financimit**<br>IBRD<br>(SIDA) 11.1% | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **2 OE**<br>**b**)S'kualifikuar **1 OE**,<br>**c**) Kualifikuar **1 OE** |
| **b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave** | | |
| **14.Lidhja e kontratës**<br>nr.7469, datë 23.10.2014 | **15.**Vlera e kontratës (me tvsh)<br>1,108,202,506.81 Lek | **16.**Likuiduar deri datë 06.01.2018 shuma<br>1,105,683,765.01 Lek |
| **17- Situacioni**<br>**IPC 7** | **18.Afati i kontratës në dite**<br>365 ditë | **19. Zgjatja e kontratës**<br>**1. Addendum 1 (**Shtesa numër 1) , nr.17469/1, datë 19.11.2014, ndryshime në paragrafin 2 të kontratës, Pika 14.2(b) Norma e amortizimit të pagesës së paradhënies dhe Pika 14.17 Shtohet Llogaria Bankare për Pagesën. |

Në tendër kanë dorëzuar dokumentacion:

| **Nr.** | **Operatori ekonomik** | **Data e dorëzimit të dokumentacionit** |
|---|---|---|
| 1 | JV T E 2 shpk & S A | 09.09.2014 |
| 2 | O I T E S ve T A | 09.09.2014 |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit, Njësia e Menaxhimi të projektit*

**Raporti i vlerësimit**:
Në këtë tender kanë marrë pjesë sa vijon:

| **Nr.** | **Operatori ekonomik** | **Cmimi i paraqitur** | **Verifikimi Po/jo** | **Pranueshmëria Po/Jo** | **Sigurimi Ofertës Po/Jo** | **Plotësia Ofertës Po/Jo** | **Reagimi Po/jo** | **Vlerësim i detajuar Po/jo** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | JV T E 2 shpk & S A | 923,500,908.46 | Po | Po | Po | Po | Po | Po |
| 2 | OI TES ve T A | 669,365,746.00 | Jo | Po | Po | Jo | Jo | Jo |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit, Njësia e Menaxhimi të projektit*

Nga ana e Komisionit të vlerësimit të ofertave mbas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur është shpallur fitues Operatori Ekonomik JV T E 2 shpk & S A, me vlerë 923,500,908.46 Lek. Komisioni i vlerësimit kontrolloi preventivet për gabime arithmetike dhe korrigjimi rezultoi në një shtesë prej 1,180.56 Lek. Shuma e korrigjuar e Ofertës është 923,502,089.01Lek. Miratimi nga Banka Botërore i ofertës është marrë më datë 23.09.2014.
Njoftimi i fituesit është bërë me shkresën nr. 6851, datë 30.09.2014.
Garancia e kontratës është lëshuar nga UBA AG nr.8813G1409257, Datë 21.08.2014
Kontrata MAFCP/W/ICB/003 me nr.7469, me fituesin e tenderit është lidhur më datë 23.10.2014.
Punimet e rehabilitimit kanë filluar të shoqëruara me deklaratat paraprake të fillimi të punimeve në komunat përkatëse siç specifikohet në Rregulloren e Zhvillimit të Territorit.
Afati kohor i përcaktuar për përfundimin e punimeve 12 muaj.

### 4.5 Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të tenderit " Shërbime mbikëqyrje për Rehabilitimin e Digave"

<table>
<tr><td colspan="3">e. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Shërbime mbikëqyrje për Rehabilitimin e Digave",</td></tr>
<tr><td>1.Urdhër Prokurimi Nr.244 datë 22.05.2014</td><td rowspan="2">3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br><br>Grupi i punës për rishikimin e TOR<br>A V<br>E.B<br>L.B<br>E.J<br>G.L<br><br>Njësia e Prokurimit<br>M.K</td><td rowspan="2">4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br><br>Urdhër Nr.332 datë 25.06.2014 dhe<br>Urdhër Nr.493 datë 20.10.2014<br><br>K.J<br>E.Z<br>T.D</td></tr>
<tr><td>2. Procedura e Prokurimit<br><br>Quality and Cost-Based Selection (QCBS)<br>Përzgjedhje e bazuar në cilësi dhe kosto</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| | E.L<br>M K | |
| **5.Fondi Limit**<br>300,000 Euro (kursi i 139.17)<br>41,751,000 Leke | **6.Oferta fituese**<br>45,989,589.22 Lek | **7. Diferenca me fondin limit**<br>4,238,589.22 ( mbi) |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>15.09.2014 | **9.Burimi Financimit**<br>IBRD<br>(SIDA) 11.1% | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **3OE**<br>**b**)S'kualifikuar **1 OE**,<br>**c**) Kualifikuar **2 OE** |
| **b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave** | | |
| **14.Lidhja e kontratës**<br>nr.8149, datë 24.11.2014 | **15.**Vlera e kontratës (me tvsh)<br>143,266.00 Euro Pa Tvsh<br>26,051,260.00 ALL Pa Tvsh<br>9,197,917.84 Tvsh | **16.** Likuiduar deri datë 06.01.2018<br>138,925 Euro<br>26,615,157 ALL<br>9,189,922 TVSH |
| **17- Fatura Tatimore**<br>**12** | **18.Afati i kontratës në dite**<br>730 ditë | **19. Zgjatja e kontratës**<br><br>**Ska** |

Ftesa për ofertë i është dërguar subjekteve të mëposhtëme:

| **Nr.** | **Operatori ekonomik** | **Numër protokolli/date** |
|---|---|---|
| 1 | S.C S (Italy) | 6436/1 datë 15.09.2014 |
| 2 | S ing. G. P S.r.l (Italy) | 6436/2 datë 15.09.2014 |
| 3 | JV G P I GmbH and C (Germany), AP E (Albania), A A C (Albania) | 6436/3 datë 15.09.2014 |
| 4 | JV SYE and C (Turkey), II CE (Albania) | 6436/4 datë 15.09.2014 |
| 5 | H (Germany) | 6436/5 datë 15.09.2014 |
| 6 | JV E E (France), TIS I (Turkey) | 6436 datë 15.09.2014 |
| **Nr.** | **Operator ekonomik në Stand-by** | **Date** |
| 1 | A (Canada) | 6438 datë 15.09.2014 |
| 2 | JV E (Spain), CM Albania | 6734/1 datë 15.09.2014 |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit/ Njësia e Menaxhimi të projektit*

Mbas sqarimeve të dhëna për kërkesat e tenderit kanë paraqitur propozime nga 3 subjektet e interesuara sa vijon:

| **Nr.** | **Operatori ekonomik** | **Datë** | **Pranuar Po/Jo** | **Kualifikuar Po/Jo** | **Pikët** | **Cmimi i Propozuar** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | JV SYE and C (Turkey), IICE (Albania) | 23.10.2014<br>Nr.7441 | Po | Po | 87.54 | 99,700.00 Euro<br>34,210,900.00ALL |
| 2 | JV EE (France), TIS Inc (Turkey) | 21.10.2014<br>Nr.7406 | Po | Jo | ______ | ______ |
| 3 | JV G P I GmbH and C (Germany), AP El (Albania), A A b C (Albania) | 23.10.2014<br>Nr.7443 | Po | Po | 97.20 | 143,266.00 Euro<br>26,051,260.00ALL |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit/ Njësia e Menaxhimi të projektit*

***Gjetje nga auditimi:***

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes:** | **Ritenderimi i Shërbimeve të mbikëqyrjes për Rehabilitimin e Digave** |
| **Situata:** | Paketa "Shërbime mbikëqyrje për Rehabilitimin e Digave", me fondin prej 232.400 Euro është tenderuar dy herë dhe në të dy rastet ka dështuar, pavarësisht se interesi i firmave në të parin ishte i lartë (34 firma) si dhe në të dytin janë ftuar po ato. Procedura e parë ka dështuar për rrjedhojë të vlerës shumë të ulët të fondit limit ndërsa e dyta për arsye se propozimi teknik i kompanisë së vetme që u paraqit në garë nuk kaloi pragun e minimumit të pikëve teknike.<br>Me datë 22.05.2014 Banka Botërore miratoi ri tenderimin e kësaj pakete me kusht rishikimin e termave të referencës, kërkesës për shprehje interesi dhe buxhetit duke sugjeruar rritjen e buxhetit me të paktën 25%, duke ndikuar në zhvillim normal të procedurës finale. Fituesi në këtë procedurë, pavarësisht se është oferta më e ulët, është 4,238,589.22 lekë mbi koston e vlerësuar. |
| **Kriteri:** | Udhëzuesit e përzgjedhjes dhe punësimit të konsulentëve të Bankës Botërore |
| **Ndikimi/Efekti:** | Shtyrje me 17 muaj e procedurës së prokurimit të mbikqyrjes së punimeve dhe për rrjedhojë, ndikim në lidhjen e kontratës së punëve civile. |
| **Shkaku:** | Mosllogaritje e saktë e kostos së mbikqyrjes. |
| **Rëndësia:** | E mesme |
| **Rekomandimi:** | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në projektet me financime të huaja që do të zhvillohen në të ardhmen për mbikqyrje të punimeve civile, t'ì përmbahet Udhëzuesit e përzgjedhjes dhe punësimit të konsulentëve të Bankës Botërore në përllogaritjen e vlerësimit të kostos. |

Më datë 22.05.2014 Banka Botërore miratoi ri tenderimin e kësaj pakete me kusht rishikimin e termave të referencës, kërkesës për shprehje interesi dhe buxhetit duke sugjeruar rritjen e buxhetit me të paktën 25%. Me urdhrin Nr. 244 datë 22.05.2014 u ngrit grupi i punës që rishikoi TOR dhe përgatiti detajimin e kostos. Kosto e këtij shërbimi është vlerësuar me një minimum të fondit të nevojshëm për realizimin e shërbimit prej 300 000 Euro, dhe kjo vlerë është thjeshtë një parashikim, pasi kosto reale e këtij shërbimi do të përcaktohet mbi bazën e proporcioneve teknike dhe ekonomike që do të paraqiten nga kompanitë që do të ftohen.

Aprovimi i Bankës për rihapjen e tenderit është dhënë më 22.05.2014 me kusht rishikimin e Termat e referencës, buxhetit, Kerkesës për Propozime etj. No Objection përfundimtar për Termat e Rishikuara të References dhe dokumentave të tjera për paketën " Shërbime mbikëqyrje për Rehabilitimin e Digave", është marrë më datë 14.07.2014.

Publikimi për shprehje interesi për Shërbime mbikëqyrje për Rehabilitimin e Digave është kryer më datë 22.05.2014 me afat përfundimtar për dorëzimin e shprehjes së interesit datën 23.06.2014.

Shprehje interesi kanë dorëzuar 27 Operatore Ekonomike nga të cilët janë përzgjedhur në listën e shkurtër 6 Operatorë kryesorë dhe 2 Operatorë shtesë në rast se firmat e shortlistuara kryesore vendosin të mos dorëzojnë ofertë.
Lidhur me raportin e përzgjedhjes në listën e shkurtër të kompanive Banka ka refuzuar dy herë të jap aprovimin me no objection. Si rrjedhoje kanë ndodhur ndryshime në përzgjedhjen e kompanive për këtë listë. Më datë 13.09.2014 pas dorëzimit të raportit të tretë të rishikuar banka ka dhënë aprovimin me no objection lidhur me raportin e përzgjedhjes së firmave. Nga 6 Operatoret e përzgjedhur në listën e shkurtër vetëm 3 arritën të dorëzojnë propozimin e tyre brenda datës se përcaktuar. Nga tre kompanitë që dorëzuan dokumentacion, 2 u kualifikuan për vlerësim te mëtejshëm.
Mbas vlerësimit të kryer Njoftimi i fituesit dhe ftesa për negocimin e kontratës është bërë me shkresën nr. 7691/3, datë 06.11.2014.
Me urdhër nr. 7875 datë 10.11.201 është ngritur grupi i negocimit të kontratës me konsulentin i përbërë nga KJ, E.Z dhe TD.
Miratimi nga Banka Botërore draft kontratës së negociuar është marrë më datë 21.11.2014.
Njoftimi për efektivitetin e kontratës është bërë me shkresën Nr. 8177 date 24.11.2014
Njoftimi i fituesit është bërë me shkresën nr. 8247, datë 26.11.2014.
Kontrata MAFCP/W/ICB/002b me nr.8149, me fituesin e tenderit JV G P I GmbH and C (Germany), APand El (Albania), A A b C (Albania)) është lidhur më datë 24.11.2014 me vlerën 45,989,589.22 Lek ose 330,000 Euro.
Afati kohor i përcaktuar për përfundimin e kontratës është 24 muaj.

### 4.6 Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të tenderit "Shërbimet e Supervizionit për punimet e ujitjes dhe kullimit"

| **f.** Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: **"Shërbimi i Supervizionit për punimet e ujitjes dhe kullimit",** | | |
|---|---|---|
| **1.Urdhër Prokurimi** Nr.535 datë 18.11.2015 dhe Nr.535/1 datë 18.11.2015<br><br>**2. Procedura e Prokurimit**<br><br>Quality and Cost-Based Selection (QCBS)<br>Përzgjedhje e bazuar në cilësi dhe kosto | **3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br><br>Grupi i punës për përgatitjen e kërkesës për shprehje interesi<br>M.K<br>E.L<br>L K<br><br>Grupi i punës për përgatitjen e TOR<br>L.B<br>A.V<br>E Z | **4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br><br>Urdhër Nr.605 datë 22.12.2015<br><br>L.B<br>T.D<br>E.Z<br><br>Urdher Nr.408 datë01.08.2016<br>L.B<br>L. K<br>T. D |
| **5.Fondi Limit**<br>**106,795,000 Lekë me TVSH**<br>775,000 Euro ( kursi 137.8) | **6.Oferta fituese**<br>**103,425,438 Lekë me TVSH**<br>290,939.50 Euro pa TVSH<br>46,177,288.50 All pa TVSH<br>17,156,686.23 TVSH | **7. Diferenca me fondin limit**<br>**3,369,562 Lekë me TVSH** |

| 8. Data e hapjes së tenderit | 9.Burimi Financimit | 10.Operatoret Ekonomike |
|---|---|---|
| 16.06.2016 | IBRD<br>(SIDA) 11.1% | **a)**Pjesëmarrës në tender **5OE**<br>**b**)S'kualifikuar **1 OE**,<br>**c**) Kualifikuar **4 OE** |
| **b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave** | | |
| **14.Lidhja e kontratës**<br>nr.10022, datë 22.12.2016 | **15.**Vlera e kontratës (me tvsh)<br>290,939.50Eur pa TVSH<br>46,177,288.50 ALL pa TVSH<br>17,156,686.23 TVSH | **16.** Likuiduar deri datë 06.01.2018<br>200,039 Euro<br>33,725,793 ALL pa TVSH<br>9,189,922 TVSH |
| **17- Fatura**<br>**2** | **18.Afati i kontratës në dite**<br>20 muaj-608 dite | **19. Zgjatja e kontratës**<br><br>**S'ka** |

Ftesa për ofertë i është dërguar subjekteve të mëposhtë me:

| Nr. | Operatori ekonomik | Numër protokolli/date |
|---|---|---|
| 1 | JV GG & Co. EKG (Germany) & GA Sh.p.k S (Albania) | 4681 datë 15.06.2016 |
| 2 | E E(France) | 4681/1 datë 15.06.2016 |
| 3 | T I ES. (Turkey) | 4681/2 datë 15.06.2016 |
| 4 | JV H S.p.A (Italy),BI (France), D C & P C (Sub-Consultant) | 4681/3 datë 15.06.2016 |
| 5 | H I ( Netherlad) | 4681/3 datë 15.06.2016 |
| 6 | JV T S.p.a (Italy), SCE S.r.l ( Italy) | 4681/4 datë 15.06.2016 |
| 7 | JV P P E (Italy), C C C (Italy) | 4681/6 datë 28.06.2016 |
| 8 | JV SY C& E & CCE Gmbh, IIC E. | 4681/7datë 30.06.2016 |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit/ Njësia e Menaxhimi të projektit*

Mbas sqarimeve të dhëna për kërkesat e tenderit kanë paraqitur propozime nga 5 subjektet e interesuara sa vijon:

| Nr | Operatori ekonomik | Datë | Pranim Po/Jo | Kualifikim Po/Jo | Pikët Teknike | Cmimi i paraqitur | Piket Financ | Piket Totale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | JV T S.p.a (Italy), SC E S.r.l ( Italy) | 2.08.2016 Nr.6046 | Po | Po | 83.4 | 580,350.00Eur pa TVSH Taksa Lokale indirekte: 116,070.00Euro | 100 | 88.38 |
| 2 | JV P P E (Italy), C CC (Italy) | 2.08.2016 Nr.6047 | Po | Po | 83.84 | 659,375.00Eur pa TVSH Taksa Lokale indirekte: 98,906.00Eur | - | - |
| 3 | JV GG & Co. E (Germany) & G A(Albania) | 2.08.2016 Nr.6044 | Po | Po | 88.32 | 290,939.50Eur pa TVSH 46,177,288.50 All pa TVSH Taksa Lokale direkte dhe indirekte: 58,187.90 Eur 9,235,457.70All | 92.10 | 89.45 |
| 4 | JV H(Italy),BI (France), D | 2.08.2016 | Po | Po | 86.12 | 208, 690.00 Eur | 95.60 | 88.96 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | C & P C | Nr.6038 | | | | 55,477,840All pa TVSH | | |
| 5 | T IE S Inc. (Turkey) | 2.08.2016<br>Nr.6045 | Po | Po | 89.82 | 751,760.00 Eur<br>Taksa Lokale indirekte:<br>20,521,120.00 All | 77.20 | 86.03 |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit/ Njësia e Menaxhimi të projektit*

Më datë 18.11.2015 me urdhër Nr.535 është ngritur grupi i punës për përgatitjen e kërkesës për shprehje interesi për procedurën e tenderimit MAFCP/CS/005 "Shërbimet e Supervizionit për punimet e ujitjes dhe kullimit" i përbërë nga:

- M.K-Specialiste pranë sektorit të prokurimit , Drejtoria Juridike
- E.L- konsulente prokurimi, Projekti i burimeve ujore dhe ujitjes
- L. K-specialist pranë sektorit të kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja

Po më datë 18.11.2015 me urdhër Nr. 535/1 është ngritur grupi i punës për përgatitjen e termave të referencës për procedurën e tenderimit MAFCP/CS/005 "Shërbimet e Supervizionit për punimet e ujitjes dhe kullimit" i përbërë nga:

- L.B-Kryetar
- A.V- Anëtar
- E.Z-Anëtar

Kërkesa për shprehje interesi ëshë publikuar online më datë 01.12.2015 dhe i është dërguar për botim Agjensisë së Prokurimit Publik me datë 02.12.2015 me Nr 9301. Afati përfundimtar për dërgimin e kërkesave ka qënë data 23.12.2015.
Termat e referencës janë dërguar Menaxherit të Projektit Të Burimeve Ujore dhe Ujitjes me datë 21.12.2015 me Nr. 9806.
Shprehje interesi kanë dorëzuar 17 Operatore Ekonomike. Me urdhër të brëndshëm Nr. 605 datë 22.12.2015 është krijuar grupi punës i vlerësimit i cili vlerësoi shprehjet e interesit dhe janë përzgjedhur në listën e shkurtër 6 Operatorë kryesorë dhe 2 Operatorë shtesë në rast se firmat e shortlistuara kryesore vendosin të mos dorëzojnë ofertë.

Me Urdhër Nr. 605 datë 22.12.2015 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga:

- L.B
- T.D
- E.Z

Raporti për përzgjedhjen e listës së shkurtës i është dërguar bankës më datë 12.01.2016, i është ridërguar më 18.04.2016 dhe 15.06.2016 dhe është marrë no objection nga Banka me 15.06.2016.
Më datë 16.06.2016 Subjekteve të parapërzgjedhur iu janë derguar Ftesat për Oferta. Data përfundimtare për dorëzimin e Ofertave fillimisht ka qëne 18.07.2016. Me pas me Amendment 1, 2 , 3 dhe 4 si pasojë e mos dorëzimit te ofertave nga disa kompani si H dhe E dhe dërgimit të ftesave kompanive në listë pritje, ky afat është shtyrë për 1.08.2016 dhe 02.08.2016.
Me Urdhër Nr.408 datë 01.08.2016 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga:

- L.B

- L. K
- T. D

Me 16.09.2016 Komisioni i vlerësimit ka dorëzuar raportin e vlerësimit teknik të ofertave për aprovim tek Banka, e cila ka dhënë aprovimin e saj më 19.09.2016. Hapja publike e propozimeve financiare është bërë më 22.09.2016. Më 28.09.2016 komisioni i vlerësimit i ka dërguar për aprovim Bankës raportin e vlerësimit të kombinuar tekniko-financiar.

Me shkresën nr. 7085/2, datë 28.09.2016 JV GG& Co. E K(Germany) & GA Sh.p.k është njoftuar se është renditur i pari si rezultat i vlerësimit tekniko-financiar dhe është njoftuar për takimin negociues të kontratës që do të zhvillohej me 04.10.2016. Me urdhër Nr. 494 datë 29.09.2016 është ngritur grupi i negocimit të kontratës.
Njoftimi i fituesit është bërë me shkresën nr. 10043, datë 22.12.2016.
Kontrata MAFCP/W/CS/005 me nr.10022, me fituesin e tenderit është lidhur më datë 22.12.2016. Afati kohor i përcaktuar për përfundimin e shërbimeve është 20 muaj.

***Gjetje nga auditimi:***

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes 1:** | **Përbërja e grupit të përgatitjes së TOR dhe KVO** |
| **Situata:** | Për këtë procedure prokurimi gjatë auditimit është konstatuar se dy anëtarë të grupit të punës për përgatitjen e termave të referencës janë edhe anëtare të komisionit të vlerësimit të ofertave. |
| **Kriteri:** | Nenin 58 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 |
| **Ndikimi/Efekti:** | Shkelje procedure. |
| **Shkaku:** | Mosnjohje e legjislacionit të fushës përkatëse. |
| **Rëndësia:** | E ulët |
| **Rekomandimi:** | Ekipi i Menaxhimit të Projektit të marrë masa që në vazhdimësi të mos lejojë ngritjen e Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave, të cilët në përbërje kanë punonjës të caktuar paraprakisht si pjesë e njësisë së prokurimit për të njëjtën procedurë prokurimi. |

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes 2:** | **Inventarizimi i dosjeve të prokurimit** |
| **Situata:** | Për të gjitha procedurat e prokurimit të sipërpërmendura, dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar dhe arkivuar. |
| **Kriteri:** | Neni 3 e 29 të "Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat" |
| **Ndikimi/Efekti:** | Shkelje procedure. |
| **Shkaku:** | Mosnjohje e legjislacionit të fushës përkatëse. |
| **Rëndësia:** | E ulët |
| **Rekomandimi:** | Nga ana e Ekipi i Menaxhimit të Projektit të merren masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve dhe dokumenteve të procedurave të prokurimit publik, në zbatim të Normave Tekniko Profesionale dhe |

Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

**4.7 Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të tenderit MEFWA/G/004a me objekt: "Pajisje hardware për Qendrën e Kadastrës së Ujit"**

Nga auditimi rezultoi që:
Me anë të Urdhrit Nr. 59 me nr. 696 prot datë 27.01.2016 të Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHRAU, është ngritur njësia e prokurimit për përgatitjen e dokumentave të tenderit, për mallrat që do të blihen për procedurën e tenderimit MEFWA/G/004a "Pajisje hardware për Qendrën e Kadastrës së Ujit". Njësia e prokurimit është e përbërë nga E.R, specialiste pranë sektorit të prokurimit, A.Z me detyrë specialist IT dhe G.L me detyrë specialiste në Drejtorinë Juridike.
Ftesa për ofertë është shpallur në dy gazeta të përditshme si dhe i është dërguar Agjensisë së Prokurimit Publik. Njësia e prokurimit ka përfunduar hartimin e dokumentave dhe specifikimeve të tenderit në datën 28.03.2016.
Me Urdhrin nr 242 me nr 3161/1 prot datë 26.04.2016 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga A.P, me detyrë Drejtor i Politikave të Burimeve Ujore, A.DH me detyrë specialist IT pranë drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe I.Ç me detyrë specialist pranë Drejtorisë së Politikave të Burimeve Ujore. Për këtë procedurë prokurimi morën pjesë në garë 2 operatorë ekonomikë me ofertat si më poshtë:

| | Ofertuesi | Vlera në lekë me TVSH |
|---|---|---|
| 1 | C P | 32,755,296 |
| 2 | "P"shpk | 33,180,000 |

Në datën 18.11.2016 është dhënë aprovimi i Bankës në lidhje me vazhdimin e procedurës.
Në datën 21.11.2016 me shkresën me nr 8879 prot të Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHRAU, është njoftuar operatori fitues për shtim të sasisë së mallrave të prokuruar, dhe për ndryshimin e vlerës totale të kontratës nga 33,180,000 lekë me TVSH në 36,338,100 lekë me TVSH.
Kontrata për sa më sipër është lidhur në datën 24.11.2016. Ndërkohë që operatori ekonomik i skualifikuar ""CP"shpk", është njoftuar në datën 05.12.2016, ose 11 ditë pas firmosjes së kontratës me operatorin, *veprim i cili e bën të pavlefshme ankesën* e tij dërguar me email në datën 08.12.2016 dhe protokolluar me nr 9484 prot në datën 12.12.2016, për sa i përket arsyeve të skualifikimit. Në lidhje me këtë ankesë, është hartuar një Draft me përgjigjen për këtë operator dhe i është dërguar fillimisht Bankës, nga ku është marrë aprovimi në lidhje me këtë Draft përgjigje. Për sa më sipër, operatorit ""CP"shpk" i është dërguar përgjigja me shkresën nr 9991 prot datë 21.12.216.
Me Urdhrin nr. 605 datë 09.12.2016 me nr 9396 prot është ngritur grupi i marrjes në dorëzim të mallrave i përbërë nga T. O, A.DH, A.G dhe F.F. Marrja në dorëzim është bërë në datën 21.12.2016, pasqyruar kjo me shkresën me nr 9962 prot datë 21.12.2016 mbajtur nga komisioni i ngritur për marrjen në dorëzim të pajisjeve.

Nga Auditimi u konstatua se nuk ka një referencë në lidhje me vlerësimin e specifikimeve teknike. Gjatë vlerësimit të ofertave të operatorëve, KVO në raportin e vlerësimit shprehet për devijime të vogla apo të mëdha kundrejt specifikimeve teknike të pajisjeve të ofruara. Por për këtë vlerësim nuk ka një bazë apo referencë lidhur me përcaktimin nëse këto devijime janë të vogla apo të mëdha duke bërë që vlerësimi të jetë jo plotësisht objektiv.

Dosja për këtë procedurë prokurimi nuk është e inventarizuar dhe arkivuar, veprim në kundërshtim me nenin 3 e 29 të "Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat", ku citohet:
*"Neni 3*
*Pranë çdo subjekti shtetëror e joshtetëror funksionon sekretaria dhe arkivi apo sekretari-arkivi, pjesë strukturore që përgjigjet për administrimin e dokumenteve të krijuara, apo të ardhura në adresë të tij. Në mungesë të një strukture të veçantë, me urdhër me shkrim të titullarit të institucionit, ngarkohet një punonjës për punën me dokumentet.*
*Neni 29*
*Mbi kapakun e dosjes (Mod. 6) shkruhet me bojë apo shtypet pastër dhe sipas rregullave të drejtshkrimit: emërtimi i plotë zyrtar i organit shtetëror apo joshtetëror, sektori apo dega e veprimtarisë, shkalla e klasifikimit sekret (nëse dokumenti është i tillë), numri i dosjes, viti, titulli i plotë i dosjes, afati i ruajtjes, datat ekstreme, sasia e dokumenteve që ka dosja, numri i inventarit të dosjes dhe afati i shfrytëzimit. Titulli i dosjes pasqyron drejt e në mënyrë të përmbledhur përmbajtjen e dokumenteve që përfshihen në të, është i qartë dhe i plotë dhe përmban llojin e dokumenteve që përfshihen në dosje, emërtimin e autorit të dokumenteve, emërtimin e korrespondentit, çështjen (objektin) së cilës i referohet përmbajtja e dokumenteve dhe, sipas rastit, vendin dhe datën që përmbajnë dokumentet. Në rast se dosja përbëhet nga disa vëllime (fraksione) me përmbajtje të njëllojtë, të gjitha vëllimeve u vihet një titull i përbashkët, duke shtuar në vëllimin e fundit shënimin: "vëllimi i fundit". Në përshkrimin e dosjeve me dokumente që kanë vlerë të veçantë, theksohet dhe qenia e tyre në origjinal apo kopje dhe mënyra e riprodhimit (dorëshkrim, daktilografim, fotokopje etj.)".*

| **a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Hardware për Qendren e Kadastrës së Ujrave"** | | |
|---|---|---|
| **1.Urdhër Prokurimi**<br>**Nr. 59, datë 27.01.2016**<br>**2. Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>**NCB** | **3. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit**<br>Urdhër Nr. 59, dt.27.01.2016<br>znj. E.R<br>z. AZ<br>znj. G L | **4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave**<br>Urdhër Nr. 242, dt.26.04.2016<br>z. A.P<br>znj.A.DH<br>znj. I C |
| **5. Fondi Limit – (pa tvsh)**<br>241,380 Euro | **6.Oferta fituese (pa tvsh)**<br>219,067 Euro | **7.Diferenca me fondin limit – (pa tvsh)**<br>22,313 Euro |
| **8. Data e hapjes së tenderit** 28.04.2016 | **9. Burimi Financimit**<br>IBRD + SIDA | **10. Operatorët Ekonomike**<br>**a)** Pjesëmarrës në tender **2 OE**<br>b) S'kualifikuar 1 OE (faza paraprake)<br>c) Kualifikuar 1 OE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**-1 | **12. Përgjigje Ankesës**- nga AK<br>Po | **13.Përgjigje** Ankesës nga APP - |

| | | |
|---|---|---|
| **APP–; KPP-** | | |
| **b. Zbatimi i KontratësPunimeve/Shërbimeve/Mallrave** | | |
| **14. Lidhja e kontratës**<br>Nr. 9015, Datë 24.11.2016 | **15. Vlera e kontratës (me tvsh)**<br>**36,338,100 Lekë** | **16. Likuiduar deri dt. 06.07.2017**<br>**Lekë 36,338,100**<br>**Pa likuiduar -** |
| **17-Situacioni Përfundimtar/FaturëMalli/Shërbiminr.6581 & 6582, dt. 20.12.2016** | **18. Afati i kontratës në dite**<br>Parashikuar 90 ditë<br>Zbatuar 90 ditë | **19. Zgjatja e kontratës: -**<br>Amendimi nr. - |
| **22. Akt Kolaudimi -** | **23. Akti i marrjes në dorëzim** Nr. 9962, dt. 21.12.2016 | **24.** Fletë Hyrja Nr 30, datë 21.12.2016 |

***Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:***
1) Për skualifikimin e operatorit ekonomik "“CP"shpk" nuk është marrë opinioni i Bankës.
2) Kontrata me operatorin e shpallur fitues është lidhur në datën 24.11.2016. Ndërkohë që operatori ekonomik i skualifikuar "“CP"shpk", është njoftuar në datën 05.12.2016, ose 11 ditë pas firmosjes së kontratës me operatorin.
3) Nuk ka një referencë në lidhje me vlerësimin e specifikimeve teknike.
4) Dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar sipas legjislacionit në fuqi.

***Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:***
1) Ligjit 89/2013 "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmejt Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes", i ndryshuar.
2) Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e regullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
3) Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".
4) Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

***Gjetje nga auditimi:***

**Titulli i Gjetjes 1:** Skualifikim pa marrë miratimin e bankës.
**Situata:** Autoriteti Kontraktor (MBZHR) nuk ka marrë opinionin paraprak të bankës për skualifikimin e operatorit ekonomik "“CP"shpk".Njësia e prokurimit nuk ka njoftuar APP.
**Kriteri:** Ligjit 89/2013 "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmejt Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes", i ndryshuar.
**Ndikimi/Efekti**: Efekt financiar negativ në vlerën **424,704 lekë**.
**Shkaku:** Ndryshim në interpretimin e ligjit.
**Rëndësia**: E lartë.
**Rekomandime**: Në vazhdimësi Ekipit i Menaxhimit të Projektit, përpara se të vazhdojë me hapat e tjerë të procedurës së prokurimit, të marrë miratimin paraprak të Bankës Botërore për çdo

skualifikim të mundshëm të operatorëve ekonomik për shkak të kualifikimeve apo specifikimeve teknike.

**Titulli i Gjetjes 2:** Njoftim i vonuar i operatorit të skualifikuar.
**Situata:** Kontrata e lidhur me operatorin "P"shpk në procedurën e prokurimit me objekt "Pajisje hardware për Qendrën e Kadastrës së Ujit" është lidhur në datën 24.11.2016. Ndërkohë që operatori ekonomik i skualifikuar "CP"shpk, është njoftuar në datën 05.12.2016, ose 11 ditë pas firmosjes së kontratës me operatorin, *veprim i cili e bën të pavlefshme të drejtën e ankimimit* e tij.
**Kriteri:** Kodit të Procedurave Administrative/
**Ndikimi/Efekti**: Pavlefshmëri e ankimimit të operatorit ekonomik.
**Shkaku:** -
**Rëndësia**: E mesme.
**Rekomandime**: Në vazhdimësi Ekipit i Menaxhimit të Projektit të respektojë të drejtat e operatorëve ekonomik të përcaktuar në Kodin e Procedurës Administrative për ankimim administrativ duke lënë një afat kohor të mjaftueshëm përpara lidhjes së kontratave.

**Titulli i Gjetjes 3:** Mungesa e referencave të sakta të specifikimeve teknike.
**Situata:** Nga Auditimi i procedurave të prokurimit u konstatua se nuk ka një referencë në lidhje me vlerësimin e specifikimeve teknike. Në raportin e vlerësimit të ofertave të operatorëve, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave shprehet për devijime të vogla apo të mëdha kundrejt specifikimeve teknike të pajisjeve të ofruara. Por për këtë vlerësim nuk ka një bazë apo referencë lidhur me përcaktimin nëse këto devijime janë të vogla apo të mëdha duke bërë që vlerësimi të jetë jo plotësisht objektiv.
**Kriteri:** Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e regullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
**Ndikimi/Efekti**: Subjektivitet në vlerësimin e specifikimeve teknike.
**Shkaku:** Mosnjohje e detajuar e ligjit për prokurimin publik
**Rëndësia**: E mesme.
**Rekomandime**: Në vazhdimësi Ekipi i Menaxhimit të Projektit, të kërkojë nga Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të ngritura për qëllimet e projektit, referenca të sakta të vlerësimit të specifikimeve teknike duke shmangur subjektivitetin dhe duke qënë më transparent kundrejt operatorëve ekonomik.

**Titulli i Gjetjes 4:** Mungesa e inventarizimit të dosjeve.
**Situata:** Nga auditimi u konstatua se të gjitha dosjet e prokurimeve nuk janë të inventarizuara dhe arkivuara**.**
**Kriteri:** "Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".
**Ndikimi/Efekti**: Risk në menaxhimin e dokumentave të dosjeve.
**Shkaku:** Mosnjohje e këtij detyrimi ligjor/
**Rëndësia**: E ulët.

**Rekomandime**: Nga ana e Ekipi i Menaxhimit të Projektit të merren masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve dhe dokumenteve të procedurave të prokurimit publik, në zbatim të Normave Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

### 4.8 Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të tenderit MAFCP/G/001 me objekt: "Blerje e pajisjeve kompjuterike dhe softe për Bordet e Kullimit dhe MBZHRAU"

Nga auditimi rezultoi që:
Me anë të Urdhrit Nr. 97 me nr. 2007 prot datë 24.03.2014 të Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHRAU, është ngritur njësia e prokurimit për përgatitjen e specifikimeve teknike, ftesës për kuotim dhe listës së furnitorëve për mallrat që do të blihen për procedurën e tenderimit MAFCP/G/001 "Blerje e pajisjeve kompjuterike dhe softe për Bordet e Kullimit dhe MBZHRAU". *Për këtë procedurë nuk ka një shkresë ku të jetë shprehur nevoja për këto mallra*. Njësia e prokurimit është e përbërë nga A.DH dhe A.Z, me detyrë specialist IT dhe G.L me detyrë specialist në Drejtorinë Juridike. Afati për përgatitjen e specifikimeve teknike, ftesës për ofertë dhe listës së furnitorëve është data 26.03.2014. *Në e-mailin dërguar grupit të punës, konstatohet se bashkëlidhur janë specifikimet teknike të kërkuara për tu hartuar nga njësia e prokurimit, veprim i cili duhet të ishte kryer nga kjo e fundit.* Nga njësia e prokurimit është hartuar dokumenti i cili përmban specifikimet teknike, ftesën për kuotim dhe listën e furnitorëve, por ky dokument nuk ka datë dhe grupi i auditimit nuk mund të vlerësojë zbatimin apo jo të afatit të vendosur për këtë. Me emailin e datës 01.04.2014 i janë dërguar Bankës Botërore për të marrë miratimin e tyre për të vazhduar më tej me procedurën e prokurimit. Kjo e fundit ka dhënë miratimin e saj në datën 03.04.2014 duke ndryshuar vetëm 3 kërkesa të cilat më pas janë pasqyruar në këto dokumenta. Në datën 08.04.2014 i është dërguar ftesë për ofertë 8 kompanive, saktësisht: DD, IO, STA, AC GmbH, IS shpk, C&CS, "P"shpk dhe FTS. Nga auditimi u konstatua se nuk ka asnjë argumentim për përzgjedhjen e këtyre kompanive. *Sipas pikës 4 të ftesës për ofertë, afati i fundit për dorëzimin e ofertave është data 28.04.2014, ndërkohë që komisioni për vlerësimin e ofertave është ngritur në datën 29.04.2014* me Urdhrin nr. 200 të me nr. 3035 prot të Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHRAU, pas kërkesës së Drejtorit të Projektit në datën 24.04.2014. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është i përbërë nga K.J, A.DH dhe A.Z. Në datën 06.05.2014 komisioni ka hartuar raportin përfundimtar të vlerësimit të ofertave nga ku renditen 4 operatorë ekonomikë me ofertat e tyre si më poshtë:

| | | |
|---|---|---|
| 1 | "P"shpk | 9,075,000 |
| 2 | C shpk | 9,109,958 |
| 3 | IS shpk | 9,263,167 |
| 4 | STA | 9,338,002 |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit/ Njësia e Menaxhimi të projektit*

Nga renditja e mësipërme dhe sipas verifikimit të dokumentave të paraqitura nga operatorët, Komisioni për Vlerësimin e Ofertave ka shpallur fitues operatorin "P"shpk me ofertë ekonomike 9,075,000 lekë pa TVSH.

Në datën 08.05.2014 ka ardhur "No Objection" nga Banka dhe në datën 13.05.2014 është njoftuar operatori për të kryer provën e mallrave të ofruar. Po në këtë datë është lidhur kontrata ndërmjet OE dhe Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHRAU.
Me anë të Urdhrit Nr. 275 datë 29.05.2014 me nr. 3783 prot është ngritur komisioni për marrjen e mallrave në dorëzim i përbërë nga G.L, A.DH dhe A.Z, Nga ana e komisionit është mbajtur çertifikata e pranimit me nr. 4502 prot datë 25.06.2014.
Nga auditimi u konstatua gjithashtu se 2 nga 3 anëtarët e hartimit të specifikimeve teknike janë edhe pjesë e komisionit të vlerësimit të ofertave, veprim në kundërshtim me Nenin 58 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku citohet: *"Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës. Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave…".*

Nga Auditimi u konstatua se nuk ka një referencë në lidhje me vlerësimin e specifikimeve teknike. Gjatë vlerësimit të ofertave të operatorëve, KVO në raportin e vlerësimit shprehet për devijime të vogla apo të mëdha kundrejt specifikimeve teknike të pajisjeve të ofruara. Por për këtë vlerësim nuk ka një bazë apo referencë lidhur me përcaktimin nëse këto devijime janë të vogla apo të mëdha duke bërë që vlerësimi të jetë jo plotësisht objektiv.

Dosja për këtë procedurë prokurimi nuk është e inventarizuar dhe arkivuar, veprim në kundërshtim me nenin 3 e 29 të "Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat", ku citohet:
*"Neni 3*
*Pranë çdo subjekti shtetëror e joshtetëror funksionon sekretaria dhe arkivi apo sekretari-arkivi, pjesë strukturore që përgjigjet për administrimin e dokumenteve të krijuara, apo të ardhura në adresë të tij. Në mungesë të një strukture të veçantë, me urdhër me shkrim të titullarit të institucionit, ngarkohet një punonjës për punën me dokumentet.*
*Neni 29*
*Mbi kapakun e dosjes (Mod. 6) shkruhet me bojë apo shtypet pastër dhe sipas rregullave të drejtshkrimit: emërtimi i plotë zyrtar i organit shtetëror apo joshtetëror, sektori apo dega e veprimtarisë, shkalla e klasifikimit sekret (nëse dokumenti është i tillë), numri i dosjes, viti, titulli i plotë i dosjes, afati i ruajtjes, datat ekstreme, sasia e dokumenteve që ka dosja, numri i inventarit të dosjes dhe afati i shfrytëzimit. Titulli i dosjes pasqyron drejt e në mënyrë të përmbledhur përmbajtjen e dokumenteve që përfshihen në të, është i qartë dhe i plotë dhe përmban llojin e dokumenteve që përfshihen në dosje, emërtimin e autorit të dokumenteve, emërtimin e korrespondentit, çështjen (objektin) së cilës i referohet përmbajtja e dokumenteve dhe, sipas rastit, vendin dhe datën që përmbajnë dokumentet. Në rast se dosja përbëhet nga disa vëllime (fraksione) me përmbajtje të njëllojtë, të gjitha vëllimeve u vihet një titull i përbashkët, duke shtuar në vëllimin e fundit shënimin: "vëllimi i fundit". Në përshkrimin e dosjeve me dokumente që kanë vlerë të veçantë, theksohet dhe qenia e tyre në origjinal apo kopje dhe mënyra e riprodhimit (dorëshkrim, daktilografim, fotokopje etj.)".*

***Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:***
1) Anëtarë të Njësisë së Prokurimit janë vendosur edhe në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave.
2) Nuk ka një referencë në lidhje me vlerësimin e specifikimeve teknike.
3) Dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar sipas legjislacionit në fuqi.
***Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:***
5) Ligjit 89/2013 "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmejt Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes", i ndryshuar.
6) Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e regullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
7) Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".
8) Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

***Gjetje nga auditimi:***

**Titulli i Gjetjes 1:** Anëtarë të njëjtë në njësi prokurimi dhe KVO
**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Blerje e pajisjeve kompjuterike dhe softe për Bordet e Kullimit dhe MBZHRAU" u konstatua se 2 nga 3 anëtarët e hartimit të specifikimeve teknike janë edhe pjesë e komisionit të vlerësimit të ofertave.
**Kriteri:** VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar**.**
**Ndikimi/Efekti**: Konflikt interesi.
**Shkaku:** Mosnjohje e detajuar e VKM Nr. 914.
**Rëndësia**: E mesme.
**Rekomandime**: Ekipi i Menaxhimit të Projektit të marrë masa që në vazhdimësi të mos lejojë ngritjen e Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave, të cilët në përbërje kanë punonjës të caktuar paraprakisht si pjesë e njësisë së prokurimit për të njëjtën procedurë prokurimi.

**Titulli i Gjetjes 2:** Mungesa e referencave të sakta të specifikimeve teknike.
**Situata:** Nga Auditimi i procedurave të prokurimit u konstatua se nuk ka një referencë në lidhje me vlerësimin e specifikimeve teknike. Në raportin e vlerësimit të ofertave të operatorëve, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave shprehet për devijime të vogla apo të mëdha kundrejt specifikimeve teknike të pajisjeve të ofruara. Por për këtë vlerësim nuk ka një bazë apo referencë lidhur me përcaktimin nëse këto devijime janë të vogla apo të mëdha duke bërë që vlerësimi të jetë jo plotësisht objektiv.
**Kriteri:** Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e regullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
**Ndikimi/Efekti**: Subjektivitet në vlerësimin e specifikimeve teknike.
**Shkaku:** Mosnjohje e detajuar e ligjit për prokurimin publik
**Rëndësia**: E mesme.
**Rekomandime**: Në vazhdimësi Ekipi i Menaxhimit të Projektit, të kërkojë nga Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të ngritura për qëllimet e projektit, referenca të sakta të vlerësimit të

specifikimeve teknike duke shmangur subjektivitetin dhe duke qënë më transparent kundrejt operatorëve ekonomik.

**Titulli i Gjetjes 3:** Mungesa e inventarizimit të dosjeve.
**Situata:** Nga auditimi u konstatua se të gjitha dosjet e prokurimeve nuk janë të inventarizuara dhe arkivuara**.**
**Kriteri:** "Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".
**Ndikimi/Efekti**: Risk në menaxhimin e dokumentave të dosjeve.
**Shkaku:** Mosnjohje e këtij detyrimi ligjor/
**Rëndësia**: E ulët.
**Rekomandime**: Nga ana e Ekipi i Menaxhimit të Projektit të merren masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve dhe dokumenteve të procedurave të prokurimit publik, në zbatim të Normave Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

### 4.9 Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të tenderit MEFWA/G/003 me objekt: "Blerje automjetesh"

*Nga auditimi u konstatua se:*
Me urdhrin nr. 698 datë 23.07.2013 protokolluar me nr. 5393 datë 23.07.2013 është ngritur grupi për hartimin e specifikimeve teknike dhe detajimin e fondit limit me antare G. M, drejtor i politikave të ujit, kryetar, A. Sh, specialist në sektorin e GIS, anëtare F.B, specialist i mirembajtjes, anëtarë.
Me shkresën nr. 5393/1 datë 19.8.2013 është nxjerrë urdhri i prokurimit nr. 698/1 datë 19.08.2013 për blerje automjetesh për zyrat e RBM me numër kontrate: MEFWA/G/003 me fond limit 157,370 euro vënë në dispozicion nga fondet e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes, komponenti 3 për "Blerje automjetesh për zyrat e RBM". Lloji I procedurës së prokurimit është tender I hapur ndërkombëtar (NCB) në të cilin janë përcaktuar gjithashtu edhe KVO me anëtarë, D.G, manaxher I projektit, kryetar, F.B, specialist I mirëmbajtjes, anëtarë V.D, specialist në sektorin e planifikim-manaxhimit, anëtarë dhe njësia e hartimit të dokumenteve-D.G, manaxher i projektit, R.L, specialist në sektorin e GIS M.Z, konsulente prokurimi.
Pas miratimit të dokumenteve të tenderit nga Banka Botërore, ftesa pë rofertë është publikuar në dy gazeta të shtypit të përditshëm si dhe I është dërguar Agjensisë së Prokurimit Publik.

Për këtë procedurë prokurimi ka paraqitur ofertën e tij vetëm një ofertues konkretisht GAA në shumën 21,556,800 ALL, ofertë e cila edhe është kualifikuar nga KVO si dhe në datë 25.04.2014 është lidhur kontrata ndërmjet sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe GAA.
Në bazë të dokumenteve të tenderit afati i dorzimit të mallit duhet te jete 30 ditë nga lidhja e kontratës, afat i cili në bazë të fletëhyrjeve në magazine është përmbushur. Sigurim i tenderi për ofertuesit duhet në shumën 420.000 ALL ose në një monedhë tjetër me të njëjtën vlerë. Me

shkresën nr. 5214 datë 23.04.2014 është nxjerrë urdhri nr. 768 datë 23.04.2014 i ministrit të mjedisit është ngritur komisioni për verifikimin dhe marrjen në dorzim të mallrave te kontratës I pëbëre nga T.Gj me detyrë përgjegjëse e shërbimeve mbështetëse në cilësinë e kryetares së komisionit, A.H magaziniere ne sëktorin e shërbimeve mbështetëse, anëtare dhe A.T shofer, antarë.

Për këtë procedurë data e hapjes së tenderit 08.10.2013 është shtyrë tre herë pasi gjatë periudhës së përgatitjes së ofertave janë dorëzuar katër kërkesa për sqarime në lidhje me specifikimet teknike, për rrjedhojë edhe dokumenti i tenderit është ndryshuar tre herë dhe data e dorëzimit dhe hapjes së ofertave është shtyrë po tre herë deri në 28.01.2014. Me shkresën nr. 4619 datë 09.04.2014 të Ministrisë së Mjedisit është bërë njoftimi i fituesit.

| **a.ZhvillimiiProcedurëssëProkurimit me objekt: "Makina per zyrat e menaxhimit te baseneve te lumenjve"** | | |
|---|---|---|
| **1.UrdhërProkurimiNr. 698/1, dt. 19.08.2013**<br>**2. LlojiiProcedurëssëProkurimit**<br>**NCB** | **3.Hartuesit e SpecifikimeveTeknike**<br>UrdhërNr. 698, dt. 23.07.2013<br>z. G.M<br>z.A. Sh<br>z. F.B<br>**Hartuesit e Dokumentave**<br>Urdhër Nr. 698/1, dt.19.08.2013<br>z. D.G<br>zj.R.L<br>zj. M.Z | **4.Komisioni i Vlerësimit Të Ofertave**<br>UrdhërNr. Nr. 698/1, dt.19.08.2013<br>z. D.G<br>z.F.B<br>zj.V.D |
| **5.Fondi Limit – Kostoja eVleresuar (pa tvsh)**<br>157,370 Euro | **6.Oferta fituese (pa tvsh)**<br>127,794 Euro | **7.Diferenca me fondin limit – koston e vleresuar (pa tvsh)**<br>29,576 Euro |
| **8. Data e hapjessëtenderit**28.01.2014 | **9.Burimi Financimit**<br>SIDA | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrësnë tender Numër**1 OE**<br>b)S'kualifikuar<br>c) Kualifikuar 1 OE |
| **11.Ankimime**<br>**AK-**<br>**APP**–; **KPP-** | **12. PërgjigjeAnkesës**nga AK | **13.Përgjigje**Ankesësnga APP |
| **b.ZbatimiiKontratësPunimeve/Shërbimeve/ Mallrave** | | |
| **14. Lidhja e kontratës**<br>Nr. 4619/1, Datë25.04.2014 | **15. Vlera e kontratës (me tvsh)**<br>**21,556,800 Leke** | **16.Likuiduarderidt.09.06.2014**<br>**Lekë 21,556,800**<br>**Pa likuiduar -** |
| **17-Situacioni Përfundimtar/FaturëMalli/Shërbimi**<br>**Nr. 534; 535;536;537; dt 23.05.2014** | **18.Afati ikontratësnëdite**<br>Parashikuar1 month<br>Zbatuar1 muaj | **19. Zgjatja e kontratës: -**<br>Amendimi nr. - |
| **22.AktKolaudimi** datë - | **23.Akti marrjes në dorëzim** Nr. 6269, dt. 23.05.2014 | **24**. FletëHyrjaNr42, datë 23.05.2014 |

***Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:***

1) Anëtarë të Njësisë së Prokurimit janë vendosur edhe në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave.
2) Dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar sipas legjislacionit në fuqi.

***Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:***

9) Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e regullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
10) Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".
11) Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

***Gjetje nga auditimi:***

**Titulli i Gjetjes 1:** Anëtarë të njëjtë në njësi prokurimi dhe KVO
**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Blerje Makina per zyrat e menaxhimit të baseneve të lumenjve" u konstatua se 1 nga 3 anëtarët e hartimit të specifikimeve teknike është pjesë e komisionit të vlerësimit të ofertave, gjithashtu edhe një prej antarëve të hartimit të dokumenteve të tenderit është pjesë e komisionit të vlerësimit të ofertave.
**Kriteri:** VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar**.**
**Ndikimi/Efekti**: Konflikt interesi.
**Shkaku:** Mosnjohje e detajuar e VKM Nr. 914.
**Rëndësia**: E mesme.
**Rekomandime**: Ekipi i Menaxhimit të Projektit të marrë masa që në vazhdimësi të mos lejojë ngritjen e Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave, të cilët në përbërje kanë punonjës të caktuar paraprakisht si pjesë e njësisë së prokurimit për të njëjtën procedurë prokurimi.

**Titulli i Gjetjes 2:** Mungesa e inventarizimit të dosjeve.
**Situata:** Nga auditimi u konstatua se dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar dhe arkivuar**.**
**Kriteri:** "Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".
**Ndikimi/Efekti**: Risk në menaxhimin e dokumentave të dosjeve.
**Shkaku:** Mosnjohje e këtij detyrimi ligjor/
**Rëndësia**: E ulët.
**Rekomandime**: Nga ana e Ekipi i Menaxhimit të Projektit të merren masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve dhe dokumenteve të procedurave të prokurimit publik, në zbatim të Normave Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

**4.10 Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të tenderit "Mobilje për Bordet e Kullimit"**

Nga auditimi u konstatua:

Më datë 10.04.2014 me urdhërin Nr.149 është ngritur njësia e prokurimit për përgatitjen e specifikimeve teknike, ftesës për kuotim dhe listës së furnitorëve për mallrat që do të blihen me procedurën e tenderimit MAFCP/G/004. Ekzistojnë dy Shpallje të Kërkesës për Shprehje Interesi, njëra ka afat datën 14.05.2014 ora 12:00 dhe e dyta ka afat datën 30.05.2014 ora 14:00. Nuk ekziston asnjë sqarim pse janë shpallur dy kërkesa për shprehje interesi. Me shkresën Nr. 2445/1 datë 24.06.2014 njësia e prokurimit ka dërguar specifikimet teknike dhe shprehjet e interesit për këtë procedure tenderimi. Shprehje interesi për këtë procedure kanë dërguar 4 kompani si më poshtë:

| | |
|---|---|
| 1 | A sh.p.k ( Albania) |
| 2 | O& C sh.p.k (Albania) |
| 3 | K sh.p.k (Albania) |
| 4 | AS S sh.p.k ( Albania) |

Më 30.07.2014 grupi i punës përgatiti ftesën për kuptim (ITQ)-Blerje mallrash. Më 3.09.2014 me shkresën Nr. 6207 i dërgohet për botim agjencisë së prokurimit publik kërkesa për shprehje interesi. Më 3.09.2014 me shkresën Nr. 6207/2 i dërgohet për botim Gazetës Sh.com kërkesa për shprehje interesi me afat 14.09.2014. Me 3.09.2014 me shkresën Nr.6207/1 dërgohet për botim gazetës KJ Ftesa për Ofertë. Shprehje interesi për këtë procedure kanë dërguar 2 kompani.

| | |
|---|---|
| 1 | R sh.p.k (Albania) |
| 2 | E sh.p.k (Albani) |

Ftesa për kuotim i është dërguar kompanive të mëposhtme:

| Nr. | Operatori ekonomik | Numër protokolli/date |
|---|---|---|
| 1 | A sh.p.k (Albania) | 7270/3 datë 16.10.2014 |
| 2 | O sh.p.k (Albania) | 7270/2 datë 16.10.2014 |
| 3 | AS S sh.p.k ( Albania) | 7270/4 datë 16.10.2014 |
| 4 | E sh.p.k (Albania) | 7270/5 datë 16.10.2014 |
| 5 | K sh.p.k (Albania) | 7270/1 datë 16.10.2014 |
| 6 | R sh.p.k ( Albania) | 7270/0 datë 16.10.2014 |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit/ Njësia e Menaxhimi të projektit*

Me urdhër Nr. 503 datë 29.10.2014 është ngritur komisioni për vlerësimin e kujtimeve të furnitoreve të ftuar në tender.Me shkresën Nr. 8181 datë 25.11.2014 dërgohet nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për miratim dhe shqyrtim Raporti i vlerësimit .

Nga auditimi u konstatua se 2 nga 3 anëtarët e hartimit të specifikimeve teknike janë edhe pjesë e komisionit të vlerësimit të ofertave, veprim në kundërshtim me Nenin 58 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku citohet:

*"Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës. Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave…".*

Miratimi i Raportit të Vlerësimit është marrë me shkresën 8181/1 datë 3.12.2014 nga sekretari i përgjithshëm.

| Nr. | Operatori e Ftuar | Operatoret qe kane derguar kuotim | Data e marrjes se kuotimit | Çmimi me TVSH |
|---|---|---|---|---|
| 1 | A sh.p.k | A sh.p.k | 28.10.2014 | 2,219,000 |
| 2 | O sh.p.k | O sh.p.k | 28.10.2014 | 2,159,000 |
| 3 | ASS sh.p.k | ASS sh.p.k | 28.10.2014 | 3,304,000 |
| 4 | E sh.p.k | | | |
| 5 | K sh.p.k | K sh.p.k | 28.10.2014 | 1,820,000 |
| 6 | R sh.p.k | R sh.p.k | 29.10.2014 | 1,843,200 |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit/ Njësia e Menaxhimi të projektit*

Ofertuesi me çmim më të ulët është K sh.p.k dhe çmimi i kontratës është 1,820,000 Lek me TVSH. Data e parashikuar e lidhjes së kontratës është 02.12.2014. Me letër Nr. 8417 datë 04.12.2014 Operatorit K sh.p.k i është dërguar Njoftimi për fituesin e kontratës. Kontrata është lidhur midis Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujit dhe K shpk me 9.12.2014. Më 11.12.2014 i është dërguar Bankës Kopje e firmosur e kontratës. Më 15.12.2014 me shkresën Nr. 8682 i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik për botim njoftimi i Shpalljes se Fituesit. Me 17.12.2014 i dërgohet letra e njoftimit të fituesve operatoreve te tjerë pjesëmarrës në tender.

| Nr. | Operatori ekonomik | Numër protokolli/date |
|---|---|---|
| 1 | A sh.p.k (Albania) | 8791/2 datë 17.12.2014 |
| 2 | O sh.p.k (Albania) | 8791 datë 17.12.2014 |
| 3 | ASS sh.p.k ( Albania) | 8791/1 datë 17.12.2014 |
| 4 | R sh.p.k ( Albania) | 8791/3 datë 17.12.2014 |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit/ Njësia e Menaxhimi të projektit*

| **a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Mobilje per Bordet e Kullimit"** | | |
|---|---|---|
| **1.Urdhër Prokurimi Nr. 149, datë 10.04.2014**<br>**2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Shopping** | **3.Hartuesit e Specifikimeve Teknike**<br>Urdhër Nr. 149, dt.10.04.2014<br>znj. A.I<br>z. T. O<br>znj. A.E | **4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>UrdhërNr. 503, dt. 29.10.2014<br>znj. A.I<br>znj.G.L<br>z. T. O |
| **5.Fondi Limit – Kostoja e Vleresuar (pa tvsh)** | **6.Oferta fituese (pa tvsh)**<br>10,889 Euro | **7.Diferenca me fondin limit – koston e vleresuar (pa tvsh)** |

| | | |
|---|---|---|
| 20,664 Euro | | 9,775 Euro |
| **8. Data e hapjes së tenderit** 29.10.2014 | **9.Burimi Financimit** IBRD | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)** Pjesëmarrës në tender Numër **5 OE**<br>b) S'kualifikuar<br>c) Kualifikuar5 OE |
| **11.Ankimime**<br>**AK**-s'ka;<br>**APP**–; **KPP-** | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP |
| **b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave** | | |
| **14. Lidhja e kontratës**<br>Nr. 8530, Datë 08.12.2014 | **15. Vlera e kontratës (me tvsh)**<br>**1,820,000 Lekë** | **16.Likuiduar deri dt.20.01.2015**<br>**Lekë 1,820,000** |
| **17-Situacioni Përfundimtar/FaturëMalli/Shërbimi Nr. 35, dt 24.12.2014**<br>**-Vlera me tvsh 1,820,000 lekë**<br>**-Vlera pa tvsh 1456000 lekë** | **18.Afati i kontratës në dite**<br>Parashikuar 1 muaj<br>Zbatuar 3 jave | **19. Zgjatja e kontratës:** |
| **22.Akt Kolaudimi** | **23.Akt i marrjes në dorëzim**<br>Nr. 504, dt. 19.01.2015 | **24**. Fletë Hyrja Nr 30 datë 30.12.2014 |

***Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:***

1) Anëtarë të Njësisë së Prokurimit janë vendosur edhe në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave.
2) Dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar sipas legjislacionit në fuqi.

***Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:***

12) Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e regullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
13) Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".
14) Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

***Gjetje nga auditimi:***

**Titulli i Gjetjes 1:** Anëtarë të njëjtë në njësi prokurimi dhe KVO

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Blerje Mobilje per Bordet e Kullimit" u konstatua se 2 nga 3 anëtarët e hartimit të specifikimeve teknike janë pjesë e komisionit të vlerësimit të ofertave.

**Kriteri:** VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar**.**

**Ndikimi/Efekti**: Konflikt interesi.

**Shkaku:** Mosnjohje e detajuar e VKM Nr. 914.

**Rëndësia**: E mesme.

**Rekomandime**: Ekipi i Menaxhimit të Projektit të marrë masa që në vazhdimësi të mos lejojë ngritjen e Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave, të cilët në përbërje kanë punonjës të caktuar paraprakisht si pjesë e njësisë së prokurimit për të njëjtën procedurë prokurimi.

**Titulli i Gjetjes 2:** Mungesa e inventarizimit të dosjeve.
**Situata:** Nga auditimi u konstatua se dosja e prokurimit nuk është e inventarizuar dhe arkivuar**.**
**Kriteri:** "Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".
**Ndikimi/Efekti**: Risk në menaxhimin e dokumentave të dosjeve.
**Shkaku:** Mosnjohje e këtij detyrimi ligjor/
**Rëndësia**: E ulët.
**Rekomandime**: Nga ana e Ekipi i Menaxhimit të Projektit të merren masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve dhe dokumenteve të procedurave të prokurimit publik, në zbatim të Normave Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

## 5. Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra e shërbime, për periudhën nga fillimi i zbatimit të projektit.

### 5.1 Zbatimi i punimeve të kontatës me objekt "Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)" Loti 1.

***Nga verifikimi i dokumentacionit në dosje rezultoi që:***
*Punimet civile inxhinierike, për rehabilitimin e skemave ujitëse janë realizuar në përputhje me projektin e zbatimit si dhe kushtet teknike të zbatimit.*

Mbi auditimin e zbatimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të zbatimit të kontratave për punime civile, mallra dhe shërbime të kontratatës me objekt "Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)" Loti 1, rezultoi:

**A. Mbi nënshkrimin e kontratës së zbatimit të punimeve inxhinierike dhe konsulencës/mbikëqyrësit të punimeve, addendumet, variation order dhe realizimin e grafikut të punimeve si dhe miratime leje të ndryshme.**

**A.1 Mbi nënshkrimin e kontratës së zbatimit dhe shërbimit të konsulencës.**

- Objekti i mësipërm është realizuar sipas kontratës së nënshkruar me datë 09.12.2016 me nr. prot. 9400, me objekt; "Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse në Bashkitë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll" ndërmjet shoqërisë **"JV S" A & "TE 2" Sh.p.k Albania & "K I S ve t L ST"** përfaqësues z. I.T dhe z. M.M në cilësinë e personave të autorizuar të BOE dhe **Ministrisë së**

**Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujit** me përfaqësues z. V.B me vlerë të kontratës **1,983,633,832.36** lekë me TVSH.

Në lotin 1, janë parashikuar të ndërtohen skemat e ujitjes si vijon:

1- Skema e ujitjes Murriz Thana, Dega Krutje me vlerë 655,827,880.02 lekë pa TVSH.

2- Skema e ujitjes Murriz Thana, Dega Tërbuf, me vlerë 478,302,869.39 lekë pa TVSH.

3- Skema e ujitjes Strum-Kurjan, me vlerë 373,153,068.99 lekë pa TVSH.

4- Skema e ujitjes Koshnica, me vlerë 68,529,521.57 lekë pa TVSH.

Referuar marrëveshjes së BOE me datë 13.10.2016 me Ref No. 1901dhe Kol No. 241 është rënë dakort që BOE "S" A & "TE 2" Sh.p.k Albania & "K I S ve t L ST" të përfaqësohet nga shoqëria "TE 2" Sh.p.k Albania me përfaqësues z. I.T dhe sipas pikës 5 të marrëveshjes shoqëria "SA" Austria do të realizoj 40% të punimeve të ndërtimit sipas preventivit të miratuar, shoqëria "TE 2" Sh.p.k Albania do të realizojë 35% të punimeve të ndërtimit sipas preventivit të miratuar ndërsa "K I S ve t L ST" do të realizojë 25% të punimeve të ndërtimit sipas preventivit të miratuar.

- Mbikëqyrja/supervizimi i punimeve civile për objektin "Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)" Loti 1 është bërë nga **JV "GG&CE KG" (Leader, Germany) & "GAlbania" (Member, Albania) (The Consultant, Ref. No. MAFCP/CS/004, Loti 1)** sipas kontratës së nënshkruar me datë 22.12.2016:

- Në vijim të nënshkrimit të kontratave të punimeve civile dhe kontratës për shërbimet e supervizionit janë lëshuar Urdhrat e Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave për ngritjen e grupit të punës dhe detyrat për administrimin dhe menaxhimin e kontratave të mësipërme, respektivisht:

Urdhër Nr. 652, datë 27.12.2016 "Për ngritjen e Grupit të Punës dhe detyrat për administrimin dhe menaxhimin e kontratës me Numër Reference MAFCP/Ë/ICB/004, me objekt "Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Me vendndodhje në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll", Loti1;

Urdhër Nr. 654, datë 27.12.2016 "Për ngritjen e Grupit të Punës dhe detyrat për administrimin dhe menaxhimin e kontratës me Numër Reference MAFCP/CS/005. me objekt " Shërbimet e supervizionit për punimet për Vaditjen dhe Kullimin";

- Sipas Amendment No .1 të mbajtur me datë 07 Dhjetor 2016, është rënë dakort që:

Shoqëria "SA" Austria, të përfaqësohet nga z. I.T dhe z. M.M; shoqëria "TE 2" Sh.p.k Albania të përfaqësohet nga z. I.T në cilësinë e Menaxherit Teknik dhe z. M.M në cilësinë e Menaxherit Tregtar si dhe shoqëria "K I S ve t L ST" përfaqësues z. I.T dhe z. M.M.

### A.2 Grupi i projektimit të projektit.

Projekti i zbatimit **"Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)"** është projektuar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik (Në vijim, BOE) Shoqëria "R-BS" dhe shoqëria "HA" me Drejtues Ligjor z. N.Ç dhe Drejtues Teknik znj. A.B.

### A.3 Afati i përfundimit të punimeve.

Koha e përfundimit të punimeve është 8 muaj dhe periudhë garancie 365 ditë. Kontrata e zbatimit për rehabilitimin e 5 skemave ujitje (Lokalizuar në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll) Loti ,1është nënshkruar me datë 09.12.2016. Ngritja e kantierit si dhe 4 zyrat për lotin 1, janë bërë me datë 22.12.2016. Referuar ditarit të punimeve si dhe Completion Report/Raportit të përfundimit të punimeve, punimet e ndërtimit kanë filluar me datë 04.01.2017 dhe kanë përfunduar në shtator dhe tetor 2017.
Sigurimi i kontratës është 10 % e çmimit të kontratës finale. Zbatimi i punimeve ka pësuar zgjatje bazuar në kushtet e kontratës, për shkak të sezionit të ujitjes, bazuar në pikën 8.4 të kushteve të veçanta të kontratës.

### A.4 Mbi kryerjen e oponencës teknike të projektit të zbatimit.

Për projektet e zbatimit me objekt: Skema ujitëse "Dega Krutje", "Dega Tërbuf" dhe skema ujitëse me "Rezervuarin Kurjan-Strum" është kryer oponencë teknike nga Instituti i Ndërtimit, Tiranë me shkresën Nr. Prot. 274/2, datë 02.08.2016. Grupi i oponencës përbëhet nga inxhinierët: E.T, M.Sh, E.Z, B.Gj, A.D dhe R.F.

### A.5 Miratime leje zhvillimore/ndërtimi, mjedisore, etj..

Konstatojmë se sipas territorit ku do të investohet nga Bashkitë përkatëse është vendosur miratimi i deklaratës për kryerje punimesh, në mbështetje të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, si dhe nenit 20 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar.

### B. Nga auditimi mbi disbursimet rezulton.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi disbursimet e punimeve të ndërtimit të kontrates me objekt **"Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)"** Loti 1, esh0074 realizuar sipas tabelës:

| ITEM | **Bugjeti fillestar** | **Bugjeti Revizionuar** | **IPC No.1 December 2016 (Paradhenie 10%)** | **IPC No.2 February 2017** | **IPC No.3 March 2017** | **IPC No.4 April- May 2017** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Total KRUTJE BRANCH/TOTALI DEGA KRUTJE | 655,827,880.02 | 675,487,322.32 | 65,582,788.00 | 102,373,471.00 | 112,081,065.68 | 78,045,763.47 |
| Total TERBUF BRANCH/ TOTALI TERBUF | 478,302,869.39 | 493,717,261.22 | 47,830,286.94 | 34,411,216.00 | 45,722,385.02 | 30,087,416.43 |
| Total KURJAN-STRUM / Totali KURJAN-STRUM | 373,153,068.99 | 391,504,827.24 | 37,315,306.90 | 21,548,081.00 | 23,080,184.11 | 113,411,448.71 |
| Total KOSHNICA / Totali KOSHNICE | 68,529,521.57 | 76,652,325.26 | 6,852,952.16 | | | 16,881,659.96 |
| **Totali** | 1,575,813,339.97 | 1,637,361,736.04 | 157,581,334.00 | **158,332,768.00** | **180,883,634.81** | **238,426,288.57** |
| **Add Provisional Sum for Contingency Alloëance (0.01%) / Fond rezerve** | 77,214,853.66 | 15,666,457.60 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Total | **1,653,028,193.63** | **1,653,028,193.64** | **157,581,334.00** | **158,332,768.00** | **180,883,634.81** | **238,426,288.57** |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit/ Njësia e Menaxhimi të projektit*

| IPC No.5 August 2017 | IPC No.6 October 2017 | IPC No.7 November 2017 | IPC No.8 December 2017 | Totali | Diferenca qe nuk eshte perdorur |
|---|---|---|---|---|---|
| 30,140,910.45 | 55,371,268.08 | 162,184,463.60 | 135,160,763.42 | 675,357,705.70 | 129,616.62 |
| 37,701,623.56 | 56,972,629.21 | 149,273,134.66 | 139,448,705.79 | 493,617,110.67 | 100,150.55 |
| 61,838,192.35 | 99,156,451.04 | 69,437,886.39 | 0.00 | 388,472,243.60 | 3,032,583.64 |
| 29,137,429.65 | 30,625,214.38 | 0.00 | 0.00 | 76,644,303.99 | 8,021.27 |
| 158,818,156.01 | 242,125,562.71 | 380,895,484.65 | 274,609,469.21 | 1,634,091,363.96 | 3,270,372.08 |
| 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 15,666,457.60 |
| **158,818,156.01** | **242,125,562.71** | **380,895,484.65** | **274,609,469.21** | **1,634,091,363.96** | **18,936,829.68** |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit/ Njësia e Menaxhimi të projektit*

Praktikat e disbursimit janë shoqëruar me IPC-të; Librezat e masave dhe vizatimet sipas skemave:

## C. Mbi auditimin e dokumentacionit teknik të zbatimit dhe realizimit të punimeve në terren.

Nga auditimi në terren mbi verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezulton:
Përmbledhje e skemave:

| Emri i skemës | Zona e projektuar e ujitjes totale (ha) | Projekti i ujitjes me gravitet (ha) | Projekti i ujitjes me pompim (ha) |
|---|---|---|---|
| **Murriz Thana-Krutje Branch** | 10,800 | 10,800 | |
| **Murriz Thana-Terbuf Branch** | 4,680 | 4,180 | 500 |
| **Kurjani** | 5,430 | 4,730 | 700 |
| **Divjaka** | 2,630 | 2,130 | 500 |
| **Koshnica** | 850 | 350 | 500 |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit/ Njësia e Menaxhimi të projektit*

### C.1 Skema ujitëse Murriz Thana - Dega e Tërbufit.

Skema ujitëse e Murriz Thana është projektuar të punojë si një sistem ujitës me kanale të hapur edhe pas rehabilitimit të saj. Rehabilitimi i kësaj skeme ka për qëllim vënien në përdorim me kapacitet të plotë të furnizuar me anën e kanalit të Tërbufit me një sipërfaqe të përgjithshme që ujitet prej këtij kanali rreth 4000 ha. Kjo skemë paraqet në vetvete një skemë relativisht të madhe, ku do të rehabilitohen rreth 32 km kanale kryesore dhe rreth 75 km sekondare.

Punimet për rehabilitimin e kanalit kryesor dhe dytësor kanë përfunduar me datë 22 Nëntor 2017.
Po përgatitet dokumentacioni i dorëzimit brenda 28 ditëve. Kompletimi i punimeve brenda kontekstit të Lotit 1 ka përfunduar.
- Referuar instalimit të shtresës së betonit, janë vërejtur dëmtime të ndryshme si dhe ndërhyrje në kanalin e ri.

### C.2 Skema ujitëse Murriz Thana - Dega e Krutjes.

Skema ujitëse e Murriz Thana është projektuar për t'i shërbyer bujqësisë me anën e kanalit kryesor të Krutjes, i cili furnizohet me ujë nga rezervuari i Thanës. Kjo skemë do të punojë si një sistem ujitës me kanale të hapur edhe pas rehabilitimit të saj. Kanali ujitës kryesor i Krutjes mbulon një sipërfaqe rreth 11000 ha tokë bujqësore, nga të cilat 6900 ha ujiten nga kanali kryesor (U-3) me gjatësi 23573 m, 2600 ha nga dega e djathtë e quajtur V-1 me gjatësi 9811 m dhe 1300 ha nga dega e majtë, e quajtur V-2 me gjatësi 7639 m.
Referuar Draft Raportit Përfundimtar(Nëntor 2017) hartuar nga supervizori "G G & Co. E. KG" gjendja aktuale e punimeve paraqitet e kompletuar, me përjashtim të kanalit kryesor V-2 10+440.6 deri 11+834, sekondarëve V-2-6, 0+000 deri 2+998 dhe V-2-7, 0+000 deri 3+416 si pasojë e pamundësisë për të punuar atje për shkak të rezistencës nga publiku.
Po përgatitet dokumentacioni i dorëzimit brenda 28 ditëve. Kompletimi i punimeve brenda kontekstit të Lotit 1 ka përfunduar.
- Referuar instalimit të shtresës së betonit, janë vërejtur dëmtime të ndryshme si dhe ndërhyrje në kanalin e ri.

### C.3 Skema ujitëse Kurjan - Strum.

Skema ujitëse e Kurjan-Strumit është projektuar të punojë si një sistem ujitës me kanale të hapur edhe pas rehabilitimit të saj. Kjo skemë paraqet në vetvete një skemë relativisht të madhe, e cila ka një shtrirje me gjatësi rreth 45 km nga fshati Velmisht deri në afërsi të qytetit të Fierit. Rrjeti ujitës i kësaj skeme ushqehet nga Rezervuari Kurjanit me kapacitet rreth 28,000,000 $m^3$ ujë. Sipërfaqja që ujitet me këtë rezervuar është rreth 4500 ha, me një gjatësi të rrjetit ujitës rreth 108 km. Kanali kryesor, degët dhe sekondarët janë projektuar për prurje të ndryshueshme në varësi të sipërfaqeve që ujisin. Kanalet sekondarë kontrollojnë përgjithësisht rreth 250 ha.
- Punimet për këtë skemë kanë përfunduar me datë 21 Tetor 2017.

### C.4 Skema ujitëse Koshnica

Nga puseta e marrjes së rezervuarit të Koshnica 1 tubacioni ka gjatësi 23.5 km dhe punon me gravitet. Punimet civile për rehabilitimin e skemës Koshnica kanë përfunduar me datë 21 Shtator 2017.
Proceset e punëve janëfokusuar në këto aktivitete:

- Hapje e eksesit rrugor përgjatë bankinës së kanalit
- Prerje e pemëve të vogla dhe pastrim përgjatë kanalit nga bimësia
- Gërmim, mbushje dhe rregullim skarpate i kanalit ekzistues
- F.V me beton të bazës dhe skarpateve të kanalit
- Instalimi i shtresës së të betonit

- Ekzekutimi i izolimit të ujit në pikat bashkuese të ndërtimit

Referuar Draft Raportit Përfundimtar (Nëntor 2017) hartuar nga supervizori "G G & Co. E. KG" vihen re disa probleme si:

-Për shkak të kushteve jo të favorshme gjeologjike në zonë ka shumë rrëshqitje të dheut, të cilat kanë ngadalësuar punimet.

-Referuar instalimit të shtresës së betonit, janë vërejtur dëmtime të ndryshme si dhe ndërhyrje në kanalin e ri të ndërtuar.

Referuar Draft Raportit Përfundimtar (Nëntor 2017) hartuar nga supervizori **"G G & Co. E. KG"** me përfundimin e punimeve për Skemën e ujitjes Murriz Thana, Dega Krutje; të skemës së ujitjes Murriz Thana, Dega Tërbuf; të skemës së ujitjes Strum-Kurjan dhe të skemës së ujitjes Koshnica, Bashkimi i Operatorëve Ekonomik **"S" A & "TE 2" Sh.p.k Albania & "K I S ve t L ST"** përfaqësuar nga "TE 2" Sh.p.k Albania nëpërmjet shkresave me Nr. Prot. MAFCP 35 dhe Nr. Prot. MAFCP 37, bazuar në pikën 10.1 të kontratës, ka kërkuar marrjen pjesore në dorëzim të punimeve.

Problematika e konstatuar nga grupi i auditimit mbi mos ngritjen e grupit të kolaudimit të punimeve është marrë konsideratë nga Autoriteti Kontraktor është ngritur grupi i kolaudimit më datën 28.12.2017 me nr. Prot. 562, për Lotin e I.

**5.2 Zbatimi i punimeve të kontatës me objekt "Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)" Loti 2. Skema Ujitëse Divjaka, është pjesë e Projektit "Burimet Ujore dhe Ujitja''.**

*Nga auditimi rezultoi që:*

**1.** Punimevet civile inxhinierike për ndërtimin e Skemës ujitëse Divjaka në raport me grafikun e punimeve të përcaktuar sipas kontratës dhe VO 1, kanë përfunduar në kohë, por konstatohet se aktualisht nuk është kryer testi i funksionimit të pompave dhe i gjithë skemës së ujitjes Divjakë. Mos kryerja e testit ka ndikuar në mos kryerjen e kolaudimit dhe marrjes së përkohshme në dorëzim të investimit të realizuar.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes 1:** | Mos realizimi i testit të funksionimit të stacioneve të pompimit dhe i të gjithë skemës ujitëse të Divjakës |
| **Situata:** | Nga inspektimet në terren mbi zbatimin e punimeve sipas kontratës u konstatua se zërat e punimeve janë realizuar, por mos lidhja e energjisë ka penguar marrjen në dorëzim te veprës. |
| **Kriteri:** | Kontrata dhe FIDIC, kundrejt së cilës krahasohet situata e cila paraqet parregullsi. |
| **Ndikimi/Efekti:** | Objektivi për ndërtimin e skemës së ujitjes dhe kullimit nuk është përmbushur tërësisht. Problematika në mos kryerjen e testit lidhet me mos lidhjen e energjisë elektrike. |
| **Shkaku:** | Përfituesi Bashkia e Divjakës, aktualisht nuk ka mundësuar zgjidhjen e kësaj problematike. |

**Rëndësia:** I Lartë

**Rekomandime**: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Njësia e Implementimit të Projekteve, për zbatimin e kushteve të kontratës mbi"Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)" Loti 2, duhet të marrin masat e nevojshme dhe të bashkërendojnë punën me shoqërinë zbatuese të punimeve "A.K" sh.p.k dhe me mbikëqyrësin e punimeve për kryerjen e testit përfundimtar nga zbatuesi i punimeve të funksionimit të skemës së kombinuar të dy stacioneve të pompimit, me qëllim bërjen efektive të skemës së ujitjes së Divjakës me sipërfaqe 2630 ha, menjëherë pas lidhjes së kontratës së energjisë elektrike të Bashkisë Divjakë me OSSHE, si dhe krijimin e kushteve për kolaudimin dhe marrjes së përkohshme në dorëzim të investimit të realizuar.

**2.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosje për zbatimin e punimeve dhe në veçanti për zërat e ri, rezulton se nuk ka gjetur zbatim pika 12.3.a.i e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës "Vlerësimi" për zërat e punimeve kanë rritur volumet me 25 % krahasuar me volumet fillestare. Referuar pikës 12.3.a.i të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës "Vlerësimi", këto zëra duheshin konsideruar si zëra të rinj pune dhe duhej bërë negocim çmimi, pasi është rritur volumi me më shumë se 25 %.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes 2:** | Mos negocim çmimi për zërat e ri dhe për zërat e punimeve që kanë rritur volumet me 25 % krahasuar me volumet fillestare, në kundërshtim me pikën 12.3.a.i të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës. |
| **Situata:** | Nga inspektimet në terren mbi zbatimin e punimeve sipas kontratës ukonstatua se rërat e punimeve janë realizuar, por nuk janë negociuar çmimet për zërat me rritje volumi. |
| **Kriteri:** | Kontrata dhe FIDIC, kundrejt së cilës krahasohet situata e cila paraqet parregullsi, pika 12.3 e KPK. |
| **Ndikimi/Efekti:** | Negocimi krijonte mundësi për uljen e çmimit të kontratës. |
| **Shkaku:** | Mos njohje e kushteve të përgjithshme të kontratës. |
| **Rëndësia:** | I mesëm |

**Rekomandime**: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Njësia e Implementimit të Projekteve, për zbatimin e kushteve të kontratës mbi"Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)" Loti 2, duhet të marrin masat e nevojshme dhe të bashkërendojnë punën me shoqërinë zbatuese të punimeve "A.K" sh.p.k dhe me mbikëqyrësin e punimeve për përcaktimin me negocim të çmimeve, për zërat e rinj me rritje volumi ≥ 25 % krahasuar me volumin fillestar të preventivit bazë.

**3.** Nga auditimi i realizimit dhe i funksionimit të kanaleve të kullimit u konstatua se, është bërë ri seksionimi dhe profilizimi i i kanaleve të kullimit në veri dhe në jug të Divjakës dhe janë pajisur me struktura të kontrolluara në skajet e tyre sipas projektit të zbatimit dhe ndryshimeve të

propozuara, por u konstatua se disa prej tyre kanë filluar të mbushen me mbetje dhe bimësi, të cilat bëhen pengesë për kullimin e ujit.

**Rekomandime:** Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në zbatim të kushteve të kontratës, të kontrollojë dhe të monitorojë funksionimin e kanaleve të kullimit përgjatë periudhës së garancisë së punimeve.

***Mbi auditimin e zbatimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të zbatimit të kontratës:***
Kontrata me objekt **“Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)” Loti 2, Skema Ujitëse Divjaka,** është pjesë e Projektit **“Burimet Ujore dhe Ujitja’’.**

**A. Mbi nënshkrimin e kontratës së zbatimit të punimeve inxhinierike dhe të kontratës së konsulencës/mbikëqyrësit të punimeve, addendumet, variation order dhe realizimi i grafikut të punimeve si dhe miratime leje të ndryshme.**

**A.1 Mbi nënshkrimin e kontratës së zbatimit dhe shërbimit të konsulencës.**

- Objekti i mësipërm është realizuar sipas kontratës me Ref. No. MAFCP/Ë/ICB/004, nënshkruar me datë 09.12.2016 me Nr. Prot. 9399, me objekt; “Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse në Bashkitë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll” Loti i II-të (Skema Ujitëse Divjaka) ndërmjet BOE **“A.K” sh.p.k Shqipëri** përfaqësues z. Xh.I **& “C” Sh.p.k Albania** përfaqësues z. F.C dhe **Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujit** me përfaqësues z. V.B. Vlera e kontratës është **585,170,674.20** Lekë pa TVSH ose **702,204,809.04** lekë me TVSH.
Referuar marrëveshjes së BOE me datë 05.12.2016 me Nr. 2274 Rep dhe Nr. 755 Kol para Noterit Publik z. D.H, është rënë dakort që BOE të përfaqësohet nga shoqëria “A.K” sh.p.k me përfaqësues z. Xh.I dhe sipas pikës 4 të marrëveshjes shoqëria “A.K” sh.p.k do të realizoj 70% të punimeve të ndërtimit sipas preventivit të miratuar, ndërsa shoqëria “C” sh.p.k do të realizojë 30% të punimeve të ndërtimit sipas preventivit të miratuar.
- Mbikëqyrja/supervizimi i punimeve civile për objektin “Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)” Loti 2: Skema ujitëse Divjaka (Skema ujitëse në Jug dhe Veri) është bërë nga JV “GG&CE KG” (Leader, Germany) & “GR Albania” (Member, Albania) (The Consultant, Ref. No. MAFCP/CS/005, Loti 2):
- Në vijim të nënshkrimit të kontratave të punimeve civile dhe kontratës për shërbimet e supervizionit janë lëshuar Urdhrat e Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave për ngritjen e grupit të punës dhe detyrat për administrimin dhe menaxhimin e kontratave të mësipërme, respektivisht:
Urdhër Nr. 653, datë 27.12.2016 “Për ngritjen e Grupit të Punës dhe detyrat për administrimin dhe menaxhimin e kontratës me Numër Reference MAFCP/Ë/ICB/004, me objekt “Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Me vendndodhje në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll”. Loti 2;

Urdhër Nr. 654, datë 27.12.2016 “Për ngritjen e Grupit të Punës dhe detyrat për administrimin dhe menaxhimin e kontratës me Numër Reference MAFCP/CS/005. me objekt “ Shërbimet e supervizionit për punimet për Vaditjen dhe Kullimin”;

**Paraqitja e ndryshimeve mbi zbatimin e kontratës:**

- MBZHRAU me shkresën me Nr. Prot 6520/1, datë 06.09.2017 aprovon ndryshimet e projektit dhe Variation Order VO Nr. 1 referuar kërkesës në datë 04.09.2017 si dhe miraton kërkesën për shtesë të kohës së përfundimit deri me datë 19 tetor 2017 ( 6 javë). MBZHRAU kërkon nga mbikëqyrësi dhe nga kontraktori, që të ndërmarrin veprimet e nevojshme për përfundimin e punimeve në kohë dhe me cilësi. Punimet shtesë në shumë 24,595,423.92 lekë pa TVSH do të përballohen nga fondi rezervë. VO 1 është nënshkruar nga MBZHRAU, mbikëqyrësi dhe kontraktori me datë 04 shtator 2017.
- Amendment Nr. 3 të kontratës me objekt zgjatjen e kohës së mbarimit të punimeve deri me datë 19 tetor 2017, bazuar në pikat 13;13.1; 13.2 të kushteve të përgjithshme të kontratës, të propozimit të supervizorit sipas VO Nr.1, në letrën me nr. prot. 2017/77, datë 23.08.2017 për ndryshimin/miratimin e projektit. Ky amendament është nënshkruar ndërmjet MBZHRAU përfaqësuar nga z. V.B dhe nga JV “A.K” sh.p.k & “C” sh.p.k përfaqësuar nga z. Xh.I. AK konfirmon se Sigurimi i performancës do të jetë i vlefshëm deri me datë 31.12.2018. Sekretari i përgjithshëm me Nr. Prot. 65/8, datë 05.09.2017 miraton projektin e rishikuar dhe urdhëri për ndryshim Nr. 1 (VO 1).

**A.2 Grupi i projektimit të projektit.**

Projekti i zbatimit “Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)” Loti 2: Skema ujitëse Divjaka (Skema ujitëse në Jug dhe Veri) është projektuar nga BOE, shoqëria “R-BS” dhe shoqëria “HA” me Drejtues Ligjor z. N.Ç dhe Drejtues Teknik znj. A.B.

**A.3 Afati i përfundimit të punimeve.**

Kontrata e zbatimit për rehabilitimin e skemës së Lushnjës, Loti 2, është nënshkruar me datë 09.12.2016. Ngritja e kantierit dhe e zyrave për lotin 2, janë bërë me datë 22.12.2016. Punimet kanë filluar me datë 4 Janar 2017. Koha e përfundimit të punimeve sipas kontratës bazë është 8 muaj ( Datë 04 Shtator 2017). Kërkesa për shtyrje të përfundimit të punimeve nga Mbikëqyrësi është bërë me datë 4 shtator 2017 dhe miratimi nga Autoriteti Kontraktor është bërë me datë 5 Shtator 2017. Periudha e garancie është 365 ditë. Sigurimi i kontratës është 10% e çmimit të kontratës finale.

**A.4 Mbi kryerjen e oponencës teknike të projektit të zbatimit.**

Për projektin e zbatimit me objekt: Skema ujitëse Divjaka **(**Skema ujitëse në Jug dhe Veri) është kryer oponencë teknike nga Instituti i Ndërtimit, Tiranë me shkresën Nr. Prot. 274/2, datë 02.08.2016. Grupi i oponencës përbëhet nga inxhinierët: E.T, M.Sh, E.Z, B.Gj, A.D dhe R.F.

**A.5 Miratime leje zhvillimore/ndërtimi, mjedisore, etj.**

- Bashkia Divjakë Krutje me vendimin nr. 23, datë 17.03.2017 ka vendosur miratimin e deklaratës për kryerje punimesh.

- Bashkia Divjakë Krutje me vendimin nr. 26, datë 24.03.2017 ka vendosur miratimin e deklaratës për kryerje punimesh.

**B. Nga auditimi mbi disbursimet rezulton.**

Nga auditimi i dokumentacionit mbi disbursimet e punimeve të ndërtimit të realizuar sipas kontratës me objekt "Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)" Loti 2: Skema ujitëse Divjaka (Skema ujitëse në Jug dhe Veri) rezultojnë në shumën totale 698,280,993.48 lekë me TVSH: Nga shuma totale e kontratës (702,204,809.04 lekë me TVSH) është kursyer vlera 3,269,846.27 Lekë nga fondi rezervë. Detajimi i disbursimeve jepet si vijon:
- **Situacioni 1** (Paradhënie) në masën 10% në vlerën 70,022,048.80 lekë me TVSH, bazuar në pikën 14.2 të kushteve të veçanta të kontratës. Kontraktori ka bërë kërkesën me nr. prot. 48, datë 23.12.2016. MBZHR me shkresën me nr. prot. 10179/3. Miratimi nga Supervizori i punimeve është bërë sipas shkresës me nr. prot. L2/01, datë 27.12.2016
- **Situacioni 2** (IPC Nr. 2) me vlerë 110,014,311.92 lekë me TVSH.

Zbatuesi i punimeve ka deklaruar përfundimin e punimeve për këtë disbursim në Mars 2017. Në këtë situacion konstatojmë se miratimi i pagesës nga JV "GG&CE KG & GR Albania" përfaqësuar nga Dr.A. B.G është bërë me datë 19.04.2017 dhe miratimi nga Bordi Rajonal i Kullimit Fier përfaqësuar nga A.Ç është bërë me datë 05.06.2017 dhe miratimi i pagesës nga MBZHR është bërë me datë 20.06.207. Përqindja e realizimit sipas IPC 2 është 20.2%.
- **Situacioni 3** (IPC Nr. 3) me vlerë 103,253,96.40 lekë me TVSH.

Zbatuesi i punimeve ka deklaruar përfundimin e punimeve për këtë disbursim me datë 31.07.2017. Në këtë situacion konstatojmë se miratimi i pagesës nga JV "GG&CE KG & GR Albania" përfaqësuar nga Dr.A. B.G, nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier përfaqësuar nga z. A.Ç nga Drejtori i Drejtorisë së Ujit dhe Kullimit në MBZHRAU është bërë sipas afateve të kontratës. Përqindja e realizimit sipas IPC 3 është 45.1%.
- **Situacioni 4** (IPC Nr. 4) me vlerë 160,571,642.58 lekë me TVSH.

Zbatuesi i punimeve ka deklaruar përfundimin e punimeve për këtë disbursim me datë 29.09.2017. Në këtë situacion konstatojmë se miratimi i pagesës nga JV "GG&CE KG & GR Albania" përfaqësuar nga Dr.A. B.G është bërë me datë 08.09.2017 dhe miratimi nga MBZHR është bërë me datë 05.10.207, dhe miratimi i pagesës nga Drejtoria e Ujit dhe Kullimit Fier është bërë me datë 12.09.2017. Përqindja e realizimit sipas IPC është 69.4%.
- **Situacioni 5** (IPC Nr. 5) me vlerë 190,876,320.65 lekë me TVSH.

Zbatuesi i punimeve ka deklaruar përfundimin e punimeve për këtë disbursim me datë 19.10.2017. Në këtë situacion konstatojmë se, nuk është bërë miratimi i pagesës nga JV "GG&CE KG & GR Albania", nga Drejtoria e Ujit dhe Kullimit Fier si dhe nga MBZHRAU sepse nuk është bërë testimi i sistemit të ujitjes për shkak të mos lidhjes me energji elektrike nga OSHEE se Bashkia e Divajkës është Debitore.
Përqindja e realizimit sipas IPC 5, është 99.1%.
Praktika e disbursimit janë shoqëruar me: IPC-të; Librezat e masave dhe vizatimet:

**C. Mbi auditimin e dokumentacionit teknik të zbatimit dhe realizimit të punimeve në terren.**

Nga auditimi në terren mbi verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike të zbatimit (Deri tek IPC 5) të vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezultojnë:

**Skema e ujitjes Divjaka:**
Për skemën ujitëse të Divjakës, zona e projektuar e ujitjes totale është 2630 ha, nga ku: për 2130 ha është projektuar ujitje me gravitet dhe për 500 ha është projektuar ujitje me pompim.
Punimet e rehabilitimit për skemën e Divjakës konsistojnë në:

- Rehabilitimin dhe riparimin e linjës egzistese në kanale kryesore dhe sekondare të klasifikuar sipas statusit aktual fizik.
- Riseksionim dhe profilim i sksioneve të kanaleve jolinear kryesor dhe sekondar me skarpate të vlerësuar si të qëndrueshme.
- Ndërtimi i strukturave të reja të kontrollit të ujit.
- Rehabilitimi dhe ndërtimi i strukturave dalëse dhe portave për marrjen e ujit nga kanalet sekondare.
- Ndërtimi i strukturave të matjes së ujit në dalje dhe në hyrje të kanaleve sekondar

Nga auditimi në terren u konstatua se:
- Është ndërtuar stacioni i ri i pompimit në vendin PS Divjaka me katër pompa (3 pompa në operim dhe 1 pompë në gatishmëri) me kapacitet total 750 l/sek. Secila pompë ka kapacitet prej 250 l/sek. <u>Nga verifikimi në terren u konstatua se pompat janë montuar sipas projektit por aktualisht nuk është kryer testimi i tyre</u>. Pra efektiviteti i punës së pompave do të vlerësohet pas testimit.
- Është ndërtuar linja me tubacion çeliku me gjatësi totale 5701 ml dhe me diametra duke filluar me tub çeliku prej 750 mm (1950 ml); me tub çeliku prej 650 mm (1757 ml); me tub çeliku prej 650 mm (566 ml); me tub çeliku prej 450 mm (1199 ml).
- Është realizuar dega e tubit Sulzotaj e lidhur me tubin kryesor në rritje të Divjakës PS, 572 ml e gjatë me Ø 450 mm.
- Është ndërtuar një stacion pompimi përforcues për të furnizuar rezervuarin e Divjakës me kapacitet 250 l/sek dhe janë instaluar tre pompa (2 pompa në operim dhe 1 pompë në gatishmëri) me kapacitet total 125 l/sek secila pompë. <u>Nga verifikimi në terren u konstatua se pompat janë montuar sipas projektit të zbatimit por aktualisht nuk është kryer testimi i tyre</u>. Pra efektiviteti i punës së pompave dhe i gjithë sistemit të ujitjes do të vlerësohet pas testimit.
- U konstatua se është ndërtuar rezervuari me beton të armuar në Sulzotaj i cili do të komandoj të gjithë zonën e ujitjes të Sulzotaj përmes 3 tubacioneve HDPE 100, PN 16.
Për sa i përket kanaleve të kullimit u konstatua se, është bërë riseksionimi dhe profilizimi i kanaleve të kullimit në veri dhe në jug të Divjakës për rreth 30,688 ml dhe janë pajisur me struktura të kontrolluara në skajet e tyre. <u>Nga inspektimi i kanaleve u konstatua se disa prej tyre kanë filluar të mbushen me mbetje dhe bimësi, të cilat bëhen pengesë për kullimin e ujit</u>.
- Bazuar në letrën e dorëzuar tek Autoriteti Kontraktor, rezulton se punimet për skemën e Divjakës kanë përfunduar me datë 19.10.2017, por testi nuk është kryer si pasojë e mos lidhjes së energjisë elektrike.

- Konstatojmë se nga ana e Autoritetit Kontraktor me përfundimin e punimeve për skemën e Divjakës nuk ka ngritur Kolaudatorin apo Grupin e Kolaudimit për të kryer kolaudimin e punimeve të objekteve si dhe marrjen në dorëzim të përkohshëm të punimeve. Ky veprim është në kundërshtim me pikën 14 të Urdhrit të Ministrit të MBZHRAU "Për ngritjen e grupit të punës dhe detyrat për administrimin dhe menaxhimin e kontratave me numër reference MAFCPËIC004, me objekt "Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Me vendndodhje në Bashkitë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)", Loti 2, me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve në Ndërtim", i ndryshuar, me pikën 1.4 (The Law of Albania), section IX (Particular conditions) të Kontratës.

**E. Nga auditimi u konstatua këto shkelje dhe mangësi:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosje për zbatimin e punimeve dhe në veçanti për zërat e rinj, rezulton se nuk ka gjetur zbatim pika 12.3.a.i e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës "Vlerësimi" për zërat si më poshtë vijon:

**Sistemi me tuba:**

- Zëri 5; Volumi i zërit Shtresë çakulli mbeturina, kave, me t=15 cm, përhapur e ngjeshur me makineri nga 80,182 $m^2$ është bërë 102,842 $m^2$, pra volumi është rritur me mbi 25 %.
- Zëri 24; Volumi i zërit "F.V. Saraçineska gize me fllanxha, PN 16 bar, Ø 500 mm " nga 1 copë është bërë 5 copë, pra volumi është rritur me mbi 5 herë. Në këtë rast vlera e rritur është me e madhe se 0.25% të çmimit të kontratës dhe ndryshimi në sasi duhej të ndryshonte drejtpërdrejtë koston për njësi të këtij zëri.
- Zëri 33; Volumi i zërit "F.V. Saraçineska çeliku me fllanxha, PN 16 bar, Ø 200 mm" nga 1 copë është bërë 2 copë, pra volumi është rritur me mbi 25%. Në këtë rast vlera e rritur është me e madhe 1% e kostos për njësi të këtij zëri.
- Zëri 35; Volumi i zërit "F.V. Saraçineska gize me fllanxha, PN 16 bar, Ø 300 mm"n ga 6 copë është bërë 17 copë, pra volumi është rritur mbi 25 %. Në këtë rast vlera e rritur është afërsisht 0.25 % të çmimit të kontratës dhe është me e madhe se 1 % e kostos për njësi të këtij zëri.
- Zëri 36; Volumi i zërit "F.V. Saraçineska çeliku me fllanxha, PN 16 bar, Ø 400 mm" nga 1 copë është bërë 2 copë, pra volumi është rritur me mbi 25 %.

**Ndërtesa e stacionit të pompimit:**

- Zëri 5; Volumi i zërit "F.V. Hekur betoni i zakonshëm Ø > 12 mm" nga 13 ton është bërë 27.22 ton, pra volumi është rritur me mbi 25 %. Ky ndryshim në volum kalon 0.25 % të Çmimit të Pranuar të Kontratës, dhe ky ndryshim në sasi ndryshon drejtpërdrejtë Koston për njësi të këtij zëri me më shumë se 1 %, prandaj duhej të ishte negociuar/zvogëluar çmimi për njësi.
- Zëri 6; Volumi i zërit "F.V. Mur tulle me vrima, t=25 cm llaç M-25" nga 26 $m^3$ është bërë 54,3 $m^3$, pra është rritur me mbi 25 %.
- Zërat 11; 12 dhe 16 kanë pësuar rritje volumi me mbi 25 %.

Për sa më sipër zërat e punimeve kanë rritur volumet ≥ 25 % krahasuar me volumet fillestare. Referuar pikës 12.3.a.i të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës "Vlerësimi", këto zëra duheshin konsideruar si zëra të rinj pune dhe duhej bërë negocim çmimi, sepse është rritur volumi me më shumë se 25 %. Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi konsulenti i punimeve dhe autoriteti kontraktor.

Problematika e konstatuar nga grupi i auditimit mbi mos ngritjen e grupit të kolaudimit të punimeve është marrë konsideratë nga Autoriteti Kontraktor është ngritur grupi i kolaudimit më datën 28.12.2017 me nr. Prot. 563, për Lotin 2.

**5.3 Zbatimi i kontratave me objekt ´´Rehabilitimi i 11 Digave ´´ ( në Kukës, Berat, Fier, Korçë dhe Murriz Thana)**

Kontrata MAFCP/Ë/ICB/003 ´´Rehabilitimi i 11 digave´´ ( në Kukës, Berat, Fier, Korçë dhe Murriz Thana) është lidhur ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujit ( Punëdhënësi ) dhe JV ´´SA´´ &´´ TE 2 shpk´´ (Kontraktori) më datë 23 Tetor 2014 me vlerë **923,502,089.01 Lek pa TVSH**. Kohëzgjatja e punimeve është 12 muaj dhe 365 ditë periudha për njoftimin e defekteve. Punimet do të fillonin fill pas firmosjes së kontratës se mbikëqyrjes së punimeve.

Afatet e përfundimit të punimeve të zbatimit janë përmbushur plotësisht dhe punimet e ndërtimit kanë përfunduar në masen 100% brenda muajit Nëntor 2015.
Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se punimet e projektit janë disbursuar në vlerën **921,403,122.84 Lek pa TVSH** pas zbritjes se garancisë 10 % me 7 situcione pjesore, si më poshtë: (Paradhenie me vlerë 92,350,208.90 Lek pa TVSH, më datë 26.11.2014; Situacioni ICP 1 me vlerë 65,436,598.00 Lek pa TVSH më datë 15.05.2015; Situacioni ICP 2 me vlerë 72,196,852.00 Lek pa TVSH më datë 23.07.2015; Situacioni ICP 3 me vlerë 72,036,587.00 Lek pa TVSH më datë15.09.2015; Situacioni ICP 4 me vlerë 147,670,274.78 Lek pa TVSH më datë15.09.2015; Situacioni ICP 5 me vlerë 117,015,408.00 Lek pa TVSH më datë 27.11.2015; Situacioni ICP 6 me vlerë 174,279,842.96 Lek pa TVSH më datë 20.12.2015-06.01.2016-12.01.2016; Situacioni ICP 7 me vlerë 88,277,029.20 Lek pa TVSH më datë 23.05.2016; Më 24.06.2016 dhe 02.08.2017 është bër pagesa e garancisë në vlerat 46,070,161.00 Lek pa TVSH në secilin rast.)

Punimet e rehabilitimit kanë filluar të shoqëruara me deklaratat paraprake të fillimi të punimeve në komunat përkatëse siç specifikohet në Rregulloren e Zhvillimit të Territorit si më poshtë:
Deklaratë paraprake për fillimin e punimeve, Diga Belesove, Nr 1. Datë 03.01.2015 Objekti-Komuna Lumas. Deklaratë paraprake për fillimin e punimeve, Diga Duhanas, Nr1. Datë 03.01.2015. Objekti-Komuna Otllak. Deklaratë paraprake për fillimin e punimeve, Diga Koshnicë Nr1. Datë 17.12.2014. Objekti- Komuna Miras. Deklaratë paraprake për fillimin e punimeve, Diga Murriz Thanë Nr1. Datë 17.12.2014. Deklaratë paraprake për fillimin e punimeve, Diga Tregtan 2 Nr2. Datë 17.12.2014. Komuna Fajza. Deklaratë paraprake për fillimin e punimeve, Diga Zharrëz Nr1. Datë 17.12.2014. Deklaratë paraprake për fillimin e punimeve, Diga Kurjan Nr1. Datë 28.01.2015 dhe Diga Strum Nr1. Datë 28.01.2015. Roskovec.
Deklaratë paraprake për fillimin e punimeve, Diga Tregtan 3 Nr1. Datë 17.12.2014, Objekti - Komuna Fajza. Deklaratë paraprake për fillimin e punimeve, Diga Vranisht Nr. 5 Datë 27.01.2015 Objekti- Komuna Fajza.

*Gjetje nga auditimi:*

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes:** | **Deklarata e fillimit të punimeve** |
| **Situata:** | Punimet e rehabilitimit të digave kanë filluar të shoqëruara me deklaratat paraprake të fillimi të punimeve në komunat përkatëse siç specifikohet në Nenin 7 të Rregullores së Zhvillimit të Territorit. Por nga auditimi rezulton se për të gjitha rastet deklarata e përdorur për fillimin e punimeve nuk është formulari i deklaratës standard i përcaktuar në shtojcën D të rregullores së zhvillimit të territorit. Për më tepër për Digen Leminot grupit të auditimit nuk i është paraqitur deklarata paraprake e fillimit të punimeve por një letër me shkrim dore për marrje njoftimi nga drejtoria e urbanistikës së komunës Pirg. |
| **Kriteri:** | Vendim nr. 408, datë 13.5.2015 për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, neni 8, pika a. |
| **Ndikimi/Efekti:** | Shkelje procedure. |
| **Shkaku:** | Mosnjohja e legjislacionit të fushës përkatëse. |
| **Rëndësia:** | E ulët |
| **Rekomandimi:** | Njësia e zbatimit të projektit, të marrë masa që në të ardhmen të zbatojë procedurat dhe të përdorë dokumentat standard për deklaratën e fillimit të punimeve me qëllim mos shmangien e procedurave. |

Eshtë kryer studimi mjedisor dhe është gjeneruar raporti ESMP- Environmental Social Management Plan si shërbim konsulence për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Politikat e shpronësimit dhe Sondazhet Bazë nga COwI As dhe CEIA për secilën nga 11 digat.

Oponenca teknike për ‘Projektin e digave ekzistuese të Thanës dhe Zharrëzës’ nr Prot 6 është dorëzuar me datë 03.06.2013 me oponent Dr. Ing Z.M për Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit.
Oponenca teknike për Projekti Zbatimin ‘ Rehabilitimi i Digës Koshnica 1’ Nr Prot 170/2 daton më 18.11.2013 nga Instituti i Ndërtimit, Departamenti i Oponencave Rregullave Teknike dhe Standardeve.

Projekt zbatimi për rehabilitimin e digave ekzistuese Duhanas, Belesovë, Slanicë dhe Staraveckë është miratuar me Vendimin nr. 7 datë 17.06.2013 nga Komiteti Kombëtar i Digave Të Mëdha.
Projekt zbatimi për rehabilitimin e digave ekzistuese Krujan e Strum është miratuar me Vendimin nr. 6 datë 22.05.2013 nga Komiteti Kombëtar i Digave Të Medha.
Projekt zbatimi për rehabilitimin e digave ekzistuese Leminot e Koshnicë është miratuar me Vendimin nr 49 datë 26.12.2013 nga Komiteti Kombëtar i Digave Të Mëdha.

Projekt zbatimi për rehabilitimin e digave ekzistuese Vranisht-2, Tregtan-2, Tregtan-3 në rrethin e Hasit dhe T Planit në rrethin e Tropojës është miratuar me Vendimin nr. 9 datë 17.07.2013 nga Komiteti Kombëtar i Digave Të Mëdha.

Janë vënë re ndryshime nga Preventivi fillestar i tenderit të cilat nuk paraqesin ndryshim në vlerën totale të kontratës në tërësi por paraqesin rritje të disa preventiveve individuale të digave si Vranishti apo Tregtan 3 dhe ulje të disa të tjerave si Leminot apo Belesovë, të pashoqëruara me Urdhër Ndryshimi VO. Mos shoqërimi me Urdhër Ndryshimi justifikohet nga mos ndryshimi i shumës së kontratës në tërësi, panvarsisht ndryshimeve në rastet individuale. Këto ndryshime kanë ardhur si pasoje e disa problemeve të filtrimit dhe rrëshqitjeve në diga të ndodhura gjatë fazës së zbatimit të ndërtit të punimeve në terren. Panvarsisht ndryshimeve dhe parashikimeve të bëra në përfundim të punimeve **ka tepruar rreth 2,098,864.93 Lek Pa TVSH.**

| Nr | Zeri | BOQ Tenderi (Pa TVSH) | BOQ Final (Pa TVSH) | BoQ e rishikuar (Pa TVSH) | Diferenca | % | IPC7 (Pa TVSH) | Diferenca boq-ipc |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Murriz Thana | 267402597,34 | 267403144,41 | 265377478,89 | 2025665,52 | 0,76 | 265089956,84 | 287522,05 |
| 2 | Kurjan | 14859518,15 | 14859500,96 | 14859500,96 | 0,00 | 0,00 | 14859500,96 | 0,00 |
| 3 | Strum | 7463968,87 | 7463967,71 | 7463967,71 | 0,00 | 0,00 | 7463967,71 | 0,00 |
| 4 | Zharrez | 75329650,00 | 75329650,00 | 74696055,19 | 633594,81 | 0,84 | 74632514,31 | 63540,88 |
| 5 | Belesove | 73994758,61 | 73994758,61 | 71415230,29 | 2579528,32 | 3,49 | 70654911,63 | 760318,66 |
| 6 | Duhanas | 93527535,39 | 93527551,64 | 93527551,64 | 0,00 | 0,00 | 92945611,63 | 581940,01 |
| 7 | Tregtan 2 | 21733137,99 | 21733190,7 | 21733190,70 | 0,00 | 0,00 | 21733190,70 | 0,00 |
| 8 | Tregtan 3 | 23932897,5 | 23932926,35 | 26617342,13 | -2684415,78 | 11,21 | 26436520,55 | 180821,58 |
| 9 | Vranisht | 45052725,02 | 45052772,13 | 55788455,35 | -10735683,22 | 23,83 | 55640243,92 | 148211,43 |
| 10 | Leminot | 63154146,32 | 63154330,87 | 53606592,37 | 9547738,5 | 15,11 | 53530100,30 | 76492,07 |
| 11 | Koshnice | 237050097,5 | 237050295,6 | 238416724,15 | -1366428,52 | 0,58 | 238416705,90 | 18,25 |
| | | | | | | | | |
| | TOT | 923501032,64 | 923502089,01 | 923502089,38 | -0,37 | 0,00 | 921403224,45 | 2098864,93 |

*Burimi i të dhënave: Grupi i Auditimit/ Njësia e Menaxhimi të projektit*

Kontrata MAFCP/CS/002B ´´Shërbimet e mbikqyrjes për rehabilitimin e digave´´ lidhur ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujit ( Punëdhënësi ) dhe JV ´´GPI Gmbh & C K´´ dhe ´´GR AP and E C´´ dhe ´´AA B C´´ ( Konsulenti) më datë 24 Nëntor 2014 me vlerë tavan **143,266 Euro dhe 26,051,260 Lek pa TVSH.** Kohëzgjatja e kontratës është 24 muaj.
Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se shërbimet e supervizionit janë disbursuar në vlerën **26,615,157 Lek dhe 138,925 Euro pa TVSH** me 6 fatura tatimore, si më poshtë:
(Fatura Tatimore Nr. 2 me vlerë 4,900,596 Lek pa TVSH dhe 52,360 Euro më datë 02.05.2015;
Fatura Tatimore Nr. 3 me vlerë 4,146,093 Lek pa TVSH dhe 30,091 Euro më datë 07.07.2015;
Fatura Tatimore Nr. 5 me vlerë 4,116,784 Lek pa TVSH dhe 15,711 Euro më datë 20.09.2015;
Fatura Tatimore Nr. 6 me vlerë 6,111,495 Lek pa TVSH dhe 24,047 Euro më datë 20.10.2015;
Fatura Tatimore Nr. 11 me vlerë 6,715,190 Lek pa TVSH dhe 14,047 Euro më datë 09.12.2015;
Fatura Tatimore Nr. 12 me vlerë 624,999 Lek pa TVSH dhe 1,920 Euro më datë 03.01.2017.)

Shërbimet e mbikëqyrjes kanë qënë në përputhje me qëllimin e punimeve të kontratës dhe janë dorëzuar sipas specifikimeve Raporti Fillestare brenda 3 javëve pas firmosje së kontratës, Raportet Mujore të Progresit, Draft Raporti i Përfundimit të Punimeve, Raporti Përfundimtar, Raportet e Inspektimit të Periudhës së Defekteve si dhe Raporti Final.

**Komente dhe Sqarim**: *Lidhur me komentet mbi projekt raportin e auditimit të dërguara nga njësia e menaxhimit të projektit dhe protokolluar në MBZHR me Nr. Prot. 1084/1, datë 22.02.2018 (Protokolluar në KLSH me Nr. Prot. 1135/6, datë 22.02.2018) sqarojmë se janë marrë në konsideratë të gjitha sqarimet e dërguara nga subjekti i audituar të cilat kanë kundërshtuar konstatimet e grupit të auditimit me dokumentacion justifikues.*

*Për sa i përket pranimit dhe angazhimit në lidhje me fillimin e zbatimit të rekomandimeve të propozuara nga KLSH në fazën e projektraportit të auditimit sqarojmë se do të verifikohet zbatimi i tyre në auditimin e rradhës se projektit.*

***<u>Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:</u>***

## A. <u>MASA ORGANIZATIVE</u>

**1. Gjetje nga auditimi**: Për shkak të ndryshimeve strukturore të Ministrisë së Mjedisit me Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave në vitin 2017 të cilat menaxhojnë pjesën më të madhe të projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes, ka një mospërputhje të përcaktimeve të bëra në ligjin aktual të marrëveshjes së projektit me ndryshimet strukturore të Ministrive dhe manualin operacional të tij. Një situatë e tillë krijon paqartësi në adresimin e problemeve të ndryshme në lidhje me këtë projekt. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 16-21 të Raportit Përfundimtare të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** *Nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të merren masat e nevojshme për të përshtatur të gjitha emërtimet dhe funksionet e reja të Ministrive përgjegjëse për projektin e Burimeve Ujore dhe Ujitjes në manualin operacional të projektit, me qëllim përcaktimin e saktë të kompetencave të strukturave përkatëse.*

***Brenda një muaji***

**2. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të tenderit "Studimi i fizibilitetit dhe projekti paraprak për rehabilitimin e sistemit ujor dhe kullues" me operator fitues shoqërinë "MMD Ltd (UK)" dhe të tenderit "Studimi i fizibilitetit, projektet e zbatimit për ujitjen dhe kullimin, skemat e konsulencës, trajnimi dhe mobilizimi" me operator fitues Bashkimin e Operatorëve Ekonomik "R s.a (leader) (Switzerland) & BS S.r.l (member) Italy & H (member) Albania" u konstatua se Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në cilësinë e Autoritetit Kontraktor në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave teknike dhe financiare dhe të shpalljes së fituesit nuk ka njoftuar Agjencinë e Prokurimit Publik për shpalljen e fituesit si dhe për lidhjen e kontratave duke sjellë mungesë transparence dhe informimi të operatorëve pjesëmarrës në tender. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 32-33 Raportit Përfundimtare të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** *Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të marrë masa në vazhdimësi në zhvillimin e procedurave të tenderimit, të zbatojë detyrat sipas procedurave të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit dhe të bëjë njoftimin e fituesit dhe njoftimin e lidhjes së kontratës për operatorin ekonomik/bashkimin e operatorëve ekonomik të shpallur fitues në Agjencinë e Prokurimit Publik.*

***Në vazhdimësi***

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të procedurave të tenderit "Studimi i fizibilitetit, projektet e zbatimit për ujitjen dhe kullimin, skemat e konsulencës, trajnim dhe mobilizimi" u

konstatua se, Termat e Referencës nuk mbajnë emrat dhe firmat e specialistëve të cilët i kanë hartuar ato, nuk kanë nr. protokolli dhe datë, si dhe nuk janë të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (MBZHR). Çdo dokument institucional bëhet i vlefshëm ligjërisht vetëm nëse ai i ka të gjithë elementët e përmendur më sipër. Gjithashtu në dosjen teknike mungon projekt-ideja e miratuar nga investitori. Projekti është shoqëruar herë pas here me shtyrje duke ndikuar me ndryshime pjesore të zbatimit të projektit të cilat janë miratuar me urdhra ndryshimi *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 33-37 të Raportit Përfundimtare të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** *Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Njësia e Implementimit të Projekteve të marrin masa që në vazhdimësi në zhvillimin e procedurave të tenderimit, specialistët e hartimit të Termave të Referencës t'i nënshkruajnë dhe t'i miratojnë ato. Gjithashtu autoriteti kontraktor, të miratojë projekt idenë mbi studimin e fizibilitetit të hartuar nga grupi i projektimit.*

***Në vazhdimësi***

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të kontratës *"Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)" Loti 2***,** u konstatua se: - Punimet civile inxhinierike për ndërtimin e skemës ujitëse Divjaka, në raport me grafikun e punimeve të përcaktuar sipas kontratës dhe urdhër ndryshimit nr. 1 (VO nr. 1), kanë përfunduar në kohë, por aktualisht nuk është kryer testi i funksionimit të pompave dhe i gjithë funksionimit të skemës së kombinuar (me ngritje dhe me gravitet) të ujitjes Divjakë. Mos kryerja e testit ka ndikuar në mos kryerjen e kolaudimit dhe marrjes së përkohshme në dorëzim të investimit të realizuar.
- Nga auditimi mbi realizimin e zërit (riseksionimi dhe profilizimi) të kanaleve të kullimit në veri dhe në jug të Divjakës u vërejt se disa kanale kanë filluar të mbushen me mbetje dhe bimësi, duke u bërë pengesë për kullimin e ujit.
- Zbatimi i punimeve sipas projektit të zbatimit dhe kushteve teknike të zbatimit ka diktuar për disa zëra të rinj, rritje volumi ≥ 25 % krahasuar me volumet fillestare të kontratës bazë, dhe konkretisht për zërat: 5; 24; 33; 35; 36 (zëra të seksionit, sistemi i ujitjes me tuba), zërat: 5; 6; 11; 12 dhe 16 (zëra të seksionit, ndërtesa e stacionit të pompimit). Nga auditimi rezulton se nuk ka gjetur zbatim pika 12.3.a.i, e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, duke mos bërë negocim çmimi nga mbikëqyrësi i punimeve dhe Autoriteti Kontraktor për rritjen e volumit të këtyre zërave. Pavarësisht se për këto zëra nuk ka pasur negocim çmimi, vlera e këtyre nuk ka pësuar rritje. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 42-45 dhe 72-73 të Raportit Përfundimtare të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** *Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Njësia e Implementimit të Projekteve, për zbatimin e kushteve të kontratës mbi"Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)" Loti 2, duhet të marrin masat e nevojshme dhe të bashkërendojnë punën me shoqërinë zbatuese të punimeve "A.K" sh.p.k dhe me mbikëqyrësin e punimeve për:*
*- Kryerjen e testit përfundimtar nga zbatuesi i punimeve të funksionimit të skemës së kombinuar të dy stacioneve të pompimit, me qëllim bërjen efektive të skemës së ujitjes së Divjakës me*

*sipërfaqe 2630 ha, menjëherë pas lidhjes së kontratës së energjisë elektrike të Bashkisë Divjakë me OSSHE, si dhe krijimin e kushteve për kolaudimin dhe marrjes së përkohshme në dorëzim të investimit të realizuar.*
*- Pastrimin e kanaleve që kanë filluar të mbushen me mbetje dhe me bimësi, për të siguruar kullimin e plotë të ujërave, nisur nga fakti që investimi i kryer për rehabilitimin e skemës ujitëse të Divjakës është në periudhën e garancisë së defekteve.*
*- Përcaktimin me negocim të çmimeve, për zërat e rinj me rritje volumi ≥ 25 % krahasuar me volumin fillestar të preventivit bazë.*

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

**5. Gjetje nga auditimi:** Punimet e rehabilitimit të digave kanë filluar të shoqëruara me deklaratat paraprake të fillimi të punimeve në komunat përkatëse siç specifikohet në Nenin 7 të Rregullores së Zhvillimit të Territorit. Por nga auditimi rezulton se për të gjitha rastet deklarata e përdorur për fillimin e punimeve nuk është formulari i deklaratës standard i përcaktuar në shtojcën D të rregullores së zhvillimit të territorit. Për më tepër për Digën Leminot grupit të auditimit nuk i është paraqitur deklarata paraprake e fillimit të punimeve, por një letër me shkrim dore për marrje njoftimi nga drejtoria e urbanistikës së komunës Pirg. Ky veprim përbën shkelje procedure në kundërshtim me Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, neni 8, pika a *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 78-80 të Raportit Përfundimtare të Auditimit).*

**5.1 Rekomandimi:** *Njësia e zbatimit të projektit, të marrë masa që në të ardhmen të zbatojë procedurat dhe të përdorë dokumentet standard për deklaratën e fillimit të punimeve me qëllim mos shmangien e procedurave ligjore.*

***Në vazhdimësi***

**6. Gjetje nga auditimi:** Kontrata e lidhur me operatorin "P"shpk në procedurën e prokurimit me objekt "Pajisje hardware për Qendrën e Kadastrës së Ujit" është lidhur në datën 24.11.2016, ndërkohë që operatori ekonomik i skualifikuar ""CP"shpk", është njoftuar në datën 05.12.2016, ose 11 ditë pas firmosjes së kontratës me operatorin fitues, fakt i cili ka bërë që ankimimi i këtij operatori i dërguar me e-mail në datën 08.12.2016 dhe protokolluar me nr. 9484 prot në datën 12.12.2016 të jetë i pavlefshëm, referuar procedurave të njoftimit të cituara në nenet 130-146 të Kodit të Procedurave Administrative *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 53-60 të Raportit Përfundimtare të Auditimit).*
**6.1 Rekomandim:** *Ekipi i Menaxhimit të Projektit të respektojë të drejtat e operatorëve ekonomik të përcaktuar në Kodin e Procedurës Administrative për ankimim administrativ duke lënë një afat kohor të mjaftueshëm përpara lidhjes së kontratave.*

***Në vazhdimësi***

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga Auditimi i procedurave të prokurimit me objekt "Pajisje hardware për Qendrën e Kadastrës së Ujit" dhe "Blerje e pajisjeve kompjuterike dhe softe për Bordet e Kullimit dhe MBZHRAU", u konstatua se nuk ka një referencë në lidhje me vlerësimin e specifikimeve teknike. Në raportin e vlerësimit të ofertave të operatorëve, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave shprehet për devijime të vogla apo të mëdha kundrejt specifikimeve teknike të pajisjeve të ofruara. Por, për këtë vlerësim nuk ka një bazë apo referencë lidhur me përcaktimin nëse këto devijime janë të vogla apo të mëdha duke bërë që vlerësimi të jetë jo plotësisht objektiv *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 53-60 të Raportit Përfundimtare të Auditimit).*

**7.1 Rekomandim:** *Ekipi i Menaxhimit të Projektit, të kërkojë nga Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të ngritura për qëllimet e projektit, referenca të sakta të vlerësimit të specifikimeve teknike duke shmangur subjektivitetin dhe duke qenë më transparent kundrejt operatorëve ekonomik.*

***Në vazhdimësi***

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se të gjitha dosjet e prokurimeve nuk janë të inventarizuara dhe arkivuara, veprim në kundërshtim me nenin 3 e 29 të "Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat" *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 32-63 të Raportit Përfundimtare të Auditimit).*

**8.1 Rekomandim:** *Nga ana e Ekipi i Menaxhimit të Projektit të merren masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve dhe dokumenteve të procedurave të prokurimit publik, në zbatim të Normave Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.*

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt: "Blerje e pajisjeve kompjuterike dhe softe për Bordet e Kullimit dhe MBZHRAU", "Blerje automjetesh", Shërbimet e Supervizionit për punimet e ujitjes dhe kullimit" dhe "Mobilje për Bordet e Kullimit" u konstatua se anëtarët e hartimit të specifikimeve teknike janë edhe pjesë e komisionit të vlerësimit të ofertave, veprim në kundërshtim me Nenin 58 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet: "Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës. Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave*..."(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 32-63 të Raportit Përfundimtare të Auditimit).*

**9.1 Rekomandim:** *Ekipi i Menaxhimit të Projektit të marrë masa që në vazhdimësi të mos lejojë ngritjen e Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave, të cilët në përbërje kanë punonjës të caktuar paraprakisht si pjesë e njësisë së prokurimit për të njëjtën procedurë prokurimi.*

*Në vazhdimësi*

## IV KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

**-Konkluzione:**
Në bazë të punës audituese të kryer, të përshkruar në Kreun III të Projektraportit, Grupit të Auditimit i rezulton se veprimtaria e Njësisë së Zbatimit të Projektit në MBZHR, për periudhën objekt auditimi, është në përputhje në çdo aspekt material me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi, përsa i përket marrëveshjes së financimit të projektit me huadhënësin, ndryshimet e saj, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimeve; shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjen me huadhënësin; menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar dhe raportimi i tyre në Ministrinë e Financave; zbatimin e kritereve dhe procedurave të përcaktuara në marrëveshje me huadhënësin, për realizimin e prokurimeve për ndërtime/pune e shërbime deri në lidhjen e kontratës dhe në përgjithësi për zbatimin e kontratave të lidhura për punime civile inxhinierike dhe shërbime.

*Nga auditimi rezultuan edhe disa problematika si:*

-Mospërputhje të përcaktimeve të bëra në ligjin aktual të marrëveshjes së projektit me ndryshimet strukturore të Ministrive për shkak të ndryshimeve strukturore të tyre në vitin 2017 e cila krijon paqartësi në adresimin e problemeve të ndryshme në lidhje me këtë projekt.
- Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstatua se të gjitha dosjet e prokurimeve të zhvilluara nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara sipas legjislacionit në fuqi
-Nga auditimi i zbatimit të procedurave të tenderit “Studimi fizibilitetit dhe projekti paraprak për rehabilitimin e sistemit ujor dhe kullues” dhe të tenderit “Studimi i fizibilitetit, projektet e zbatimit për ujitjen dhe kullimin, skemat e konsulencës, trainim dhe mobilizimi” u konstatua se Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në cilësinë e Autoritetit Kontraktor në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave teknike dhe financiare dhe të shpalljes së fituesit, nuk ka njoftuar Agjencinë e Prokurimit Publik, për shpalljen e fituesit si dhe për lidhjen e kontratave.
Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të kontratës “Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)” Loti 2, u konstatua se punimet civile inxhinierike për ndërtimin e skemës ujitëse Divjaka, në raport me grafikun e punimeve të përcaktuar sipas kontratës dhe urdhër ndryshimit nr. 1, kanë përfunduar në kohë, por aktualisht nuk është kryer testi i funksionimit të pompave dhe i gjithë skemës së ujitjes Divjakë. Mos kryerja e testit ka ndikuar në mos kryerjen e kolaudimit dhe marrjes së përkohshme në dorëzim të investimit të realizuar.
Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të kontratës “Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)” Loti 2, mbi realizimin e zërit (riseksionimi dhe profilizimi) të kanaleve të kullimit në veri dhe në jug të Divjakës u konstatua se disa kanale kanë filluar të mbushen me mbetje dhe bimësi, duke u bërë pengesë për kullimin e ujit.

Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të kontratës "Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)" Loti 2, për zërat e rinj me rritje volumi ≥ 25 % krahasuar me volumet fillestare, rezulton se për zërat: 5; 24; 33; 35; 36 (zëra të seksionit, sistemi i ujitjes me tuba) dhe zërat: 5; 6; 11; 12 dhe 16 (zëra të seksionit, ndërtesa e stacionit të pompimit), nuk ka gjetur zbatim pika 12.3.a.i, e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, duke mos bërë negocim çmimi nga supervizori i punimeve dhe Autoriteti Kontraktor për rritjen e volumit.

- Nga auditimi rezultoi se objektivat e konsulentit dhe të supervizorit konsiderohen të përmbushura.

- Nga auditimi i procedurës "Shërbime mbikëqyrje për Rehabilitimin e Digave", me fondin prej 232.400 Euro është tenderuar dy herë dhe në të dy rastet ka dështuar. Procedura e parë ka dështuar për rrjedhojë të vlerës shumë të ulët të fondit limit ndërsa e dyta për arsye se propozimi teknik i kompanisë së vetme që u paraqit në garë nuk kaloi pragun e minimumit të pikëve teknike. Kjo procedurë është ritenderuar me kushtin e vendosur nga BB për rishikimin e termave të referencës, kërkesës për shprehje interesi dhe buxhetit duke sugjeruar rritjen e buxhetit me të paktën 25%, duke ndikuar në zhvillim normal të procedurës finale. Fituesi në këtë procedurë, pavarësisht se është oferta më e ulët, është 4,238,589.22 lekë mbi koston e vlerësuar. Mosllogaritja e saktë e kostos së mbikqyrjes ka rezultuar në 17 muaj shtyrje të procedurës së prokurimit të mbikqyrjes së punimeve dhe për rrjedhojë, ndikim në lidhjen e kontratës së punëve civile.

- Punimet e rehabilitimit të digave kanë filluar të shoqëruara me deklaratat paraprake të fillimi të punimeve në komunat përkatëse siç specifikohet në Nenin 7 të Rregullores së Zhvillimit të Territorit. Por, nga auditimi rezulton se për të gjitha rastet deklarata e përdorur për fillimin e punimeve nuk është formulari i deklaratës standard i përcaktuar në shtojcën D të rregullores së zhvillimit të territorit. Gjithashtu për Digen Leminot grupit të auditimit nuk i është paraqitur deklarata paraprake e fillimit të punimeve por një letër me shkrim dore për marrje njoftimi nga drejtoria e urbanistikës së komunës Pirg. Shkelje procedure kjo, në kundërshtim me Vendim nr. 408, datë 13.5.2015 për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, neni 8, pika a.

- për procedurën e prokurimit me objekt "Pajisje hardware për Qendrën e Kadastrës së Ujit", kontrata e lidhur me operatorin "P" shpk është në datën 24.11.2016, ndërkohë që operatori ekonomik i s'kualifikuar ""CP" shpk", është njoftuar në datën 05.12.2016, ose 11 ditë pas firmosjes së kontratës me operatorin, *veprim i cili e bën të pavlefshme të drejtën e ankimimit* e tij në zbatim të neneve 130-146 të Kodit të Procedurave Administrative.

-Nga Auditimi i procedurave të prokurimit me objekt "Pajisje hardware për Qendrën e Kadastrës së Ujit" dhe "Blerje e pajisjeve kompjuterike dhe softe për Bordet e Kullimit dhe MBZHRAU", u konstatua se nuk ka një referencë në lidhje me vlerësimin e specifikimeve teknike. Në raportin e vlerësimit të ofertave të operatorëve, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave shprehet për devijime të vogla apo të mëdha kundrejt specifikimeve teknike të pajisjeve të ofruara. Por për këtë vlerësim nuk ka një bazë apo referencë lidhur me përcaktimin nëse këto devijime janë të vogla apo të mëdha duke bërë që vlerësimi të jetë jo plotësisht objektiv.

- Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt: "Blerje e pajisjeve kompjuterike dhe softe për Bordet e Kullimit dhe MBZHRAU", "Blerje automjetesh", Shërbimet e Supervizionit për punimet e ujitjes dhe kullimit" dhe "Mobilje për Bordet e Kullimit" u konstatua se anëtarët e

hartimit të specifikimeve teknike janë edhe pjesë e komisionit të vlerësimit të ofertave, veprim në kundërshtim me Nenin 58 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku citohet: *"Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës. Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave…".*

## OPINIONI I AUDITIMIT

***Baza për opinionin mbi përputhshmërisë (ISSAI 4100[1]) e Projektit "Burimet Ujore dhe Ujitja".***

*Nga auditimi mbi përputhshmërinë[2], sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti-Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural/ Njësia e Menaxhimit të Projektit, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë materiale, të cilat konsistojnë si më poshtë:*

***1**. në drejtim të menaxhimit më me efektivitet të investimeve të realizuara për kontratat me objekt "Rehabilitimi i 5 skemave ujitëse (Lokalizuar në Bashkinë Lushnjë, Divjakë, Roskovec dhe Devoll)" Loti I dhe Loti II, me qëllim rritjen në një nivel më të lartë të përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit menaxherial.*

***2**. në drejtim të kuptimit dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.*

***3**. në drejtim të përmbushjes se detyrave te autoritet kontraktor për procedurat e prokurimit*

***4**. në drejtim të përllogaritjes së vlerësimit të kostos në mbikëqyrjen e punimeve civile duke iu përmbajtur udhëzuesve të përzgjedhjes dhe punësimit të konsulentëve të Bankës Botërore.*

*Ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.*

***Opinion i pakualifikuar***

*Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 400, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për Projektin "Burimet Ujore dhe Ujitja", nuk u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale, për të cilën japim* ***opinion të pakualifikuar.***

---

[1] **1.ISSAI 4100 –** Objektivi i audituesve në një auditim pnrputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë ënshtë në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

[2] Mbështetur mbi Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së".

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

**GRUPI I AUDITIMIT**

**1. A.B, përgjegjës grupi;**

**2. B.D, auditues;**

**3. M.R, auditues**

**4. I.H, auditues**

**5. S.M, auditues**

**DREJTORI I DEPARTAMENTIT**

**Y.P**